



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture,
Forestry and Rural Development

Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,

Në mbështetje të nenit 18 pika (c) të Ligjit Nr. 2004/21 Për Veterinarinë (Gazeta Zyrtare, Nr.18/01. Nëntor 2007), nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 34 / 18 Nëntor 2022), nenin 4 (paragrafi 1 nën paragrafi 1.11), Shtojcën 1:pika 11 të Rregullores (QRK)-NR.14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (16.08.2023) si dhe nenin 38, paragrafi 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë, Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare, Nr. 15,12.09.2011),

Nxjerrë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MBPZHR) - NR. 15/2023 PËR ZBATIMIN E
RREGULLAVE SHËNDETËSORE PËR NËNPRODUKTE SHTAZORE DHE
PRODUKTE TË DERIVUARA QË NUK JANË TË DESTINUARA PËR KONSUM NGA
NJERIU

KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

NËNKAPITULLI I
QËLLIMI, FUSHËVEPRIMI DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1
Qëllimi

1. Ky Udhëzim Administrativ përcakton masat zbatuese:

1.1.për rregullat e shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve dhe për nënproduktet e kafshëve dhe produktet e përfituara nga to dhe të cilat nuk dedikohen për konsum njerëzor” dhe



1.2. për mostrat dhe artikujt e caktuar të cilët nuk i nënshtrohen kontrolleve veterinarë në pikat kufitare.

2. Ky Udhëzim Administrativ është në përputhje me Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 142/2011 Për zbatimin e rregullave shëndetësore në lidhje me nënproduktet shtazore dhe produktet e përfituara nga to e që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor dhe duke zbatuar Direktivën e Këshillit 97/78/EC në lidhje me mostrat e caktuara dhe artikujt të cilat nuk i nënshtrohen kontrolleve veterinarë në kufi sipas asaj direktive, të ndryshuar për herë të fundit nga Rregullorja e Komisionit (BE) 2020/797 e datës 17 qershor 2020.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të detyrueshme për të gjithë operatorët afarist që merren me nënprodukte shtazore dhe produkte të përfituara prej tyre në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Udhëzim Administrativ kanë këto kuptime:

1.1. Kafshët me gëzof - nënkupton kafshët që mbahen ose rriten për prodhim të gëzofit dhe nuk përdoren për konsum nga njeriu;

1.2. Gjaku - nënkupton gjakun e plotë të freskët;

1.3. Materiali i ushqimit për kafshë- nënkupton materialet e ushqimit për kafshë, të përcaktuara me legjislacionin në fuqi për vendosjen në treg dhe përdoret si ushqim, që është me origjinë shtazore, duke përfshirë proteinat e procesuara shtazore, produktet e gjakut, yndyrërat e renderuara, produktet e vezëve, vaji i peshkut, derivatet e yndyrërave, kolagjeni, xhelatina dhe proteinat e hidrolizuara, dikalcium fosfati, trikalcium fosfati, qumështi, produktet me bazë qumështi, produktet e derivuara nga qumështi, kulloshtira, produktet e kulloshtres dhe llumi nga centrifuga dhe ndarësi;

1.4. Produktet e gjakut - nënkupton produktet e derivuara prej gjakut ose pjesëve të gjakut, me përjashtim të miellit të gjakut; që përfshijnë plazmën e thatë, ngrirë dhe të lëngshme, gjakun e plotë të tharë, qelizat e kuqe dhe pjesë të saj të thara, ngrira, dhe lëngshme si dhe parapërzierjet;

1.5. Proteinat e procesuara të kafshëve - nënkupton proteinat e derivuara nga kafshët tërësisht nga materiali i Kategorisë 3 që janë trajtuar në pajtim me Nënkapitullin 1, Kapitulli II, Shtojca VIII e këtij Udhëzimi Administrativ:

1.5.1. përfshirë miellin e gjakut dhe miellin e peshkut ashtu që të përgatiten në mënyrë të përshtatshme për përdorim direkt si material i ushqimit të kafshëve ose ndonjë

përdorim tjetër në produktet e ushqimit të kafshëve, përfshirë ushqimin për kafshë shoqëruese, ose për përdorim për fertilizuesit organik ose pasurues të tokës; sidoqoftë ato nuk përfshijnë produktet e gjakut, qumështin, produktet me bazë të qumështit, produktet e derivuara nga qumështi, kulloshtren, produktet e kulloshtres, llumi i centrifugës ose ndarësit, xhelatinën, proteinat e hidrolizuara dhe dikalcium fosfatit, vezët dhe produktet e vezëve, përfshirë lëvozhgat e vezëve, trikalcium fosfatit, dhe kolagjenin.

1.6. Mielli i Gjakut - nënkupton proteinat e procesuara të kafshëve të derivuara nga trajtimi me anë të ngrohjes së gjakut ose përbërësve të gjakut në pajtim me Nënkapitulli 1, Kapitulli II, Shtojca VIII të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.7. Mielli i Peshkut - nënkupton proteinat e procesuara të kafshëve të derivuara nga kafshët akuatike, përveç gjitarëve të detit, duke përfshirë pakurizorërt ujorë të kultivuar, duke përfshirë ato që mbulohen nga legjislacioni specifik për kërkesat e shëndetit të kafshëve për kafshët e akuakulturës dhe produktet e tyre, si dhe për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të caktuara në kafshë akuatike dhe yjet e detit të specieve *Asterias rubens* të cilat mbliidhen në një zonë të prodhimit të molusqeve, ose vaji nga përpunimi i peshkut për konsum nga njeriu, të cilin një operator i ka destinuar për qëllime tjera përveq konsumit nga njeriu;

1.8. Yndyrërat e renderura - nënkupton yndyrërat e përfituara nga procesimi i:

1.8.1. Nënprodukteve të kafshëve; ose

1.8.2. Produkteve për konsum nga njeriu, të cilat operatori i ka destinuar për qëllime tjera përveq konsumimit nga njeri.

1.9. Vaj peshku - nënkupton vajin e përfituar nga përpunimi i kafshëve akuatike, përveç gjitarëve të detit, duke përfshirë pakurizorërt ujorë të kultivuar, duke përfshirë ato që mbulohen nga legjislacioni në fuqi për kërkesat e shëndetit të kafshëve për kafshët e akuakulturës dhe produktet e tyre, si dhe për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve të caktuara në kafshë akuatike dhe yjet e detit të specieve *Asterias rubens* të cilat mbliidhen në një zonë të prodhimit të molusqeve, ose vaji nga përpunimi i peshkut për konsum nga njeriu, të cilin një operator i ka destinuar për qëllime tjera përveq konsumit nga njeriu;

1.10. Nënproduktet e apikulturës - nënkupton mjaltin, dyllin e bletëve, xhelatinën mbretërore, propolisin ose polenin që nuk synohet për konsum nga njeriu;

1.11. Kolagjeni - nënkupton produktet me bazë të proteinave të përfituara nga lëkurat, gëzofët, eshtrat, dhe tendinat e kafshëve;

1.12. Xhelatinë - nënkupton proteinat natyrore të tretshme, që xhelatinizohen ose jo të xhelatinizueshme, e cila fitohet me hidrolizë të pjesëshme të kolagjenit të prodhuar nga eshtrërat, gëzofët dhe lëkurat, tendinat dhe sinovitet e kafshëve;

1.13. Mbetja nga përpunimi i yndyrërave shtazore - nënkupton proteinat që përmbajnë mbetjet e renderimit, pas ndarjes së pjesëshme të yndyrës dhe ujit;

1.14. Proteinat e hidrolizuara - nënkupton polipeptidet, peptidet dhe aminoacidet, dhe përzierjet e tyre, të fituara me hidrolizë të nënprodukteve shtazore;

1.15. Uji i bardhë - nënkupton një përzierje të qumështit, produkteve me bazë të qumështit ose produkteve të derivuara prej tyre me ujë që është grumbulluar gjatë shpërlarjes së pajisjeve të qumështit përfshirë kontejnerët e përdorur për produkte qumështi, para pastrimit dhe dezinfektimit të tyre;

1.16. Ushqimi i konzervuar për kafshë shoqëruese - nënkupton ushqimin e kafshëve shoqëruese të procesuar me ngrohje që është i vendosur në kanaçe të mbyllura hermetikisht;

1.17. Përtypësit për qenjtë - nënkupton produktet për kafshë shoqëruese që përtyphen, të prodhuara nga gëzofët e lëkurat e patrajtuara të thundrakëve ose nga materialet e tjera me origjinë shtazore;

1.18. Organet e brendshme aromatizuese - nënkupton një produkt të derivuar të lëngshëm ose dehidruar me origjinë shtazore të përdorur për përmirësim të vlerave të palatabilitetit (shijes) të ushqimit për kafshë shoqëruese;

1.19. Ushqim për kafshë shoqëruese - nënkupton ushqimin, përveç atij të përcaktuar në Nenin 26, paragrafi 2 i këtij Udhëzimi Administrativ për përdorim si ushqim për kafshë shoqëruese dhe përtypës për qentë, të cilët përbëhen nga nënproduktet shtazore dhe produktet e përfituara të cilat:

1.19.1.përmbajnë material të Kategorisë 3, përveç materialit të përcaktuar në Nenin 10 paragrafi 1 nënparagrafi 1.14, 1.15 dhe 1.16 të Udhëzimit Administrative (MBPZHR) – NR..05/2022 Për përcaktimin e rregullave shëndetësore për nënproduktet shtazore dhe produktet e përfituara prej tyre të cilat nuk destinohen për konsum njerëzor dhe

1.19.2.mund të përmbajë material të importuar të Kategorisë 1 që përbëhet nga nënproduktet shtazore të derivuara nga kafshët të cilat i janë nënshtruar trajtimit ilegal siç është përcaktuar në Nenin 2, paragrafin 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.26/2005 Mbi masat për monitorimin e materieve të caktuara dhe mbetjeve të tyre në kafshët e gjalla dhe në produktet me prejardhje shtazore në lidhje me monitorimin e përdorimit në blegtori të materieve të caktuara që kane veprim hormonal ose tireostatik ,beta agonistëve në kafshët e gjalla dhe në produktet me prejardhje shtazore.

1.20. Ushqimi i përpunuar për kafshë shoqëruese - nënkupton ushqimin për kafshë shoqëruese, përveç atij të freskët, i cili është përpunuar në pajtim me pikën 3 të Kapitullit II të Shtojcës XI të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.21. Ushqimi i freskët për kafshë shoqëruese - nënkupton ushqimin për kafshë që përmban material të caktuar të Kategorisë 3 i cili nuk i është nënshtruar ndonjë procesi të konzervimit përveç ftohjes dhe ngirjes;

1.22. Mbetjet hotelerike - nënkupton të gjitha mbetjet e ushqimit, përfshirë vajin e përdorur për gatim që vjen nga restorantet, objektet hotelerike dhe kuzhinat, përfshirë kuzhinat qendrore dhe kuzhinat shtëpiake;

1.23. Mbetjet e tretjes - nënkupton mbetjet që rezultojnë nga transformimi i nënprodukteve shtazore në fabrikë të biogazit;

1.24. Përmbajtja e traktit të tretjes - nënkupton përmbajtjen e traktit të tretjes të gjitarëve dhe brejtësve;

1.25. Derivatet e yndyrësve - nënkupton produktet e derivuara nga yndyrërat e renderuara, të cilat, sa i përket materialit të yndyrësve të renderuara të Kategorisë 1 ose Kategorisë 2, janë procesuar në pajtim me Kapitullin XI të shtojcës XI të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.26. Guano - nënkupton produkt natyror i cili është mbledhur nga ekstremet e lakuriqëve ose zogjve të egër të detit dhe i cili nuk është i mineralizuar;

1.27. Mielli i mishit dhe eshtrave - nënkupton proteinat e kafshëve të cilat janë derivuar nga përpunimi i materialeve të Kategorisë 1 ose Kategorisë 2 në pajtim me njëren nga metodat e procesimit të përcaktuar në Kapitullin III të Shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.28. Lëkurat dhe gëzofët e trajtuara - nënkupton produktet e derivuara nga lëkurat dhe gëzofet e patrajuara, me përjashtim të përtpësve të qenve, të cilat janë:

1.28.1. të thara;

1.28.2. të thara me kripë ose lagura me kripë për një periudhë prej së paku 14 ditë para dërgimit;

1.28.3. të kryposura për një periudhë prej së paku shtatë ditësh në kripë të detit me shtesë prej 2% të sodë bikarbonit;

1.28.4. të thara për një periudhë prej së paku 42 ditësh në temperaturë prej të paktën 20 °C; ose

1.28.5. i nënshtrohet procesit të konzervimit përveç rethjes;

1.29. Lëkurat dhe gëzofët e patrajuara - nënkupton të gjitha indet lëkurore dhe nënlëkurore që nuk i janë nënshtrohet ndonjë trajtimi, përveç copëtimit, ftohjes dhe ngrirjes;

1.30. Puplat dhe pjesët e puplave të patrajuara - nënkupton puplat dhe pjesët e puplave, përveç puplave dhe pjesëve të puplave që janë trajtuar:

1.30.1. me rrymim të avullit; ose

- 1.30.2. me ndonjë metodë tjetër që siguron se nuk mbetet ndonjë rrezik i papranueshëm;
- 1.31. Leshi i patrajtuar - nënkupton leshin, me përjashtim të atyre që i janë:
- 1.31.1. nënshtruar larjes në fabrikë;
 - 1.31.2. janë fituar nga rexhja; ose
 - 1.31.3. janë trajtuar me ndonjë metodë tjetër që siguron se nuk ka mbetë ndonjë rrezik i papranueshëm;
 - 1.31.4. është prodhuar nga kafshë të ndryshme nga ato të specieve të derrit, dhe i është nënshtruar larjes në fabrikë, e cila konsiston në zhytjen e leshit në seri banjash me ujë, sapun dhe hidroksid natriumi ose hidroksid kaliumi; ose
 - 1.31.5. është prodhuar nga kafshë të ndryshme nga ato të specieve të derrit, dedikuar për dërgim drejtpërdrejt në një fabrikë që prodhon produkte të përfituara nga leshi për industrinë tekstile dhe i është nënshtruar të paktën njërit prej trajtimeve vijuese.
 - 1.31.6. depilimi kimik me anë të gëlqeres së shuar ose sulfurit të natriumit;
 - 1.31.7. tymosje në formaldehyd në një dhomë të mbyllur hermetikisht për të paktën 24 orë;
 - 1.31.8. pastrim industrial i cili konsiston në zhytjen e leshit në detergjent të tretshëm në ujë të mbajtur në 60 -70 °C;
 - 1.31.9. ruajtja e cila mund të përfshijë kohën e udhëtimit, në 37 °C për tetë ditë, 18 °C për 28 ditë ose 4 °C për 120 ditë.
- 1.32. Floket e patrajtuara - nënkupton flokët me përjashtim të atij i cili është:
- 1.32.1. nënshtruar larjes në fabrikë;
 - 1.32.2. janë fituar nga rexhja; ose
 - 1.32.3. janë trajtuar me ndonjë metodë tjetër që siguron se nuk ka mbetë ndonjë rrezik i papranueshëm.
- 1.33. Qimet e patrajtuara të derrit - nënkupton qimet e derrit, përveç atyre që i janë:
- 1.33.1. nënshtruar larjes në fabrikë;
 - 1.33.2. janë fituar nga rexhja; ose

- 1.33.3. trajtuar me ndonjë metodë tjetër që siguron se nuk ka mbetë asnjë rrezik i papranueshëm.
- 1.34. Njësi për ekspozim - nënkupton nënproduktet shtazore ose produktet e derivuara që synohen për ekzpozita ose aktivitete artistike;
- 1.35. Produktet e ndërmjetme - nënkupton produkt të derivuar:
- 1.35.1. që synohet për prodhim të produkteve medicinale, produkte medicinale veterinare, pajisje medicinale, pajisje aktive medicinale të implantueshme, pajisje medicinale të diagnostikimit in vitro ose reagjentët laboratorik ose produktet kozmetike si në vijim;
 - 1.35.2. si material në procesin e përpunimit ose në prodhimin përfundimtar të produktit final;
 - 1.35.3. në validimin ose verifikimin gjatë procesit të prodhimit; ose
 - 1.35.4. në kontrollin e cilësisë të produktit final;
 - 1.35.5. fazat e dizajnit, transformimit dhe prodhimit të cilëve janë kompletuar mjaftueshëm në mënyrë që të konsiderohen si produkte të derivuara dhe të kualifikojnë materialin drejtëpërsëdrejti, ose si komponentë i një produkti që i referohet nenparagrafit 1.35.1 të këtij paragrafi;
 - 1.35.6. i cili megjithatë kërkon përpunim ose transformim të mëtejshëm, siç është përzierja, shtresimi, montimi, paketimi ose etiketimi për ta bërë atë të përshtatshëm për vendosje të produktit në treg ose vendosjes së tij në shërbim, si të jetë e përshtatshme, si produkt medicinal, produkt medicinal veterinar, pajisje medicinale, pajisje medicinale aktive të implantueshme, pajisje diagnostikimi in vitro, ose reagjent laboratorik ose produkt kozmetik.
- 1.36. Reagjent laboratorik - nënkupton një produkt të paketuar, të gatshëm për përdorim, që përmban nënprodukte shtazore ose produkte të derivuara dhe synohet si i tillë ose në kombinim me produkt me prejardhje jo-shtazore për përdorim specifik laboratorik si reagjent ose produkt reagjent, kalibrues ose material kontrollues për detektim, matje, ekzaminim ose prodhim të substancave tjera;
- 1.37. Produkt që përdoret për diagnostikim in vitro - nënkupton një produkt të paketuar, të gatshëm për përdorim, që përmban një produkt të gjakut apo ndonjë nënprodukt tjetër shtazor, dhe i përdorur si reagjent, produkt reagjent, kalibrues, kit apo ndonjë sistem tjetër, qoftë i përdorur i vetëm ose në kombinim, që synohet të përdoret *in vitro* për testimin e mostrave me prejardhje njerëzore ose shtazore, vetëm ose me qëllim diagnostikimin e gjendjes fiziologjike, gjendjes shëndetësore, abnormalitetit gjenetik ose sëmundjes ose për përcaktimin e sigurisë dhe kompatibilitetit me reagjentët; ai nuk përfshinë organet e dhuruara ose gjakun;

1.38. Mostrat e hulumtimit dhe diagnostikës - nënkupton nënproduktet shtazore dhe produktet e derivuara të synuara për qëllimin si në vijim: testimi në kontekst të aktiviteteve të diagnostikimit ose analizës për promovimin e avacnimit në shkencë dhe teknologji, të aktiviteteve për edukim dhe hulumtim;

1.39. Mostrat për qëllim komercial - nënkupton nënproduktet shtazore ose produktet e derivuara të synuara për studime të caktuara ose analiza të autorizuar nga autoriteti kompetent në pajtim me Nenin 17 ,paragraph 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) 05/2022 Për përcaktimin e rregullave shëndetësore për nënproduktet shtazore dhe produktet e përfituara prej tyre të cilat nuk destinohen për konsum njerëzor me qëllim të kryerjes së procesit të prodhimit ose promovimit të artikujve ushqimor për kafshë ose produkte tjera të derivuara, përfshirë testimin e pajisjeve, për përdorim në ndërmarrje ose fabrikë e cila është:

1.40. ko-incinerimi - nënkupton përpunimin ose hudhjen e nënprodukteve shtazore ose produkteve të derivuara, nëse ato janë mbeturina, në fabrikë të ko-incinerimit;

1.41. djegia - nënkupton procesin që përfshin oksidimin e lëndëve djegëse në mënyrë që të përdoret vlera e energjisë së nënprodukteve shtazore ose produkteve të derivuara, nëse ato nuk janë mbeturina;

1.42. incinerimi - nënkupton hudhjen e në produkteve shtazore ose produkteve të derivuara si mbeturina, në fabrikën e incinerimit, siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi;

1.43. mbetje e incinerimit dhe ko-incinerimit - nënkupton çdo mbetje në e cilat gjenerohet në fabrikat për incinerim ose ko-incinerim që trajtojnë nënproduktet shtazore ose produktet e derivuara;

1.44. kodimi sipas ngjyrës - nënkupton përdorimin sistematik të ngjyrave siç është vendosur në paragrafin 1 pikën 1.3 të Kapitullit II të shtojcës VI për të shfaqur informatën siç është përcaktuar në këtë Udhëzim Administrativ në sipërfaqe ose në një pjesë të sipërfaqes të paketimit kontejner apo makinë, ose në një etiketë ose simbol që aplikohet në to;

1.45. Operimet e ndërmjetme - nënkupton operimet, përveç magazinimit, të përcaktuara në Nenin 20 paragrafi 2 nënparagrafi 1.2 të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.46. Rexhja e lëkurave - nënkupton forcimin e lëkurave, duke përdorur përbërës me prejardhje bimore për rexhje, kripërat e kromit ose substancat e tjera siç janë kripërat e aluminit, kripërat e hekurit, aldehidet dhe kuinonet, ose përbërësit tjerë sintetik për forcim;

1.47. Taksidermia - nënkupton artin e përgatitjes, mbushjes dhe montimit të lëkurërave të kafshëve me efekte si të gjallë, ashtu që të mos transmetohet asnjë rrezik i papranueshëm për shëndetin publik dhe të kafshëve nëpërmjet lëkurës së montuar;

1.48. Tregtimi - nënkupton tregtinë me mallëra ndërmjet Republikës së Kosovës dhe shteteve të tjera;

1.49. Metodatat e procesimit - nënkupton metodatat e përcaktuara në kapitullin II dhe III të Shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.50. Grumbull - nënkupton njësinë e prodhimit të prodhuar në një fabrikë të vetme duke përdorur parametra uniforme të prodhimit, siç janë origjina e materialeve, ose një numër i njësisve të tilla, kur prodhohen në një rënditje të vazhdueshme në një fabrikë të vetme dhe deponohen bashkë si njësi e transportit;

1.51. Kontejner i mbyllur hermetikisht - nënkupton një kontejner që është dizajnuar dhe që synohet të jetë i sigurtë ndaj hyrjes së mikroorganizmave;

1.52. Fabrika e biogazit nënkupton një fabrikë në të cilën nënproduktet shtazore ose produktet e derivuara janë të paktën pjesë e materialit që i nënshtrohet degradimit biologjik në kushte anaerobe;

1.53. Qendrat e grumbullimit - nënkupton hapësirat përveç fabrikave të procesimit në të cilat nënproduktet shtazore të përcaktuara në nenin 18 (1) të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022 Për përcaktimin e rregullave shëndetësore për nënproduktet shtazore dhe produktet e përfituara prej tyre të cilat nuk destinohen për konsum njerëzor që grumbullohen me qëllim që të përdoren për ushqyerjen e kafshëve të përcaktuara në nenin e njëjtë;

1.54. Fabrika e kompostimit- nënkupton fabrikën në të cilën nënproduktet shtazore ose produktet e derivuara janë të paktën pjesë e materialit i cili i nënshtrohet degradimit biologjik në kushte aerobe;

1.55. Fabrika e ko-incinerimit - nënkupton çdo fabrikë të palëvizshme ose lëvizëse qëllimi kryesor i së cilës është gjenerimi i energjisë ose prodhimit të produkteve materiale siç janë përcaktuar në legjislacionin në fuqi;

1.56. Fabrikë e incinerimit - nënkupton çdo njësi teknike të palëvizshme ose lëvizëse dhe pajisjet e dedikuara për trajtim termik të mbeturinave siç është përcaktuar në legjislacionin specifik për incinerimin e mbetjeve;

1.57. Fabrika e ushqimit të kafshëve shoqëruese - nënkupton hapësirën ose objektin për prodhimin e ushqimit të kafshëve shoqëruese ose organeve të brendshme aromatizuese (përtypsëve), siç është përcaktuar në Nenin 24 paragraf 1, nënparagraf 1.5 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022 Për përcaktimin e rregullave shëndetësore për nënproduktet shtazore dhe produktet e përfituara prej tyre të cilat nuk destinohen për konsum njerëzor;

1.58. Fabrika e procesimit - nënkupton hapësirën ose objektin për procesimin e nënprodukteve shtazore siç janë përcaktuar në Nenin 24 paragraf 1, nënparagraf 1.1 të Udhëzimit Administrativ 05/2022 Për përcaktimin e rregullave shëndetësore për nënproduktet shtazore dhe produktet e përfituara prej tyre të cilat nuk destinohen për konsum njerëzor;

1.59. Fabrika e përpunimit - nënkupton fabrikat ose objektet për përpunimin e nënprodukteve shtazore siç përcaktohet në nenin 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 Për përcaktimin e rregullave shëndetësore për nënproduktet shtazore dhe produktet e përfituara prej tyre të cilat nuk destinohen për konsum njerëzor, të cilat nënprodukte shtazore përpunohen në përputhje me Shtojcën II dhe Shtojcën VIII të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.60. Vendi për rritje - nënkupton materialet duke përfshirë dheun e vazove, përveç dheut në tokë në të cilin rriten bimët dhe kërpudhat dhe që përdoret pavarësisht nga dheu i tokës;

1.61. Kriter i higjienës së procesit - nënkupton një kriter që tregon funksionimin e pranueshëm të procesit të prodhimit. Një kriter i tillë nuk është i zbatueshëm për produktet e vendosura në treg. Ai vendos një vlerë treguese të kontaminimit mbi të cilën kërkohen veprime korrigjuese për të ruajtur higjienën e procesit në përputhje me kërkesat e përgjithshme për sigurinë ushqimit për kafshë;

1.62. Autoriteti kompetent - nënkupton Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë;

1.63. Udhëzim Administrativ (MBPZHR)-NR.05/2022 për Përcaktimin e Rregullave Shëndetësore për Nën Produktet Shtazore dhe Produkte të Derivuara që nuk janë të Destinuara për Konsum nga Njeriu (tani e tutje në tere tekstin e këtij udhëzimi administrativ do të përdoret Udhëzim Administrativ (MBPZHR)-NR.05/2022).

Neni 4

Pika e fundit në zinxhirin e prodhimit të produkteve të caktuara të derivuara

1. Produktet e derivuara mund të vendosen në treg, përveç ato të importuara, pa kufizime, siç është përcaktuar në Nenin 5 paragrafi 3 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022, si në vijim:

1.1. biodizeli i cili përmbush kërkesat për hudhje dhe përdorim të produkteve të derivuara të përcaktuara në paragrafin 2, nënparagrafin 2.2, Nëkapitullin 3, Kapitulli IV, Shtojca II të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.2. ushqimi i përpunuar i kafshëve shoqëruese i cili plotëson kërkesat e veçanta për ushqim të përpunuar të kafshëve shoqëruese të përcaktuara në Paragrafin 7, nënparagrafi 7.1 Kapitulli II, Shtojca XI të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.3. përtypësit për qen, që përmbushin kërkesat specifike për përtypësit për qen të përcaktuar në paragrafi 7, nënparagrafin 7.2 Kapitulli II, Shtojca XI të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.4. gëzofët dhe lëkurat e thundrakëve që përmbushin kërkesat specifike për pikën e fundit të këtyre produkteve të përcaktuara në pikën C Kapitulli V, Shtojca XI të këtij Udhëzimi Administrativ;

- 1.5. leshi dhe flokët, që përmbushin kërkesat specifike për pikën e fundit për këto produkte të përcaktuara në Pikën B, Kapitulli VII, Shtojca XI të këtij Udhëzimi Administrativ;
- 1.6. puplat dhe pushi, që përmbushin kërkesat specifike për pikën e fundit për këto produkte të përcaktuara në Pikën C, Kapitulli VII, Shtojca XI të këtij Udhëzimi Administrativ;
- 1.7. gëzofi që përmbush kushtet e përcaktuara në Kapitullin VIII të Shtojcës XI të këtij Udhëzimi Administrativ;
- 1.8. vaj peshku për prodhimin e produkteve medicinale i cili plotëson kërkesat e veçanta për pikën përfundimtare për atë produkt të përcaktuara në Kapitullin XIII të Shtojcës XI të këtij Udhëzimi Administrativ;
- 1.9. benzina dhe lëndët djegëse të cilat plotësojnë kërkesat specifike për produktet nga procesi katalitik me shumë hapa për prodhimin e lëndëve djegëse të ripërtëritshme të përcaktuara në paragrafin 2, nënparagrafi 2.3 të nënkapitullit 3 të Kapitullit IV të Shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ;
- 1.10. produktet oleokimike të përfuara nga yndyrat e përpunuara dhe që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Kapitullin XI të Shtojcës XI të këtij Udhëzimi Administrativ;
- 1.11. naftë e rinovueshme, karburant i rinovueshëm i avionëve, propan i rinovueshëm dhe benzinë e rinovueshme që plotësojnë kërkesat specifike për produktet nga hidro-trajtimi katalitik me shumë etapa për prodhimin e karburanteve të rinovueshme të përcaktuara në paragrafin 2, nënparagrafi 2.6 të nënkapitullit 3 të Kapitullit IV të Shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ

Neni 5

Sëmundjet serioze të transmetueshme

Sëmundjet e përcaktuara nga WOAH në Nenin 1.2.3 të Kodit Terrestrial të Shëndetit të Kafshëve, dhe në Kapitullin 1.3 të Kodit të Shëndetit të Kafshëve Akuatike, konsiderohen si sëmundje serioze të transmetueshme për qëllim të kufizimeve të përgjithshme për shëndetin e kafshëve, siç është përcaktuar në Neni 6, paragraf 1, nënparagrafin 1.2.2 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022.

KAPITULLI II

HUDHJA DHE PËRDORIMI I NËNPRODUKTEVE SHTAZORE DHE PRODUKTEVE TE DERIVUARA

KUFIZIMET NË PËRDORIM TË NËNPRODUKTEVE SHTAZORE

Neni 6

Ushqyerja e kafshëve të fermave me barishte

1. Operatorët duhet të respektojnë kufizimet në ushqyerjen e kafshëve të fermave me barishte nga toka në të cilën janë aplikuar plehra organike ose përmirësues të tokës.

2. Kushtet si në vijim ~~do të~~ zbatohen në të ushqyerit e kafshëve të fermave me barishte nga toka, ose me qasje të drejtpërdrejtë të kafshëve në atë vend ose duke përdorur barishten e prerë si ushqim, me kusht që plehrat organike ose pasuruesit e tokës janë aplikuar në atë tokë:

2.1. periudha e pritjes prej së paku 21 ditësh të përcaktuar në Nenin 11 paragraf 1, nënparagraf 1.3 të Udhëzimit Administrativ; (MBPZHR) Nr.05/2022 duhet të vëzhgohet;

2.2. janë përdorur vetëm plehrat organike dhe pasuruesit e tokës që janë në përputhje me Nenin 32 paragrafin 1 dhe paragrafin 4 të Udhëzimit Administrativ; (MBPZHR) Nr.05/2022 dhe me Kapitullin II të Shtojcës IX këtij Udhëzimi Administrativ.

3. Kushtet nga paragrafi 2 i këtij neni nuk do të zbatohen, vetëm nëse plehrat organike dhe pasuruesit e tokës janë aplikuar në tokë:

3.1. plehu dhe glasat;

3.2. përmbajtjet e traktit digjektiv, qumështi, produktet me bazë qumështi, produktet e derivuara nga qumështi, kulloshtira dhe produktet e kulloshtres, të cilat autoriteti kompetent nuk i konsideron se paraqesin rrezik për përhapjen e ndonjë sëmundje serioze të kafshëve.

Neni 7

Hudhja me incinerim dhe ko-incinerim dhe shfrytëzimi si lëndë për djegie

1. Autoriteti kompetent do të sigurojë se incinerimi dhe ko-incinerimi i nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara do të bëhet vetëm nëse:

1.1. në fabrikat e incinerimit dhe ko-incinerimit të cilave i'u është dhënë aprovimi në pajtim me Ligjin perkates për mbeturina; dhe

1.2. për fabrikat që nuk kërkohet të aprovohen me Ligjin perkates për mbeturina, në fabrikat e incinerimit dhe ko-incinerimit të cilave u është dhënë aprovimi nga autoriteti kompetent që të kryejnë hudhjen me incinerim, ose hudhjen ose ripërpunimin e nënprodukteve shtazore ose produkteve të derivuara, nëse ato janë mbeturina, me anë të ko-incinerimit, në pajtim me Nenin 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të Udhëzimit Administrativ; (MBPZHR) Nr.05/2022.

2. Autoriteti kompetent do të aprovojë vetëm fabrikat e incinerimit dhe ko-incinerimit siç është përcaktuar në nënparagrafin 1.2, në pajtim me Nenin 24 paragrafin 1, nënparagrafin 1.2 dhe 1.3 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022, nëse përmbushin kërkesat e përcaktuara në Shtojcën I të këtij Udhëzimi Administrativ.

3. Operatorët e fabrikave të incinerimit dhe ko-incinerimit do të plotësojnë kërkesat e përgjithshme për incinerim dhe ko-incinerim të përcaktuara në Kapitullin I të Shtojcës I të këtij Udhëzimi Administrativ.
4. Operatorët e fabrikave të incinerimit dhe ko-incinerimit me kapacitet të lartë do të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Kapitullin II të Shtojcës I të këtij Udhëzimi Administrativ;
5. Operatorët e fabrikave të incinerimit dhe ko-incinerimit me kapacitet të ulët do të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Kapitullin III të Shtojcës I të këtij Udhëzimi Administrativ;
6. Operatorët duhet të sigurojnë që fabrikat me djegie të ndryshme nga ato të përcaktuara në Nënkapitullin 2 , Kapitulli IV, Shtojca II të këtij Udhëzimi Administrativ që janë nën kontrollin e tyre në të cilat nënproduktet shtazore ose produktet e fituara përdoren si lëndë djegëse, të jenë në përputhje me kushtet e përgjithshme dhe kërkesat specifike të përcaktuara në kapitujt IV dhe V të Shtojcës I të këtij Udhëzimi Administrativ, dhe janë miratuar nga autoriteti kompetent në pajtim me nenin 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR)-Nr. 05/2022 i cili përcakton Rregullat shëndetësore për nënproduktet shtazore dhe produktet e derivuara prej tyre që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor.
7. Autoriteti kompetent do të miratojë vetëm impiantet me djegie të përcaktuara në paragrafin 6 të këtij neni për përdorimin e nënprodukteve shtazore dhe produkteve të përfituara si lëndë djegëse për djegie, me kusht që:
 - 7.1. impiantet me djegie hyjnë në objektin e kapitullit V të shtojcës I të këtij Udhëzimi Administrativ;
 - 7.2. impiantet e djegies janë në përputhje me të gjitha kushtet përkatëse të përgjithshme dhe kërkesat specifike të përcaktuara në Kapitujt IV dhe V të Shtojcës I të këtij Udhëzimi Administrativ;
 - 7.3. ekzistojnë procedura administrative për të siguruar që kërkesat për miratimin e impianteve të djegies të kontrollohen çdo vit.
8. Për përdorimin e plehut organik të kafshëve të kultivuara ose miellit të mishit dhe kockave si lëndë djegëse për djegie, siç përcaktohet në kapitullin V të Shtojcës I të këtij Udhëzimi Administrativ, përveç atyre të përcaktuara në paragrafin 7, zbatohen edhe rregullat si ne vijim të këtij neni:
 - 8.1. aplikacioni për miratim që i dorëzohet nga operatori autoritetit kompetent në pajtim me nenin 24 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, duhet të përmbajë dëshmi të vërtetuara nga autoriteti kompetent ose nga një organizatë profesionale e autorizuar nga autoriteti kompetent, se fabrika e djegies në të cilin plehu i kafshëve të kultivuara ose mielli i mishit dhe kockave përdoret si lëndë djegëse plotëson kërkesat të përcaktuara në pikën B, paragrafi 3 për plehun organik, dhe pika D në rastin e miellit të mishit dhe kockave, si dhe kërkesat e përcaktuara për të dy lëndët djegëse në pikën B, paragrafi 4 dhe 5 të Kapitullit V të Shtojcës I të këtij Udhëzimi Administrativ pa paragjykuar

mundësinë e autoriteteve kompetente për të akorduar heqjen nga pajtueshmëria me dispozita të percaktuara në përputhje me pikën C, paragrafi 5 i kreut V të Shtojcës I;

8.2. Procedura për aprovim e percaktuar në nenin 44 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, nuk do të finalizohen pa kaluar së paku dy herë radhazi kontrollet, njëri pas tjetrit pa paparalajmërim nga autoriteti kompetent ose nga një organizatë profesionale e autorizuar nga ai autoritet, gjatë gjashtë muajve të parë të funksionimit të fabrikës së djegies, duke përfshirë matjet e nevojshme të temperaturës dhe shkarkimeve. Pasi rezultatet e këtyre kontrolleve të tregojnë përputhshmëri me kërkesat e percaktuara në pikat B, paragrafi 3, 4 dhe 5 për plehun organik dhe pikën D për miellin e mishit dhe kockave dhe, sipas rastit, me pikën C, paragrafin 4 ose pikën D paragrafi 5 i Kapitullit V të Shtojcës I të këtij Udhëzimi Administrativ, mund të jepet miratimi i plotë;

8.3. djegia e miellit të mishit dhe kockave në fabrikat për djegie të cekura në pikat A, B dhe C të Kapitullit V të Shtojcës I të këtij Udhëzimi Administrativ nuk do të autorizohen.

Neni 8

Vendgroposja e materialeve të caktuara të Kategorisë 1 dhe 3

1. Me anë të derogimit nga Neni 12 dhe Neni 14 paragrafin 14 nënparagrafin 1.3 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, autoriteti kompetent mund të autorizojë hudhjen e materialeve të Kategorisë 1 dhe 3 si në vijim në vendgroposjet e autorizuara:

1.1. ushqimi i importuar për kafshë shoqëruese ose ushqimi për kafshë shoqëruese i prodhuar nga materialet e importuara, nga materiali i Kategorisë 1 i percaktuar në Nenin 8 paragrafi 1 dhe nënparagrafi 1.3 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr.05/2022;

1.2. materiali i Kategorisë 3 i percaktuar në Nenin 10 të paragrafit 1 dhe nënparagrafit 1.6 dhe 1.7 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022, nëse:

1.2.1. materialet e tilla nuk kanë qenë në kontakt me ndonjë nënprodukt shtazore të percaktuar në Nenet 8, 9 dhe Nenin 10 paragrafit 1 nënparagrafit 1.1-1.5, 1.8-1.16 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr.05/2022;

1.2.2.. në kohën kur destinohen për hudhje, materialet e:

1.2.2.1.percaktuara në Nenin 10 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022, janë nënshtruar procesimit siç është percaktuar në Regulloren për higjienën e prodhimeve, dhe

1.2.2.2. përcatuar në Nenin 10 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022 të procesuar në pajtim me Kapitullin II të Shtojcës VIII të këtij Udhëzimi Administrativ ose në pajtim me kërkesat specifike për ushqim të kafshëve shoqëruese të vendosura në Kapitullin II të Shtojcës XI të këtij Udhëzimi Administrativ ; dhe

1.2.2.3. hudhja e materialeve të tilla nuk paraqet ndonjë rrezik për shëndetin publik ose të kafshëve.

Neni 9

Kërkesat për fabrikat e procesimit dhe ndërmarrjet e tjera

1. Operatorët do të sigurohen se fabrikat e procesimit dhe ndërmarrjet tjera nën kontrollin e tyre i plotësojnë kërkesat si në vijim të përcaktuara në Kapitullin I të Shtojcës II-të këtij Udhëzimi Administrativ:

1.1. kushtet e përgjithshme për procesim të përcaktuara në Kapitullin 1;

1.2. kërkesat për trajtim të ujërave të zeza të përcaktuara në Kapitullin 2;

1.3. kërkesat specifike për procesim të materialeve të Kategorisë 1 dhe 2 të përcaktuara në Kapitullin 3;

1.4. kërkesat specifike për procesim të materialeve të Kategorisë 3 të përcaktuara në Kapitullin 4.

2. Autoriteti kompetent do të miratojë vetëm fabrikat e procesimit dhe ndërmarrjet e tjera, nëse ato i plotësojnë kushtet e përcaktuara në Kapitullin I të Shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 10

Kërkesat e higjienës dhe procesimit për fabrikat e procesimit dhe ndërmarrjet tjera

1. Operatorët do të sigurohen se ndërmarrjet dhe fabrikat nën kontrollin e tyre i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Kapitullin I të Shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ si:

1.1. kërkesat e higjienës dhe procesimit të përcaktuara në Kapitullin II;

1.2. metodat standarde të procesimit të përcaktuara në Kapitullin III, nëqoftëse metodat e tilla përdoren në ndërmarrje ose fabrikë;

1.3. metodat alternative të procesimit të përcaktuara në Kapitullin IV, nëqoftëse metodat e tilla përdoren në ndërmarrje ose fabrikë.

Neni 11

Kërkesat në lidhje me transformimin e nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara në biogaz dhe kompostim

1. Operatorët do të sigurohen se ndërmarrjet dhe fabrikat nën kontrollin e tyre do të plotësojnë kërkesat si në vijim për transformim të nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara në biogaz dhe kompostim të përcaktuara në Kapitullin I të Shtojcës III të këtij Udhëzimi Administrativ:

- 1.1. Kërkesat e zbatueshme në fabrikat e biogazit dhe kompostimit të përcaktuara në Kapitullin I;
 - 1.2. Kërkesat higjienike të zbatueshme për fabrika të biogazit dhe kompostimit të përcaktuara në Kapitullin II;
 - 1.3. Parametrat standarde të transformimit të përcaktuara në Nënkapitullin 1 të Kapitullit III;
 - 1.4. Standardet për mbetjet e tretjes dhe kompostimit të përcaktuara në Nënkapitullin 3 të Kapitullit III.
2. Autoriteti kompetent do të miratojë vetëm fabrikat e biogazit dhe kompostimit, nëse ato i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Shtojcën III-të këtij Udhëzimi Administrativ.

3. Autoriteti kompetent mund të autorizojë përdorimin e parametrave alternativ të transformimit për fabrika të biogazit dhe kompostimit që i'u nënshtrohen kërkesave të përcaktuara në Nënkapitulli 2, Kapitulli III, Shtojca III - të këtij Udhëzimi Administrativ.

KAPITULLI III

DEROGIMI NGA DISA DISPOZITATË UDHËZIMIT ADMINISTRATIV (MBPZHR) – Nr. 05/2022 I CILI PÛRCAKTON RREGULLAT SHËNDETËSORE PÛR NËN – PRODUKTE SHTAZORE DHE PRODUKTET E DERIVUARA QË NUK JANË TË DESTINUARA PÛR KONSUM NGA NJERËZIT

Neni 12

Regullat e veçanta mbi mostrat e hulumtimit dhe diagnostikimit

1. Autoriteti kompetent mund të autorizojë transportin, përdorimin dhe hudhjen e mostrave të hulumtimit dhe diagnostifikimit, nën kushtet që sigurojnë kontrollin e rreziqeve për shëndetin publik dhe të kafshëve. Autoriteti kompetent do të sigurohet në veçanti se operatorët plotësojnë kërkesat e Kapitullit I të Shtojcës IV të këtij Udhëzimi Administrativ.
2. Operatorët do të plotësojnë regullat e veçanta për mostrat e hulumtimit dhe diagnostikimit të përcaktuara në Kapitullin I të Shtojcës IV të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 13

Regullat e veçanta për mostrat e tregtimit dhe njësitë e ekspozimit

1. Autoriteti kompetent mund të autorizojë transportin, përdorimin dhe hudhjen e mostrave të tregtimit dhe njësite të ekspozimit nën kushte të cilat sigurojnë kontrollin e rreziqeve për shëndetin publik dhe të kafshëve. Autoriteti kompetent do të sigurojë në veçanti se operatorët do të plotësojnë kërkesat e paragrafit 2, 3 dhe 4 të Nënkapitullit 1, Kapitullit I, Shtojcës IV të këtij Udhëzimi Administrativ .
2. Operatorët do të plotësojnë regullat e veçanta për mostrat e tregtimit dhe njësitë e ekspozimit të përcaktuara në Nënkapitullin 2, Kapitullin I, Shtojcën IV të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 14

Regullat e veçanta të ushqyerjes së kafshëve

1. Operatorët mund të ushqejnë me material të Kategorisë 2 kafshët si në vijim, nëqoftëse materiali vjen nga kafshët që nuk janë vrarë ose nuk kanë ngordhur si rezultat i pranisë ose dyshimit të pranisë së ndonjë sëmundje të transmetueshme tek njerëzit ose kafshët, që i nënshtrohen plotësisht të kërkesave të përgjithshme të përcaktuara në Nënkapitullin 1, Kapitullin II, Shtojcën IV të këtij Udhëzimi Administrativ dhe çdo kushti që mund të përcaktohet nga autoriteti kompetent:

- 1.1. kafshët e kopshtit zoologjik;
- 1.2. kafshët me gëzof;
- 1.3. qentë prej tufave të njohura ose grupet e zagarëve;
- 1.4. qentë dhe macet nga strehimoret;
- 1.5. larvat dhe krimbat për karrem peshkimi.
- 1.6. kafshët e cirkut.

2. Operatorët mund të ushqejnë me material të Kategorisë 3 kafshët në vijim që i nënshtrohen kërkesave të përgjithshme të përcaktuara në Nënkapitullin 1, Kapitullin II, Shtojcën IV të këtij Udhëzimi Administrativ dhe çdo kushti tjetër që mund të përcaktohet nga autoriteti kompetent:

- 2.1. kafshët e kopshtit zoologjik;
- 2.2. kafshët me gëzof;
- 2.3. qentë prej tufave të njohura ose grupet e zagarëve;
- 2.4. qentë dhe macet nga strehimoret;
- 2.5. larvat dhe krimbat për karrem peshkimi, dhe
- 2.6. kafshët e cirkut.

Neni 15

Ushqyerja e specieve të caktuara brenda dhe jashtë stacioneve të ushqyerjes dhe në kopshte zoologjike

1. Autoriteti kompetent mund të autorizojë përdorimin e materialit të Kategorisë 1 që përbëhet nga tërë trupi ose pjesët e kafshëve të ngordhura që përmbajnë material të specifikuar të rrezikshëm për ushqyerje kur:

1.1. në stacion të ushqyerjes, të specieve të rrezikuara ose të mbrojtura të zogjëve nekrofag dhe specieve tjera që jetojnë në habitatin e tyre natyral, për promovim të biodiversitetit, që i nënshtrohet plotësisht të kushteve të përcaktuara në Nënkapitullin 2, Kapitullin II, Shtojcës IV të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.2. jashtë stacioneve të ushqyerjes, nëse është e përshtatshme pa grumbullim paraprak të kafshëve të ngordhura, të kafshëve të egra të përcaktuara në paragrafin 1 nënparagrafi 1.1 të Nënkapitullit 2, Kapitullit II, Shtojcës IV të këtij Udhëzimi Administrativ, që i nënshtrohet kushteve të përcaktuara në Nënkapitullin 3, Kapitullin II, Shtojcës IV të këtij Udhëzimi Administrativ.

2. Autoriteti kompetent mund të autorizojë përdorimin e materialit të Kategorisë 1 që përbëhet nga tërë trupi ose pjesët e kafshëve të ngordhura që përmbajnë material të specifikuar të rrezikshëm dhe përdorimin e materialeve të derivuara nga kafshët e kopshtit zoologjik për ushqyerje të kafshëve të kopshtit zoologjik që i nënshtrohen plotësisht të kushteve të përcaktuara në Nënkapitulli 4, Kapitullin II, Shtojcës IV.

Neni 16

Rregullat e veçanta për grumbullim dhe hudhje

1. Nëse autoriteti kompetent autorizon hudhjen e nënprodukteve shtazore me anë të derogimit të përcaktuar në Nenin 19 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.5 dhe 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR)- Nr.05/2022. Hudhja do të plotësojë rregullat e veçanta si në vijim të përcaktuara në Kapitullin III, Shtojca IV e këtij Udhëzimi Administrativ:

1.1. rregullat e veçanta të hudhjes për nënproduktet shtazore të përcaktuara në Nënkapitulli 1, Kapitulli III, Shtojca IV të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.2. rregullat për djegien dhe groposjen e nënprodukteve shtazore në zonat e thella të përcaktuara në Nënkapitulli 2, Kapitulli III, Shtojca IV të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.3. rregullat për djegie dhe groposje të bletëve dhe nënprodukteve të apikultures të përcaktuara në Nënkapitullin 3, Kapitullin III, Shtojca IV të këtij Udhëzimi Administrativ .

2. Me përjashtim nga neni 14 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, autoriteti kompetent mund të autorizojë grumbullimin, transportin dhe asgjësimin të sasive të vogla të materialeve të Kategorisë 3, siç përcaktohet në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 i atij Udhëzimi Administrativ me mjetet e përcaktuara në nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 i atij Udhëzimi Administrativ, në varësi të respektimit të kërkesave për asgjësim me mjetet tjera të përcaktuara në Kapitullin IV të Shtojcës IV të këtij Udhëzimi Administrativ.

KAPITULLI IV

AUTORIZIMI I METODAVE ALTERNATIVE

Neni 17

Formati standard për aplikim për autorizim të metodave alternative

1. Aplikimet për autorizim të metodave alternative të përdorimit ose hüdhes së nënprodukteve shtazore ose produkteve të derivuara, të përcaktuara në Nenin 20 paragrafi 1 të këtij Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022, do të dorëzohen nga vendet ose palët e interesuara në pajtim me kërkesat e formatit standard për aplikim për metoda alternative të përcaktuara në Shtojcan V të këtij Udhëzimi Administrativ.

2. Autoriteti Kompetent do të përcaktoj rregulla për autorizim të metodave alternative.

KAPITULLI V

GRUMBULLIMI, TRANSPORTI, IDENTIFIKIMI DHE GJURMUESHMËRIA

Neni 18

Kërkesat në lidhje me dokumentet komerciale dhe certifikatat shëndetësore, grumbullimin dhe transportin e nënprodukteve shtazore dhe gjurmueshmërinë

1. Operatorët do të sigurohen se nënproduktet shtazore dhe produktet e derivuara se:

1.1. i plotësojnë kërkesat për grumbullim, transport dhe identifikim të përcaktuara në Kapitullin I dhe II të Shtojcës VI të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.2. shoqërohen gjatë transportit me dokumente komerciale dhe certifikata shëndetësore në pajtim me kërkesat e përcaktuara në Kapitullin III të Shtojcës VI të këtij Udhëzimi Administrativ.

2. Operatorët që dërgojnë, transportojnë ose pranojnë nënprodukte shtazore ose produkte të derivuara do të mbajnë regjistra të dërgesave dhe dokumente komerciale dhe certifikata shëndetësore në lidhje me to në pajtim me kërkesat e përcaktuara në Kapitullin IV të Shtojcës VI të këtij Udhëzimi Administrativ.

3. Operatorët do të plotësojnë kërkesat për shënjim të produkteve të caktuara të derivuara të përcaktuara në Kapitullin V të Shtojcës VI të këtij Udhëzimi Administrativ.

KAPITULLI VI

REGJISTRIMI DHE APROVIMI I NDËRMARRJEVE DHE FABRIKAVE

Neni 19

Kërkesat në lidhje me aprovimin e një apo më shumë ndërmarrjeve dhe fabrikave që përpunojnë nënprodukte shtazore në vendndodhjen e njëjtë

Autoriteti kompetent mund të jap aprovim për më shumë se një ndërmarrje ose fabrikë që përpunon nënprodukte shtazore në vendndodhjen e njëjtë, në qoftëse transmetimi i rreziqeve për shëndet publik dhe të kafshëve ndërmjet ndërmarrjeve ose fabrikave përshtohet nga planprojekti i tyre dhe mënyra e trajtimit të nënprodukteve shtazore dhe produkteve të përfituara brenda ndërmarrjeve ose fabrikave.

Neni 20

**Kërkesat që kanë të bëjnë me ndërmarrje dhe fabrika të caktuara të aprovuara që
përpunojnë nënprodukte shtazore dhe produkte të derivuara**

1. Operatorët sigurohen se ndërmarrjet dhe fabrikat nën kontrollin e tyre, të cilat janë aprovuar nga autoriteti kompetent, do të plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Kapitujt si në vijim të Shtojcës VII të këtij Udhëzimi Administrativ ku ata kryejnë një ose më shumë nga aktivitetet e përcaktuara në Nenin 24 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022 si:

1.1 kapitulli I, ku ata prodhojnë ushqim për kafshë shoqëruese siç përcaktohet në nenin 24 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022;

1.2 kapitulli II, ku ata magazinojnë nën produktet shtazore siç përcaktohet në Nenin 24 paragrafi 1 nënparagrafi 1.9 të Udhëzimit Administrativ 05/2022 dhe ku ata trajtojnë nënproduktet shtazore pas grumbullimit të tyre, me anë të operimeve të përcaktuara në Nenin 24 paragrafi 1 nënparagrafi 1.8 i këtij Udhëzimi Administrativ si në vijim:

1.2.1. klasifikimi;

1.2.2. prerja;

1.2.3. ftofja;

1.2.4. ngrirja;

1.2.5. kryposja;

1.2.6. konzervimi me procese tjera;

1.2.7. heqja e gëzofëve dhe lëkurave ose heqja e materialeve të specifikuara si të rrezikshme;

1.2.8. operimet që përfshijnë trajtimin e nënprodukteve shtazore që kryhen në pajtim me kërkesat e Ligjislacionit përkatës ne fuqi;

1.2.9. higjiena ose pasterizimi i nënprodukteve shtazore të destinuara për transformim në biogas ose kompostim, para transformimit të tillë ose kompostimit në një ndërmarrje ose fabrikë tjetër në pajtim me Shtojcën III të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.2.10. sitja;

1.2.11. proceset e tranzicionit fazor të materialeve të kategorisë 3, siç janë:

1.2.11.1.termokoagulimi i gjakut;

1.2.11.2.centrifugimi i gjakut;

1.2.11.3.hidrolizimi i thundrave, qimeve të derrit, puplave dhe qimeve të destinuara për përpunim me metodat e përpunimit të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ.

1.3 kapitulli III, ku ata magazinojnë produktet e derivuara për qëllime të caktuara të përcaktuara në Nenin 24 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022;

1.4 kapitulli V, ku ruhen në fermë nënproduktet e kafshëve të përcaktuara në nënparagrafin 1.8 ose 1.9 të nenit 24, paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR)-Nr.05/2022;

1.5 kur operacionet e përcaktuara në nënparagrafët 1.2.1 deri në 1.2.7 dhe 1.2.11 të këtij neni kryhen në lokacionin e objektit ose fabrikës së aprovuar sipas nenit 26, paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 që gjenerojnë ato materiale, autoriteti kompetent mund të autorizojë operimin pa regjistrim në përputhje me nenin 23 të këtij Udhëzimi Administrativ ose miratimin në përputhje me nenin 24, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8 i këtij Udhëzimi Administrativ, me kusht që nënproduktet e kafshëve të ruhen, transportohen dhe asgjësohen ose përdoren si nënprodukte të papërpunuara shtazore në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022.

Neni 21

Kërkesat në lidhje me ndërmarrjet dhe fabrikat e caktuara të regjistruara që përpunojnë nën produkte shtazore dhe produkte të derivuara

1. Fabrikat ose ndërmarrjet e regjistruara ose operatorët e tjerë të regjistruar do të përpunojnë nënproduktet shtazore dhe produktet e derivuara në kushtet e përcaktuara në Kapitullin II të Shtojcës VII të këtij Udhëzimi Administrativ.
2. Operatorët e regjistruar që transportojnë nën produkte shtazore ose produkte të derivuara, në vend tjetër në mes hapësirave të të njëjtit operator, duhet të plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën 2 të Kapitullit IV të Shtojcës VII të këtij Udhëzimi Administrativ.
3. Përfundimisht paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk do të zbatohen për:
 - 3.1 operatorët e aprovuar që transportojnë nën produkte shtazore ose produkte të derivuara si aktivitet ndihmës;
 - 3.2 operatorët që kanë qenë të regjistruar për aktivitete transporti në pajtim me Udhëzimin Administrativ për ushqim për kafshë.
4. Autoriteti kompetent mund të lirojë operatorët si në vijim nga obligimi për të njoftuar, siç është përcaktuar në Nenin 23 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) 05/2022 nëse:

4.1. operatorët që përpunojnë ose gjenerojnë trofetë e gjahut ose preparatet e tjera të percaktuara në Kapitullin VI të Shtojcës XI të këtij Udhëzimi Administrativ për qëllime private ose jo-komerciale;

4.2. operatorët që përpunojnë ose hedhin mostrat e hulumtimit dhe diagnostifikimit për qëllime edukative;

4.3. operatorët që transportojnë lesh të thatë të patrajtuar, me kusht që ato të jenë të mbyllura mirë në ambalazh dhe të dërgohen drejtpërdrejt në një fabrikë që prodhon produkte të përfituara për përdorime jashtë zinxhirit të ushqimit ose në një fabrikë që kryen operacione të ndërmjetme, në kushte që parandalojnë përhapjen e agjentëve patogjenë;

4.4. operatorët që përdorin sasi të vogla të materialeve të kategorive 2 dhe 3 të percaktuara në nenet 9 dhe 10 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 ose produkte që rrjedhin prej tyre, për qëllime të furnizimit të drejtpërdrejtë të produkteve brenda rajonit të përdoruesi përfundimtar, në tregun lokal ose në objektet lokale të shitjes me pakicë, nëse autoriteti kompetent nuk e konsideron një aktivitet të tillë si rrezik për përhapjen e ndonjë sëmundjeje serioze të transmetueshme në njerëzit ose kafshët. Kjo pikë nuk do të zbatohet kur këto materiale përdoren si ushqim për kafshët e kultivuara përveç kafshëve me gëzof;

4.5. përdoruesit e plehrave organike ose përmirësuesve të tokës në ambientet ku nuk mbahen kafshë të kultivuara;

4.6. operatorët që trajtojnë dhe shpërndajnë plehra organike ose përmirësues të tokës ekskluzivisht në ambalazhe të gatshme për shitje me pakicë me peshë jo më shumë se 50 kg për përdorime jashtë zinxhirit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

Neni 22

Listat e ndërmarrjeve, fabrikave dhe operatorëve

1. Autoriteti kompetent do të sigurojë që listat e përditësuara të ndërmarrjeve, fabrikave dhe operatorëve, të percaktuara në nenin 47, paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 si:

1.1. janë hartuar në përputhje me specifikimet teknike të publikuara në faqen e internetit të Komisionit Evropian;

1.2. mund të futen në sistemin TRACES kur kërkohet nga Komisioni Evropian.

2.. Listat e ndërmarrjeve, fabrikave dhe operatorëve publikohen në faqen e internetit të autoritetit kompetent.

KAPITULLI VII

VENDOSJA NE TREG

Neni 23

Procesimi dhe vendosja në treg e nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara për ushqyerjen e kafshëve të fermave, duke përjashtuar kafshët me gëzof

1. Operatorët do të plotësojnë kërkesat si në vijim për vendosjen në treg, përveç importit, të nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara, të destinuara për ushqyerjen e kafshëve të fermës duke përjashtuar kafshët me gëzof siç është përcaktuar në Nenin 31 paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022, të përcaktuara në Shtojcën VIII të këtij Udhëzimi Administrativ si;

1.1.kërkesat e përgjithshme për procesimin ose përpunimin dhe vendosjen në treg të përcaktuara në Kapitullin I;

1.2.kërkesat specifike për proteinat e procesuara dhe përpunuara shtazore dhe produktet tjera të derivuara të përcaktuara në Kapitullin II;

1.3.kërkesat për ushqimin e caktuar të peshkut dhe karremat e peshkimit të përcaktuara në Kapitullin III.

2. Autoriteti kompetent mund të autorizojë vendosjen në treg, përveç importit të qumështit, produkteve me bazë të qumështit dhe produktet e derivuara nga qumështi të kategorizuara si material i Kategorisë 3 në pajtim me Nenin 10 paragrafin 1, nënparagrafin 1.5,1.6 dhe 1.8 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022 dhe të cilat nuk janë procesuar në pajtim me kërkesat e përgjithshme të vendosura në Pjesën I të Nënkapitullit 4, Kapitullit II, Shtojca VIII të këtij Udhëzimi Administrativ, nëqoftëse ato materiale plotësojnë kërkesat për derogimin për vendosjen në treg të qumështit të procesuar në pajtim me standardet kombëtare të vendosura në Pjesën II të Nënkapitullit 4.

Neni 24

Vendosja në treg dhe përdorimi i fertilizuesve organik dhe pasuruesve të tokës

1. Operatorët do të plotësojnë kërkesat për vendosjen në treg, përveç importit, të fertilizuesve organik dhe pasuruesve të tokës, dhe përdorimin e produkteve të tilla, posaçërisht aplikimit të tyre në tokë, siç është përcaktuar në Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafin 1.9 dhe Nenin 32 paragrafin 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022, të vendosura në Shtojcën IX të këtij Udhëzimi Administrativ si:

1.1. Vendosja në treg e te poshteshenuarave nuk i nënshtrohen asnjë kushti të shëndetit të kafshëve;

1.2. glaset nga zogjët e egër të detit të importuar;

1.3. terrene të gatshme për rritje, të ndryshme nga ato të importit që përmbajnë më pak se:

1.3.1. 5% të volumit të produktit të derivuar nga materiali i Kategorisë 3 ose Kategorisë 2 të ndryshme nga plehu i procesuar;

1.3.2. 50% te volumit nga plehu i procesuar.

2. Kur fertilizuesi organik ose pasuruesi i tokës, i cili është prodhuar nga pluhuri i mishit dhe kockave të derivuar nga materiali i Kategorisë 2 ose nga proteinat e procesuar të kafshëve, do të aplikohet në tokë, autoriteti kompetent do të autorizojë një ose më shumë komponentë të cilët duhet të përzihen me ato materiale, të përcaktuara me Nenin 32 paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022, sipas kritereve të vendosura në pikën 3 të Nënkapitullit 1 të Kapitullit II të Shtojcës IX të këtij Udhëzimi Administrativ.

3. Autoriteti kompetent i Republikës së Kosovës vendit si vend i origjines dhe vendit të destinacionit që i ndanë një kufi i përbashkët mund të autorizojë dërgimin e plehut në mes fermave me vendndodhje në regionet e kufinjëve të këtyre dy vendeve, që i'u nënshtrohen kushteve adekuate të kontrollit të ndonjë rreziku të mundshëm për shëndetin publik dhe të kafshëve, dhe është obligim i operatorëve të mbaj regjistra adekuat që përcaktohen me marreveshje bilaterale.

4. Siç është përcaktuar në Nenin 30 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022, autoriteti kompetent inkurajon, kur është e nevojshme, hartimin, shpërndarjen dhe përdorimin e udhëzuesve nacional për praktikë të mira bujqësore për aplikimin e fertilizuesve organik dhe pasuruesve të tokës.

Neni 25

Produktet e ndërmjetme

1. Produktet e ndërmjetme të importuara brenda ose që kalojnë tranzit nëpër territorin e Republikës së Kosovës do të plotësojnë kushtet për kontrollë të rrezikut potencial për shëndet publik dhe të kafshëve të përcaktuara në Shtojcën X të këtij Udhëzimi Administrativ.

2. Produktet e ndërmjetme të cilat janë transportuar në ndërmarrje ose fabrikë të përcaktuar në pikën 3 të Shtojcës X-të këtij Udhëzimit Administrativ mund të trajtohen pa kufizime të mëtutjeshme sipas Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, nëqoftëse:

2.1. ndërmarrja ose fabrika ka hapësira adekuate për pranimin e produkteve të ndërmjetme, të cilat parandalojnë bartjen e sëmundjeve ngjitëse tek njerëzit ose kafshët;

2.2. produktet e ndërmjetme nuk paraqesin ndonjë rrezik për bartjen e sëmundjeve ngjitëse tek njerëzit apo kafshët, për shkak të purifikimit të tyre ose trajtimeve tjera të cilave i'u janë nënshtruar nënproduktet shtazore të cilat përbëjnë produktet e ndërmjetme, për shkak të koncentrimit të nënprodukteve shtazore në produktet e ndërmjetme ose për shkak të masave adekuate të biosigurisë për trajtimin e produkteve të ndërmjetme;

2.3. ndërmarrja ose fabrika mban shënime në regjistra mbi sasinë e materialeve të pranuar, kategorinë e tyre, nëse është e aplikueshme, dhe ndërmarrjeve, fabrikave ose operatorëve të cilët ata i kanë furnizuar me produktet e tyre; dhe

2.4. materialet e ndërmjetme të papërdorura ose materialet e tjera të tepërta nga ndërmarrja ose fabrika, siç janë produktet me afat të skaduar, hudhen në pajtim me Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022.

3. Operatori ose pronari i ndërmarrjes ose fabrikës së destinuar për produkte të ndërmjetme ose përfaqësuesi i tyre do të përdorë ose dërgojë produktet e ndërmjetme në mënyrë ekskluzive për përzierje, mbështjellje, mbledhje, paketim ose etiketim të metejshëm sipas nën paragrafit 1.35 të Nenit 3 të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 26

Ushqimi për kafshë shoqëruese dhe produktet tjera të derivuara

1. Përdorimi i materialit të Kategorisë 1 të përcaktuar në Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, 1.2, 1.4 dhe 1.5 të Udhëzimit Administrativ 05/2022 për prodhim të produkteve të derivuara të cilat synohen të konsumohen ose aplikohen tek njerëzit ose kafshët, i ndryshëm nga produktet e derivuara të përcaktuara në Nenet 33 dhe 36 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022 do të ndalohet.

2. Aty ku nënprodukti shtazor ose produkti i derivuar mund të përdoret për ushqim të kafshëve në ferma ose për qëllime tjera të përcaktuara në Nenin 36 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022, do të vendosen në treg, përveç atyre të importuara, në pajtim me kërkesat specifike për proteinat e procesuara shtazore dhe produktet tjera të derivuara të përcaktuara në Kapitullin II të Shtojcës VIII të këtij Udhëzimit Administrativ nëqoftëse Shtojca XI i këtij Udhëzimi Administrativ nuk përcakton kërkesa specifike për produkte të tilla.

3. Operatorët do të plotësojnë kërkesat për vendosjen në treg, përveç atyre nga importimi, të ushqimeve për kafshë shoqëruese, të përcaktuara në Nenin 40 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022 të përcaktuara në Kapitujt I dhe II të Shtojcës XI të këtij Udhëzimi.

4. Operatorët do të plotësojnë kërkesat për vendosjen në treg, përveç atyre nga importi, të produkteve të derivuara, siç përcaktohen në nenin 40 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022 të përcaktuara në Kapitullin I dhe Kapitujt III deri XII të shtojcës XI të këtij udhezimi administrativ.

KAPITULLI VIII

IMPORTI, TRANZITI DHE EKSPORTI

Neni 27

Importi, tranziti dhe eksporti i nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara

1. Ndalohet importi dhe tranziti në Republikën e Kosovës për nënproduktet shtazore si në vijim:

1.1. Plehu i papërpunuar;

1.2. leshi dhe qimet që janë larë në fabrikë ose që janë trajtuar me metodë tjetër që nuk siguron se nuk mbetet asnjë rrezik i papranueshëm;

1.3. Dylli i bletëve në formë të vojshtinës.

2. Importi dhe tranziti në territorin e Republikës së Kosovës i nënprodukteve shtazore në vijim nuk i nënshtrohet kushteve të shëndetit të kafshëve

2.1. leshi dhe qimet që janë larë në fabrikë ose që janë trajtuar me metodë tjetër që siguron se nuk mbetet asnjë rrezik i papranueshëm;

2.2. gëzofët që janë tharë në temperaturë të ambientit prej 18°C për një periudhë prej së paku dy ditësh në lagështi prej 55%;

2.3. leshi dhe qimet e prodhuara nga kafshë të ndryshme nga ato të specieve të derrit, të cilat janë trajtuar me larje fabrike që konsiston në zhytjen e leshit dhe të flokëve në seri banjash me ujë, sapun dhe hidroksid natriumi ose hidroksid kaliumi;

2.4. leshi dhe qimet e prodhuara nga kafshë të ndryshme nga ato të specieve të derrit, të cilat dërgohen drejtpërdrejt në një fabrikë që prodhon produkte nga leshi dhe flokët për industrinë e tekstilit dhe është trajtuar me të paktën një nga metodat si ne vijim:

2.4.1. depilimi kimik me anë të gëlqeres së shuar ose sulfurit të natriumit;

2.4.2. tymosje në formaldehyd në një dhomë të mbyllur hermetikisht për të paktën 24 orë;

2.4.3. pastrim industrial i cili konsiston në zhytjen e leshit dhe qimeve në një detergjent të tretshëm në ujë të mbajtur në 60 - 70 °C;

2.4.4. magazinimi dhe ruajtja, të cilat mund të përfshijnë kohën e udhëtimit, në 37°C për tetë ditë, 18 °C për 28 ditë ose 4 °C për 120 ditë;

2.5. leshi dhe qimet e thata dhe të mbyllura mirë në ambalazhe, të prodhuara nga kafshë të ndryshme nga ato të specieve të derrit, të destinuara për t'u dërguar në një fabrikë që prodhon produkte të prejdurhura nga leshi dhe flokët për industrinë e tekstilit dhe plotëson të gjitha kërkesat si ne vijim:

2.5.1. është prodhuar së paku 21 ditë para datës së hyrjes në Republikën e Kosovës, e mbajtur në një shtet apo rajon të saj që është;

2.5.2. Vendi i BE-së ose vend tjetër nga i cili autorizohet importi në BE i mishit të freskët të ripërtypësve.

2.6. E lire nga sëmundja Afta Epizootike dhe, në rastin e leshit dhe qimeve të deleve dhe dhive, nga lija e deleve dhe lija e dhive në përputhje me legjislacionin në fuqi;

2.7. Shoqërohet me deklaratën e importuesit siç kërkohet në përputhje me paragrafin 1, nënparagrafi 1.37 të Shtojcës XIII të këtij Udhëzimi Administrativ.

2.8. është paraqitur nga operatori në pikat e inspektimit kufitar ku ka kaluar me rezultat të kënaqshëm kontrollin e dokumentacionit.

3. Operatorët duhet të respektojnë kërkesat specifike në vijim për importim dhe transit në Republikën e Kosovës të nënprodukteve të caktuara shtazore dhe produkteve të përfituara, siç përcaktohen në nenin 41, paragrafi 3 dhe nenin 42 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR).Nr. 05/2022 të përcaktuara në Shtojcën XII të këtij Udhëzimi Administrativ.

4. Kërkesat specifike për importin dhe transitin e materialeve të kategorisë 3 dhe produkteve të përfituara për përdorime në zinxhirin e ushqimit, përveç për ushqim për kafshët shoqëruese ose ushqimi për kafshët me gëzof, të përcaktuara në Kapitullin I të Shtojcës XII.

5. Kërkesat specifike për importin dhe transitin e nënprodukteve shtazore dhe produkteve të përfituara për përdorime jashtë zinxhirit të ushqimit për kafshët e kultivuara, të përcaktuara në Kapitullin II të Shtojcës XII.

6. Kërkesat specifike për nënproduktet shtazore dhe produktet e përfituara që kanë origjinën dhe kthehen në Republikën e Kosovës pas refuzimit të hyrjes nga një shtet tjetër, të përcaktuara në Kapitullin VI të Shtojcës XII.

7. Rregullat e përcaktuara në Kapitullin V të Shtojcës XII do të zbatohen për eksportet nga Republika e Kosovës të produkteve të përfituara dhe të specifikuara aty.

Neni 28

Plasimi në treg, duke përfshirë importin dhe eksportin e materialeve të caktuara të Kategorisë 1

1. Autoriteti kompetent mund të autorizojë plasimin në treg, duke përfshirë importin dhe eksportin e gëzofit dhe lëkurës së prejardhur nga kafshët të cilat i'u janë nënshtruar mjekimit me substance të ndaluara që përcaktohen në legjislacionin në fuqi për ndalimin e përdorimit të disa substancave që kanë veprim hormonal dhe tirostatik (b-agonistët) dhe zorrëve të ripërtypëse me ose pa përmbajtjen e tyre dhe të kockave dhe produkteve të kockave që përmbajnë kolonën vertebrale dhe kafkën, që i nënshtrohen plotësisht të kërkesave si në vijim:

1.1. këto materiale nuk duhet të jenë materiale të Kategorisë 1 të derivuara nga ndonjë nga kafshët si në vijim:

1.1.1. kafshët e dyshuara që janë të infektuara nga semundja e TSE-se në përputhje me legjislacionin në fuqi;

1.1.2. kafshët në të cilat prania e TSE është konfirmuar zyrtarisht;

1.2. kafshët e asgjesuara në kontekstin e masave për çrrënjësimin e TSE-së;

1.3. këto materiale nuk duhet të jenë të destinuara për ndonjë nga përdorimet si në vijim:

- 1.3.1. ushqyerjen e kafsheve;
- 1.3.2. aplikimin në tokë nga e cila ushqehen kafshët e fermave;
- 1.4. prodhimin e:
 - 1.4.1. produkteve kozmetike siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi;
 - 1.4.2. pajisjeve medicinale të implantueshme aktive siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi;
 - 1.4.3. pajisjeve medicinale, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi;
 - 1.4.4. in vitro pajisjeve diagnostikuese medicinale, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi;
 - 1.4.5. produkteve medicinale veterinarë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi;
 - 1.4.6. produkteve medicinale siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi.
2. Materialet e importuara duhet të jenë të etiketuara dhe të plotësojnë kërkesat specifike për lëvizjet e caktuara të nënprodukteve shtazore të përcaktuara në Nënkapitullin 1 të Kapitullit IV të Shtojcës XII të këtij Udhëzimi Administrativ.
3. Materialet duhet të importohen në përputhje me kërkesat e certifikates përkatëse të përcaktuar me legjislacionin në fuqi.
4. Materialet me origjinë nga Republika e Kosovës dhe që kthehen në Republikën e Kosovës pas refuzimit të hyrjes nga një shtet tjetër, duhet të jenë në përputhje me kërkesat specifike të përcaktuara në Kapitullin VI të Shtojcës XII të këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 29

Importi dhe tranziti i mostrave të hulumtimit dhe diagnostikimit

1. Autoriteti kompetent mund të autorizojë importin dhe tranzitin e mostrave të hulumtimit dhe diagnostikimit, përbërë nga produktet e derivuara ose nënproduktet shtazore, duke përfshirë edhe nënproduktet shtazore të përcaktuara në Nenin 25 paragrafi 1 i këtij Udhëzimit Administrativ në përputhje me kushtet që garantojnë kontrollin e rreziqeve për shëndetin publik dhe të kafshëve si vijon:
 - 1.1. paraqitja e dërgesës duhet të ketë qenë e autorizuar paraprakisht nga autoriteti kompetent; dhe
 - 1.2. dërgesa duhet të dërgohet direkt nga pika e hyrjes në Republikën e Kosovës tek përdoruesi i autorizuar.

2. Operatorët që trajtojnë mostra të hulumtimit ose diagnostikimit duhet të plotësojnë kërkesat e veçanta për asgjësimin e mostrave të hulumtimit ose diagnostikimit të përcaktuara në Nënkapitullin 1, Kapitullin III, Shtojcën XII të këtij Udhëzimit Administrativ.

Neni 30

Importi dhe tranziti i mostrave të tregtimit dhe artikujve për ekspozim

1. Autoriteti kompetent mund të autorizojë importin dhe tranzitin e mostrave të tregtimit në përputhje me rregullat e veçanta të përcaktuara në paragrafin 1 të Nënkapitullit 2, Kapitulli III, Shtojca XII të këtij Udhëzimi Administrativ.

2. Operatorët që trajtojnë mostrat e tregtimit duhet të plotësojnë rregullat e veçanta për trajtimin dhe asgjësimin e mostrave të tregtimit të përcaktuara në paragrafet 2 dhe 3 të Nënkapitulli 2, Kapitulli III, Shtojca XII të këtij Udhëzimi Administrativ.

3. Autoriteti kompetent mund të autorizojë importin dhe tranzitin e artikujve për ekspozim në përputhje me rregullat e veçanta për artikuj për ekspozim të përcaktuara në Nënkapitulli 3, Kapitulli III, Shtojca XII e këtij Udhëzimi Administrativ.

4. Operatorët që trajtojnë artikuj për ekspozim do të zbatojnë kushtet për paketimin, trajtimin dhe asgjësimin e artikujve për ekspozim të përcaktuara në Nënkapitullin 3, Kapitullin III, Shtojca XII e këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 31

Lista e ndërmarrjeve dhe fabrikave të vendeve të tjera

1. Importi në Republikën e Kosovës lejohet vetëm nga:

1.1. operatorët e regjistruar ose të aprovuara në BE;

1.2. Nga vendet tjera të treta ndërmarrjet e regjistruara dhe aprovuara të autorizuar për të ekspozuar në BE;

1.3. Vendet tjera të regjistruara dhe aprovuara ndërmarrjet e përcaktuara në bazë të marreveshjes biletariale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe atij shteti.

Neni 32

Modelet e certifikatave shëndetësore dhe deklaratave për import dhe tranzit

1. Dërgesat e nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara për import ose tranzit nëpër territorin e Republikës Kosovës, do të shoqërohen me certifikata shëndetësore dhe dokumentacion përcjellës, në përputhje me modelet e përcaktuara në Shtojcën XIII të këtij Udhëzimit Administrativ në pikat e kalimit kufitar ku kryhen kontrollet veterinarë.

2. Lista e certifikatave veterinarë dhe shenimet e nevojshme janë të përcaktuara në Shtojcën XIII të këtij Udhëzimi Administrativ.

3. Për Modeli i certifikatave të listuara në shtojcën XIII do të merret nga sistemi i Komisionit Evropian TRACES!

4. Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, nënproduktet shtazore dhe produktet e prejardhura me origjinë shtazore që kthehen në Republikën e Kosovës pas refuzimit të hyrjes nga një shtet tjetër, duhet të jenë në përputhje me kërkesat specifike të përcaktuara në kapitullin. VI të Shtojcës XII të këtij Udhëzimi Administrativ.

KAPITULLI IX

KONTROLLET ZYRTARE

Neni 33

Kontrolli zyrtar

1. Autoriteti kompetent do të marrë masat e nevojshme për kontrollin e tërë zinxhirit të grumbullimit, transportit, përdorimit dhe asgjësimit të nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara, siç janë përcaktuar në Nenin 4 paragraf 2 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR).Nr. 05/2022. Këto masa do të zbatohen në pajtim me rregullat për konrolle zyrtare të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kontrollet zyrtare të ndërmarra për siguruar verifikimin e përputhshmësisë me ligjin për ushqimin dhe ushqimin për kafshë dhe rregullat për shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve.

2. Kontrollet zyrtare të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni do të përfshijnë konrolle mbi mbajtjen e regjistrave dhe dokumenteve tjera të kërkuara me rregullat e përcaktuara në kete Udhëzim Administrativ.

3. Autoriteti kompetent do të kryej kontrollet zyrtare siç janë përcaktuar në Nenin 45 paragrafit 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Kapitujt e Shtojcës XIV të këtij Udhëzimit Administrativ si në vijim:

3.1.kontrollet zyrtare në fabrikat e përpunimit siç janë përcaktuar në Kapitullin I;

3.2. kontrollet zyrtare të veprimtarive të tjera që përfshijnë trajtimin e nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara siç janë përcaktuar në Nënkapitullin 1 deri 9 të Kapitullit II.

4. Autoriteti kompetent do të kryejë konrolle të bllobave të cilat janë aplikuar në dërgesa të nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara.

5. Kur Autoriteti kompetent vendos një bllobë për ngarkesë të tillë e cila është transportuar në një vend të destinacionit, duhet të informojë autoritetin kompetent të vendit të destinacionit.

6. Autoriteti kompetent i vendit të destinacionit do të vendosë në bazë të kërkesës nga një operator në lidhje me pranimin ose refuzimin e materilait të caktuar të Kategorisë 1, Kategorisë 2 dhe miellit me mish-dhe-kocka ose yndyrë të kafshëve të derivuar nga materialet e Kategorise 1 dhe Kategorise 2, brenda 20 ditëve kalendarike nga data e marrjes së aplikimit të tillë me kusht që

ai është paraqitur sipas legjislacionit në fuqi për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Republikën e Kosovës.

Neni 34

Riaprovimi i fabrikave dhe ndërmarrjeve pas dhënies së aprovimit të përkohshëm

1. Kur fabrika ose ndërmarrja është aprovuar për procesim të materialeve të Kategorisë 3 dhe pastaj i është dhënë aprovimi i përkohshëm për procesimin e materialit të Kategorisë 1 dhe 2, në pajtim me Nenin 24 paragraf 2 nënparagraf 2.2 nën nënparagrafin 2.2.2 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR).Nr. 05/2022 do të jetë e ndaluar të rifillojë procesimin e materialit të Kategorisë 3, pa marrë së pari aprovimin e autoritetit kompetent për të rifilluar procesimin e materialit të Kategorisë 3 në pajtim me nenin 44 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR).Nr. 05/2022.

2. Kur aty ku fabrika ose ndërmarrja është aprovuar për procesimin e materialit të Kategorisë 2 dhe pastaj i është dhënë aprovimi i përkohshëm për procesimin e materialit të Kategorisë 1, në pajtim me Nenin 24 paragrafin 2 nënparagrafin 2.2 nën nënparagrafin 2.2.2 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, ndalohet rifillimi i procesimit të materialit të Kategorisë 2, pa e marrë së pari aprovimin e autoritetit kompetent për të rifilluar procesimin e materialit të Kategorisë 2 në pajtim me nenin 44 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022.

KAPITULLI X

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 35

Kufizimet për plasimin në treg të nënprodukteve shtazore të caktuara dhe produkteve të derivuara për shkaqe të shëndetit publik dhe të kafshëve

1. Autoriteti kompetent nuk do të ndalojë ose të kufizojë plasimin në treg të nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara si në vijim për shkaqe të shëndetit publik dhe të kafshëve jashtë dispozitave të legjislacionit në fuqi, të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ (MBPZHR).Nr. 05/2022 dhe në këtë Udhëzim Administrativ si në vijim:

1.1. proteinave të përpunuara të kafshëve dhe produkteve të tjera të derivuara të përcaktuara në Kapitullin II të Shtojcës X të këtij Udhëzimi Administrativ ;

1.2. ushqimin për kafshë shoqëruese dhe disa produkte të tjera të derivuara të përcaktuara në Shtojcën XIII të këtij Udhëzimit Administrativ;

1.3. nënproduktet shtazore dhe produktet e derivuara të importuara ose që kalojnë tranzit në Kosovë, siç janë përcaktuar në Shtojcën XIV të këtij Udhëzimit Administrativ.

Neni 36

1. Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ janë Shtojcat si në vijim:

1.1. Shtojca I: Hudhja dhe rikthimi;

- 1.2. Shtojca II: Procesimi;
- 1.3. Shtojca III: Transformimi i NPSH dhe produkteve të derivuara në biogaz, kompost;
- 1.4. Shtojca IV: Rregullat speciale mbi hulumtimin, ushqyerjen, grumbullimin dhe asgjësimin;
- 1.5. Shtojca V: Formati standard për aplikimin për metoda alternative;
- 1.6. Shtojca VI: Grumbullimi, transporti dhe gjurmueshmëria;
- 1.7. Shtojca VII: Kërkesat e aplikueshme për ndërmarrje të caktuara të aprovuara dhe regjistruara;
- 1.8. Shtojca VIII: Materialet e ushqimit të kafshëve;
- 1.9. Shtojca IX: Pleherat organike dhe përmirësuesit e tokës;
- 1.10. Shtojca X: Produktet e ndërmjetme;
- 1.11. Shtojca XI: Ushqimi për kafshë shtëpiake dhe produktet tjera derivate;
- 1.12. Shtojca XII: Importi, eksporti dhe tranziti;
- 1.13. Shtojca XIII: Modelet e Çertifikatave Shëndetësore dhe
- 1.14. Shtojca XIV: Kontrollët Zyrtarë.

Neni 37
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Faton PEÇI

Ministër i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

14/11/2023



SHTOJCA I
HUDHJA, RIPORDORIMI
DHE PËRDORIMI SI KARBURANT

KAPITULLI
KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR INCINERIM DHE KO-INCINERIM

Nënkapitulli 1
Kushtet e përgjithshme

1. Operatorët e fabrikave të incinerimit dhe ko-incinerimit të përcaktuara në Nenin 7 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të këtij Udhëzimit Administrativ do të sigurojnë që kushtet higjienike plotësohen në fabrikat nën kontrollin e tyre si vijon:

1.1. nën produktet shtazore dhe produktet e derivuara duhet të hudhen sa më shpejt që të jetë e mundur pas mbërritjes, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga autoriteti kompetent. Ato do të magazinohen siç duhet deri në hudhje, në përputhje me kushtet e përcaktuara nga autoriteti kompetent;

1.2. Fabrikat duhet të kenë përgaditjet e përshtatshme për pastrimin dhe dezinfektimin e kontejnerëve dhe automjeteve në vend, veçanërisht në zonën e caktuar nga e cila hudhen ujërat e zeza në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të shmangur rreziqet e kontaminimit;

1.3. Fabrikat duhet të jenë të vendosura në një hapësirë të mirë-drenazhuar dhe me material të fortë dhe të qëndrueshëm;

1.4. Fabrikat duhet të kenë përgaditje të përshtatshme për mbrojtjen nga dëmtuesit, siç janë insektet, brejtësit dhe zogjtë. Një program i dokumentuar për kontrollin e dëmtuesve i cili përdoret për këtë qëllim;

1.5. Personeli duhet të ketë qasje në hapësirat adekuate për higjienën personale si banjot, zhveshtoret dhe lavamanët, nëse është e nevojshme për të parandaluar rrezikun nga kontaminimi;

1.6. Procedurat e pastrimit duhet të plotësohen dhe dokumentohen për të gjitha pjesët e hapësirave. Për pastrim duhet të sigurohen pajisjet e përshtatshme dhe substancat për pastrim;

1.7. Kontrolli i higjienës duhet të përfshijë inspektime të rregullta të mjedisit dhe të pajisjeve. Oraret e inspektimit dhe rezultatet duhet të dokumentohen dhe ruhen për të paktën dy vite.

2. Operatori i fabrikës së incinerimit ose ko-incinerimit do të marrë të gjitha masat e nevojshme në lidhje me pranimin e nënprodukteve shtazore apo produkteve të derivuara për të parandaluar, ose kufizuar sa më shumë të jetë e mundur, rreziqet e drejtpërdrejta për shëndetin e njeriut ose të kafshëve.

3. Kafshët nuk duhet të kenë qasje në fabrika, nënprodukte shtazore dhe produkte të derivuara që janë në pritje të incinerimit ose ko-incinerimit ose në hirin që rezulton nga incinerimi ose ko-incinerimi i nën produkteve shtazore.
4. Nëse fabrika e incinerimit ose ko-incinerimit është e vendosur në një fermë blegtorale:
 - 4.1. duhet të ketë ndarje totale fizike mes pajisjeve të incinerimit ose ko-incinerimi, bagëtisë dhe ushqimit të tyre, shtratit me ndarje fizike kur është e nevojshme;
 - 4.2. Pajisjet duhet të dedikohen tërësisht për funksionimin e inceneratorit dhe nuk përdoren diku tjetër në prone ose, përndryshe, pastrohen dhe dezinfektohen përpara përdorimit të tillë;
 - 4.3. personeli që punon në fabrikë duhet të ndërrojnë rrobat e tyre të jashtme dhe këpucët para trajtimit të kafshëve ose ushqimit blegtoral.
5. Magazinimi i nën produkteve shtazore dhe produkteve të derivuara që janë në pritje të incinerimit ose ko-incinerimit dhe të hirit duhet të bëhet në kontejnere të mbuluar, të identifikuar si duhet dhe, nëse është e përshtatshme, të sigurt nga rrjedhja.
6. Nën produktet shtazore që nuk janë incinuar tërësisht duhet të ri digjen ose hidhen me mjete të tjera, nga hudhja në një deponi të autorizuar, në përputhje me Nenet 12, 13 dhe 14, të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022.

Nënkapitulli 2

Kushtet e operimit

Fabrikat e incinerimit ose ko-incinerimit duhet të projektohen, pajisen, ndërtohen dhe operohen në mënyrë të tillë që gazi që rezulton nga procesi ngritet në mënyrë të kontrolluar dhe homogjene, madje edhe në kushtet më të pafavorshme, në një temperaturë prej 850 ° C për të paktën 2 sekonda ose tek një temperaturë prej 1 100 ° C për 0,2 sekonda, e matur pranë murit të brendshëm ose në një pikë përfaqësimi të dhomës ku kryhet incinerimi ose ko-incinerimi, siç është autorizuar nga autoriteti kompetent.

Nënkapitulli 3

Mbetjet e incinerimit dhe ko-incinerimit

1. Mbetjet e incinerimit dhe ko-incinerimit do të minimizohen në sasi dhe dëmin që mund të shkaktojnë. Mbetjet e tilla duhet të përmiresohen, kur është e përshtatshme, drejtpërdrejt në fabrikë apo jashtë saj në përputhje me legjislacionin në fuqi ose të hidhen në një deponi të autorizuar.
2. Transporti dhe magazinimi i mbetjeve të thata, duke përfshirë pluhurin, do të zhvillohet në atë mënyrë që të parandalohet shpërndarja në mjedis, me kontejner të mbyllur.

Nënkapitulli 4

Matja e temperaturës dhe e parametrave të tjerë

1. Teknikat që do të përdoren për të monitoruar parametrat dhe kushtet relevante për procesin e incinerimit ose ko-incinerimit.
2. Miratimi i lëshuar nga autoriteti kompetent, apo kushtet e lidhura me të, do të parashtrajnë kërkesat e matjes së temperaturës.
3. Funksionimi i çdo paisjeje të automatizuar të monitorimit do t'i nënshtrohet kontrollit dhe testit vjetor të mbikqyrjes.
4. Rezultatet e matjeve të temperaturës duhet të regjistrohen dhe prezantohen në mënyrë të përshtatshme për ti mundësuar autoritetin kompetent që të verifikoj përpunjen me kushtet e lejuara të operimit të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ, në përputhje me procedurat që do të vendosen nga ai autoritet.

Nënkapitulli 5

Operimi i parregullt

Në rast të një prishjeje, apo kushteve jo të rregullta të funksionimit të një fabrike të incinerimit ose ko-incinerimit, operatori do të zvogëlojë ose do të mbyllë operacionet sa më shpejt të jetë e mundur deri sa operacionet e rregullta të mund të rifillojnë.

KAPITULLI II

FABRIKAT E INCINERIMIT DHE KOINCINERIMIT ME KAPACITET TË LARTË

Nënkapitulli 1

Kushtet specifike operative

1. Fabrikat e incinerimit dhe ko-incinerimit që trajtojnë vetëm nënproduktet shtazore dhe produktet e derivuara me një kapacitet prej më shumë se 50 kg në orë - fabrikat me kapacitet të lartë dhe të cilat nuk janë të nevojshme që të kenë një leje për të vepruar në përputhje me kushtet si vijon:

1.1. fabrikat duhet të jenë të pajisura për secilën linjë me të paktën një djegës ndihmës. Ky djegës do të ndizet automatikisht kur temperatura e gazrave të djegies pas injektimit të fundit të ajrit të djegies bie më poshtë se 850 ° C ose 1 100 ° C, si të jetë e aplikueshme. Ai gjithashtu duhet të përdoret edhe gjatë nisjes dhe përfundimit të operacioneve të fabrikës për të siguruar që temperatura prej 850 ° C ose e 1 100 ° C, si të jetë e aplikueshme, është ruajtur në çdo kohë gjatë këtyre operacioneve dhe për aq kohë sa materiali i padjegur është në dhoma ku kryhet incinerimi ose ko-incinerimi;

1.2. Kur nënproduktet shtazore apo produktet e derivuara hyjnë në dhomën ku kryhet incinerimi apo ko-incinerimit nga një proces i vazhdueshëm, fabrika duhet të operojë me një sistem automatik për të parandaluar futjen e nënprodukteve shtazore apo produkteve të derivuara kafshëve në fillim, derisa temperatura prej 850 ° C ose 1 100 ° C, si të jetë e aplikueshme, është arritur, dhe kur do që temperatura nuk mbahet.

1.3. Operatori duhet të operojë fabrikën e incinerimit në atë mënyrë që niveli i incinerimit të arrihet ashtu që përmbajtja totale e karbonit organik e zgjyrit dhe hirit në fund të jetë më pak se 3%, ose humbja e tyre në ndezje është më pak se 5% e peshës së thatë të materialit. Nëse është e nevojshme, teknikat e duhura të para-trajtimit do të përdoren.

Nënkapitulli 2 Shkarkimet e ujit

1. Vendet e fabrikave me kapacitet të lartë, duke përfshirë zonat që lidhen me magazinimin e nën produkteve shtazore, duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të parandalohet lirim i paautorizuar dhe aksidental i substancave ndotëse në tokë, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.
2. Magazinat do të sigurohet nga rrjedha e shiut të ndotur nga vendi i fabrikës ose nga uji i ndotur që vjen nga derdhjet apo operacionet e zjarrefikësve.
3. Operatori, nëse është e nevojshme, do të sigurojë që shiu dhe uji i tillë mund të testohet dhe të trajtohet para derdhjes, kur është e nevojshme.

KAPITULLI III FABRIKAT E INCINERIMIT DHE KOINCINERIMIT ME KAPACITET TË ULËT

1. Fabrikat e incinerimit dhe koincinerimit që trajtojnë vetëm nën-produktet shtazore dhe produktet e derivuara me një kapacitet maksimal prej më pak se 50 kg të nën produkteve shtazore në orë ose për grumbull - fabrikat me kapacitet të ulët dhe nga të cilat nuk kërkohet që të kenë një leje për të vepruar si vijon:

1.1. përdoren vetëm për asgjësimin e:

1.1.1. kafshëve shoqeruese të ngordhura të përcaktuara në Nenin 8 paragraf 1, nënparagrafin 1.1, nën nënparagrafin 1.1.3 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022; ose

1.1.2. materialeve të Kategorisë 1 të përcaktuara në Nenin 8, paragrafin 1 nën nënparagrafin 1.2, 1.5 dhe 1.6 materialeve të Kategorisë 2 të përcaktuara në Nenin 9 ose materialeve të Kategorisë 3 të përcaktuara në Nenin 10 të atij Udhëzimi Administrativ dhe;

1.1.3. kur materialet e Kategorisë 1 të përcaktuara në Nenin 8 paragraf 1, nënparagraf 1.2 të këtij Udhëzimit Administrativ ose Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 futen në fabrikën me kapacitet të ulët, të jetë e pajisur me një djegës ndihmës;

1.1.4. të veprojnë në mënyrë të tillë që nënproduktet shtazore të jenë reduktuar plotësisht në hi.

KAPITULLI IV

KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR PËRDORIMIN E NËNPRODUKTEVE TË KAFSHËVE DHE PRODUKTEVE TË PËRFITUARA PREJ TYRE SI LËNDË DJEGËSE

Nënkapitulli 1

Kërkesat e përgjithshme në lidhje me djegien e nënprodukteve shtazore dhe produkteve të përfituara si lëndë djegëse

1. Operatorët e fabrikave me djegie nga neni 7 paragrafi 6 i këtij Udhëzimi Administrativ do të sigurojnë që në fabrikat me djegie nën kontrollin e tyre të plotësojnë kushtet si ne vijim:

1.1. Nënproduktet e kafshëve dhe produktet e përfituara të destinuara për t'u përdorur si lëndë djegëse duhet të përdoren për këtë qëllim sa më shpejt të jetë e mundur ose të ruhen në mënyrë të sigurt derisa të përdoren;

1.2. Fabrikat e djegies duhet të zbatojnë masat e menjëhershme për të siguruar që pastrimi dhe dezinfektimi i kontejnerëve dhe automjeteve të kryhet në një zonë të caktuar të ambienteve të tyre nga ku mund të mblidhen dhe të derdhen ujërat e zeza në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të shmangur rreziqet e ndotjes së mjedisit.

2. Me përjashtim të kërkesave të përcaktuara në nënparagrafin 1.1 të këtij nënkapitulli, kontejnerët dhe automjetet që përdoren për transportin e yndyrave të përpunuara mund të pastrohen dhe dezinfektohen në fabrikën e ngarkimit ose në çdo fabrikë tjetër të aprovuar ose të regjistruar sipas Udhëzimit Administrativ. MBPZHR) - Nr. 05/2022, si:

2.1. fabrikat e djegies duhet të vendosen në një vend të fortë dhe të drenazhuar mirë;

2.2. fabrikat e djegies duhet të zbatojnë masat e menjëhershme për mbrojtjen nga dëmtuesit. Për këtë qëllim duhet të përdoret një program i dokumentuar i kontrollit të dëmtuesve;

2.3. sipas nevojës personeli duhet të ketë qasje në objektet e adekuate për higjienën personale si tualetet, dhomat e zhveshjes dhe lavamanët, për të parandaluar rreziqet e kontaminimit të pajisjeve për trajtimin e kafshëve të kultivuara ose ushqimeve të tyre;

2.4. duhet të hartohen dhe zbatohen dhe dokumentohen për të gjitha pjesët e fabrikës së djegies. Për pastrim duhet të sigurohen pajisje të përshtatshme dhe agjentë pastrimi;

2.5. Kontrolli i higjienës duhet të përfshijë inspektime të rregullta të mjedisit dhe pajisjeve. Oraret dhe rezultatet e inspektimit duhet të dokumentohen dhe mbahen për një periudhë prej të paktën dy vjetësh;

2.6. kur yndyrat e përpunuara përdoren si lëndë djegëse për djegie në motorët e palëvizshëm me djegie të brendshme të vendosura brenda fabrikave të aprovuara ose të regjistruara të përpunimit të ushqimit ose ushqimit për kafshë, përpunimi i ushqimit ose ushqimit për kafshë në të njëjtin vend duhet të bëhet në kushte strikte të ndarjes.

3. Operatorët e fabrikave për djegie do të marrin të gjitha masat e nevojshme sa i përket pranimi të nënprodukteve shtazore ose produkteve të përfituara prej tyre për të parandaluar ose kufizuar sa më shumë që është e mundur, rreziqet për shëndetin e njerëzve ose kafshëve dhe mjedisin.
4. Kafshët nuk duhet të kenë qasje në fabrikën e djegies ose të nënproduktet shtazore dhe produktet e përfituara prej tyre që janë në pritje për djegie ose hirin që rezulton nga djegia.
5. Kur fabrika për djegie ndodhet në një prone blegtorale që mban kafshë të specieve për prodhim të ushqimit:
 - 5.1. duhet të ketë një ndarje fizike totale ndërmjet pajisjeve të djegies dhe kafshëve, duke përfshirë ushqimin dhe shtrojën e tyre;
 - 5.2. pajisjet duhet t'i dedikohen tërësisht funksionimit të fabrikës së djegies dhe të mos përdoren diku tjetër në pronë, përveç rastit kur ato janë pastruar dhe dezinfektuar në mënyrë efektive përpara përdorimit të tillë;
 - 5.3. Personeli që punon në fabrikën për djegie duhet të ndërrojë veshjet dhe këpucët e jashtme dhe të marrë masat e higjienës personale përpara se të trajtojë kafshët në këtë ose në çdo fermë tjetër ose ushqimin e tyre ose materialin e shtrojes.
6. Nënproduktet shtazore dhe produktet e përfituara që presin djegien si lëndë djegëse dhe mbetjet e djegies duhet të ruhen në një zonë të dedikuar të mbyllur dhe të mbuluar, ose në kontejnerë të mbuluar dhe rezistent ndaj rrjedhjes.
7. Djegia e nënprodukteve shtazore ose produkteve të përfituara prej tyre kryhet në kushte që parandalojnë kontaminimin e indirekt të ushqimit për kafshët.

Nënkapitulli 2

Kushtet e funksionimit të fabrikave për djegie

1. Fabrikat e djegies duhet të projektohen, ndërtohen, pajisen dhe funksionojnë në mënyrë të tillë që edhe në kushtet më të pafavorshme, nënproduktet shtazore dhe produktet e përfituara të trajtohen për të paktën 2 sekonda në një temperaturë prej 850 °C ose për të paktën 0,2 sekonda në një temperaturë prej 1 100 °C.
2. Gazi që rezulton nga procesi ngrihet në mënyrë të kontrolluar dhe homogjene për 2 sekonda në një temperaturë prej 850 °C ose për 0,2 sekonda në një temperaturë prej 1 100 °C.
3. Temperatura duhet të matet pranë murit të brendshëm ose në një pikë tjetër përfaqësuese të dhomës së djegies, siç autorizohet nga autoriteti kompetent.
4. Teknikat e automatizuara do të përdoren për të monitoruar parametrat dhe kushtet që lidhen me procesin e djegies.

5. Rezultatet e matjes së temperaturës regjistrohen automatikisht dhe paraqiten në mënyrën e duhur për t'i mundësuar autoritetit kompetent të verifikojë pajtueshmërinë me kushtet e lejuara të funksionimit të përmendura në paragrafin 1 dhe 2 të këtij Nënkapitullinë përputhje me procedurat që do të vendosen nga autoriteti përkatës.

6. Operatori i një fabrike të djegies duhet të sigurojë që karburanti të digjet në mënyrë të tillë që përmbajtja totale e karbonit organik të skorjeve dhe hirit të poshtëm të jetë më pak se 3% ose humbja e tyre gjatë ndezjes është më pak se 5% e peshës së thatë të materialit.

Nënkapitulli 3 Mbetjet e djegies

1. Mbetjet e djegies duhet të minimizohen në sasinë dhe dëmshmërinë e tyre. Mbetje të tilla duhet të riperpunohen, ose kur nuk është e përshtatshme, të asgjësohen ose përdoren në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Transporti dhe ruajtja e ndërmjetme e mbetjeve të thata, duke përfshirë pluhurin, duhet të bëhet në kontejnerë të mbyllur ose në një mënyrë tjetër që parandalon shpërndarjen në mjedis.

Nënkapitulli 4 Defektet ose kushtet e funksionimit jo i rregullt

1. Fabrika e djegies duhet të jetë e pajisur me pajisje që mbyllin automatikisht funksionimin në rast të një avarie ose kushtesh jonormale të funksionimit derisa të mund të rifillojë funksionimi normal.

2. Nënproduktet e kafshëve të cilat nuk digjen plotësisht dhe produktet e përfituara duhet të digjen përsëri ose të asgjësohen në një deponi të autorizuar me mjetet e përcaktuar në nenet 12, 13 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022.

KAPITULLI V

LLOJET E FABRIKAVE DHE DERIVATET TË CILAT MUND TË PËRDOREN PËR DIEGJE DHE KËRKESAT SPECIFIKE PËR LLOJET TË POSAÇME TË FABRIKAVE

A. Motorë të palëvizshëm me djegie të brendshme

1. Materiali fillestar:

Për këtë proces, mund të përdoret një pjesë yndyre e përftuar nga nënproduktet shtazore të të gjitha kategorive me kusht që të plotësojë kushtet si ne vijon:

1.1. përveç nëse përdoret vaj peshku ose yndyrë e përpunuar që është prodhuar në përputhje me legjislacionin në fuqi përkatsisht, ndarja e yndyrës që përfitohet nga nënproduktet shtazore duhet së pari të përpunohet duke përdorur:

1.1.1. në rastin e një fraksioni yndyror të materialeve të kategorisë 1 dhe 2, ndonjë nga metodat e përpunimit nga 1 deri në 5 siç është përcaktuar në Kapitullin III të Shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ. Kur kjo yndyrë zhvendoset nga një sistem transportues i mbyllur, i cili nuk mund të anashkalohet, dhe me kusht që një sistem i tillë të jetë i autorizuar nga autoriteti kompetent, nga impianti i përpunimit për djegie të menjëhershme direkte, shënjimi i përhershëm me gliceroltriheptanoate (GTH) të përcaktuar në paragrafin 1 të Kapitullit V të Shtojcës VI të këtij Udhëzimi Administrativ nuk do të kërkohej;

1.1.2. në rastin e një ndarje yndyrore të materialit të kategorisë 3, ndonjë nga metodat e përpunimit 1 deri në 5 ose metoda e përpunimit 7 siç është përcaktuar në kapitullin III të Shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.1.3. në rastin e materialeve të përfutuara nga peshku, ndonjë nga metodat e përpunimit 1 deri në 7 të përcaktuara në Kapitullin III të Shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.1.4. Yndyra duhet të ndahet nga proteina dhe në rastin e yndyrës me origjinë ripërtypëse që synohet të digjet në një fabrikë tjetër, papastërtitë e patretshme mbi 0,15 % ndaj peshës duhet të largohen.

2. Metodologjia:

Djegia e yndyrës shtazore si lëndë djegëse në një motor të palëvizshëm me djegie të brendshme duhet të kryhet si ne vijim:

2.1. fraksionet yndyrore të përcaktuara në paragrafin 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 të kësaj pike A duhet të digjen:

2.1.1. sipas kushteve të përcaktuara në nënkaptullin 2, paragrafi 1 i Kapitullit IV të kësaj Shtojce; ose

2.1.2. duke përdorur parametrat e procesit që arrijnë një rezultat ekuivalent me kushtet sipas nënparagrafit 2.1 të këtij paragrafi dhe të cilat janë të autorizuar nga autoriteti kompetent;

2.2. nuk duhet të lejohet djegia e materialit me origjinë shtazore, përveç yndyrës shtazore;

2.3. yndyra shtazore që përfitohet nga materiali I Kategorisë 1 ose Kategorisë 2 e djegur në ambiente të aprovuara ose të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqië cila përcakton rregullat e higjienës së ushqimit me origjinë shtazore ose në legjislacionin specifik për higjienën e kafshëve, ushqimit të ose në vende publike duhet të jetë përpunuar me metodën e përpunimit 1 siç është përcaktuar në kapitullin III të Shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ.

3. Djegia e yndyrës shtazore duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, në veçanti, duke iu referuar standardeve dhe kërkesave të atij legjislacioni dhe kërkesave në lidhje me teknikat më të mira të disponueshme për kontrollin dhe monitorimin e emetimeve.

Kushtet e funksionimit:

Duke përjashtuar kërkesat e përcaktuara në paragrafin 2 të Nënkapitullit 2 të Kapitullit IV të kësaj Shtojce, kërkesat e bazuara në parametra të tjerë të procesit, të cilat sigurojnë një rezultat mjedisore të barabartë mund të autorizohen nga autoriteti kompetent përgjegjës për çështjet mjedisore.

B. Fabrika për djegie në fermë në të cilat plehu i shpendëve përdoret si lëndë djegëse

1. Lloji i fabrikës:

Fabrika e djegies në fermë me një input termik total të vlerësuar jo më shumë se 5 MW.

2. Materiali fillestar dhe qëllimi:

Plehu ekskluzivisht i papërpunuar i shpendëve, siç përcaktohet në nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022. Për përdorim si lëndë djegëse për djegie në përputhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 3 deri në 5 të kësaj pike B. Djegia e nënprodukteve të tjera shtazore ose produkteve të përfituara dhe e plehut organik të specieve të tjera ose e krijuar jashtë fermës nuk lejohet për përdorim si lëndë djegëse në fabrikat për djegie në fermë të përcaktuar në paragrafin 1 të kësaj pike B.

3. Kërkesat specifike për plehun e shpendëve që përdoret si lëndë djegëse për djegie:

3.1. plehu duhet të ruhet në mënyrë të sigurt në një zonë të mbyllur magazinimi për të minimizuar nevojën për trajtim të mëtejshëm dhe për të parandaluar ndotjen e kryqëzuar me zona të tjera në një fermë që mban kafshë të specieve prodhuese ushqimore.

3.2. fabrika për djegie në fermë duhet të jetë e pajisur me:

3.2.1. një sistem automatik të menaxhimit të karburantit për të vendosur karburantin direkt në dhomën e djegies pa trajtim të mëtejshëm;

3.2.2. një djegës ndihmës i cili duhet të përdoret gjatë operimeve të ndezjes dhe fikjes për të siguruar që kërkesat e temperaturës të përcaktuara në nënkapitullin 2, paragrafi 2 të kreut IV të kësaj shtojce janë përmbushur gjatë gjithë kohës gjatë këtyre operimeve dhe për sa kohë që materiali i padjegur është në dhomën e djegies.

4. Vlerat kufitare të shkarkimeve dhe kërkesat e monitorimit:

4.1. emetimet e dioksidit të squfurit, oksideve të azotit - përkatësisht shuma e monoksidit të azotit dhe dioksidit të azotit, e shprehur si dioksid azoti dhe grimcave nuk duhet të kalojnë vlerat kufitare të emetimeve të shprehura në mg/Nm³ në një temperaturë prej 273,15 K, një

presion prej 101,3 kPa dhe një përmbajtje oksigjeni prej 11%, pas korrigjimit për përmbajtjen e avullit të ujit në gazrat e mbeturinave:

Ndotësi	Limiti i vlerës së emetimit në mg/Nm ³
Dioksidi I sulfurit	50
Oksidet e azotit (si NO ₂)	200
Grimcat	10

4.1.1 operatori i fabrikës për djegie në fermë duhet të kryejë të paktën matje vjetore të dioksidit të squfurit, oksideve të azotit dhe grimcave. Si një alternativë ndaj matjeve të përcaktuara në nënparagrafin 1, procedura të tjera, të verifikuara dhe të miratuara nga autoriteti kompetent, mund të përdoren për të përcaktuar emetimet e dioksidit të squfurit. Monitorimi do të kryhet nga ose në emër të operatorit në përputhje me standardet CEN. Kur standardet CEN nuk janë të disponueshme, do të zbatohen ISO, standarde kombëtare ose të tjera ndërkombëtare që sigurojnë sigurimin e të dhënave të një cilësie shkencore ekuivalente;

4.1.2. të gjitha rezultatet do të regjistrohen, përpunohen dhe paraqiten në mënyrë të tillë që t'i mundësojë autoritetit kompetent të verifikojë pajtueshmërinë me vlerat kufitare të shkarkimeve;

4.1.3. për fabrikat për djegie në fermë që aplikojnë pajisje dytësore të zvogëlimit të emetimit për të përmbushur limitin e vlerave të emetimeve, funksionimi efektiv i kësaj pajisjeje do të monitorohet vazhdimisht dhe rezultatet e tyre do të regjistrohen;

4.1.4. Në rast të mospërputhjes me vlerat kufitare të emetimeve të përcaktuara në nënparagrafin 4.1 të këtij paragrafi ose kur një fabrikë djegieje në fermë nuk plotëson kërkesat e paragrafit 1 të Nënkapitullit 2 të Kapitullit IV të kësaj Shtojce, operatorët duhet të informojnë menjëherë autoritetin kompetent dhe të marrë masat e nevojshme për të siguruar që përputhshmëria të rikthehet brenda një kohe sa më të shkurtër. Kur përputhshmëria nuk mund të rivendoset, autoriteti kompetent do të pezullojë funksionimin e fabrikës dhe do të tërheqë aprovimin e tij.

5. Ndryshimet e funksionimit dhe prishjet:

5.1. Operatori duhet të njoftojë autoritetin kompetent për çdo ndryshim të planifikuar të fabrikës së djegies në fermë, i cili do të ndikonte në emetimet e tij të paktën një muaj përpara datës në të cilën ndodh ndryshimi;

5.2. Operatori do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që periudhat e fillimit dhe mbylljes së fabrikës të djegies në fermë dhe të çdo keq funksionimi të jenë sa më të shkurtra. Në rast të një mosfunksionimi ose prishjeje të pajisjeve dytësore të zvogëlimit, operatori duhet të informojë menjëherë autoritetin kompetent.

C.Fabrikat për djegie në të cilat plehu i kafshëve të kultivuara përveç plehut të shpendëve të përcaktuar në pikën B përdoret si lëndë djegëse për djegie

1. Lloji i fabrikës:

Fabrika për djegie me një input termik total të vlerësuar jo më shumë se 50 MË.

2. Materiali fillestar:

Ekskluzivisht pleh organik i kafshëve të kultivuara, përveç plehut të shpendëve të përcaktuar në pikën B të këtij Kapitulli, për t'u përdorur si lëndë djegëse për djegie në përputhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 3 të pikës C. Djegia e nënprodukteve të tjera shtazore ose produktet e prejardhura nuk do të lejohen të përdoren si lëndë djegëse në impiantet me djegie të përmendura në paragrafin 1 të kësaj pike C. Plehurat e kafshëve të kultivuara, përveç plehut organik të shpendëve, të përcaktuara në pikën B të këtij Kapitulli, i prodhuar jashtë fermës nuk duhet të vijnë në kontakt me kafshë të kultivuara.

3. Metodologjia:

Fabrikat e djegies në të cilat plehu i kafshëve të kultivuara, përveç plehut të shpendëve, i përcaktuar në pikën B të këtij Kapitulli, përdoret si lëndë djegëse, duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikat B, paragrafi 3, 4 dhe 5.

D.Fabrikat e djegies në të cilat mielli I mishit dhe kockave përdoret si lëndë djegëse për djegie

1.Lloji i fabrikës:

Fabrikat e djegies me një input termik total të vlerësuar jo më shumë se 50 MW

2. Materiali fillestar:

Mielli me mish dhe kocka të materialeve të kategorisë 1 dhe kategorisë 2, për t'u përdorur si lëndë djegëse për djegie në përputhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 3 të kësaj pike D, vetëm ose në një përzierje miell mishi dhe kockash, yndyrë e përpunuar dhe pleh organik.

3. Kërkesat specifike për miellin e mishit dhe kockave të përdorura si lëndë djegëse për djegie:

3.1. mielli i mishit dhe kockave do të ruhet në impiantin e djegies në mënyrë të sigurt në një depo të mbyllur të mbrojtur nga akseset e kafshëve dhe nuk do të dërgohet në një destinacion tjetër përveç rastit kur autorizohet nga autoriteti kompetent në rast të prishjes ose kushteve jonormale të funksionimit;

3.2.fabrika e djegies duhet të jetë e pajisur me:

3.2.1. një sistem automatik ose i vazhdueshëm i menaxhimit të karburantit për të vendosur karburantin drejtpërdrejt në dhomën e djegies pa trajtim të mëtejshëm;

3.2.2. njëdjegës ndihmës i cili duhet të përdoret gjatë operimeve të ndezjes dhe fikjes për të siguruar që kërkesat e temperaturës të përcaktuara në nënkapitullin 2, paragrafi 2 të kapitullit IV të kësaj shtojce të përmbushen gjatë gjithë kohës gjatë këtyre operimeve dhe për sa kohë që materiali i padjegur është në dhomën e djegies.

4. Metodologjia:

Fabrikat e djegies në të cilat mielli i mishit dhe kockave të materialeve të kategorisë 1 ose të kategorisë 2 përdoret si lëndë djegëse duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përgjithshme të përcaktuara në Kapitullin IV të këtij Shtojca dhe kërkesat specifike të përcaktuara në pikën B, paragrafi 4 dhe 5. të këtij Kapitulli.

SHTOJCA II PROCESIMI

KAPITULLI I

KËRKESAT PËR FABRIKAT E PROCESIMIT DHE FABRIKAT E NDËRRMARRJET TJERA TË CAKTUARA

Nënkpitulli 1

Kushtet e përgjithshme

1. Fabrikat përpunuese duhet të plotësojnë kërkesat si ne vijim, për përpunim me sterilizimin nën presion ose në përputhje me metodat e përpunimit të përcaktuara në nenin 15, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 si:

1.1. Fabrikat e procesimit nuk duhet të jenë të vendosura në të njëjtin vend me therrtoret apo ndërmarrjet e tjera të cilat janë të aprovuara ose të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi i cili përcakton rregullat shëndetësore për higjienën e ushqimit me origjinë shtazore përveç nëse rreziqet për shëndetin publik dhe shëndetin e kafshëve që rezultojnë nga përpunimi i nënprodukteve shtazore, që kanë origjinë nga thertoret e tilla apo ndërmarrjet e tjera, janë lehtësuar në përputhje së paku me kushtet si në vijim:

1.1.1. fabrika e procesimit duhet të jetë e ndarë fizikisht nga thertorja ose ndermarrje tjetër, kur është e përshtatshme duke e vendosur fabrikën e procesimit në një ndërtesë që është e ndarë krejtësisht nga thertorja ose ndermarrja tjetër;

1.2. në fabrikë të procesimit duhet të jenë të instaluar dhe të operojnë si vijon:

1.2.1. Një sistem lëvizës që lidh fabrikën e procesimit me thertoren ose ndermarjen tjetër dhe që nuk mund të anashkalohet,

1.2.2. Hyrjet, hapësirat e pranimit, pajisjet dhe daljet për të dyja, edhe fabrikën e procesimit edhe thertoren ose ndermarrjet, e veçanta;

1.2.3. duhet të merren masa për të parandaluar përhapjen e rreziqeve përmes veprimit të personelit që është i punësuar në fabrikë të procesimit dhe në thertore ose ndërmarrje tjetër;

1.2.4. personat e paautorizuar dhe kafshët nuk duhet të kenë qasje në fabrikë të procesimit;

1.5. me ane të derogimit në nënparagrafët 1.1.1 deri në 1.1.4 të këtij nënparagrafi, në rastin e impianteve të përpunimit që përpunojnë materiale të kategorisë 3, autoriteti kompetent mund të autorizojë kushte të tjera në vend të atyre të përcaktuara në këto nënparagrafë, që synojnë zvogëlimin e rreziqeve për shëndetin publik dhe të kafshëve, duke përfshirë rreziqet që dalin nga procesimi i materialit të Kategorisë 3, e që ka origjinën nga ndermarrjet jashtë vendit të fabrikës të aprovuara apo të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për higjienën e produkteve ushqimore ose me rregullat specifike për higjienën e ushqimeve me origjinë shtazore;

1.6. fabrika e procesimit duhet të ketë një sektor të pastër dhe të papastër, të ndara në mënyrë adekuate. Sektori i papastër duhet të ketë një vend të mbuluar për të pranuar nënproduktet shtazore dhe duhet të jetë i ndërtuar ashtu që të jetë e lehtë për t'u pastruar dhe dezinfektuar. Dyshemetë duhet të jenë të shtruara ashtu që të lehtësojnë kullimin e lëngjeve;

1.7. fabrika e procesimit duhet të ketë hapësira të përshtatshme, duke përfshirë banjot, zhveshtoret për ndërrimin e rrobave dhe lavamanit për stafin;

1.8. fabrika e procesimit duhet të ketë kapacitete të mjaftueshme për prodhimin e ujit të nxehtë dhe avullit për përpunimin e nënprodukteve shtazore;

1.9. sektori i papastër duhet, nëse është e përshtatshme, të ketë pajisje për të zvogëluar madhësinë e nënprodukteve shtazore dhe pajisjet për ngarkimin e nënprodukteve shtazore të grimcuara, në njësinë e procesimit;

1.10. kur kërkohet trajtimi me ngrohje, të gjitha instalimet duhet të jenë të pajisura me:

1.10.1 pajisje matëse për të monitoruar temperaturën në raport me kohën dhe, nëse është e aplikueshme për metodën e përdorur të procesimit, presionin në pikat kritike;

1.10.2 pajisjet që regjistrojnë në vazhdimësi rezultatet e këtyre matjeve në mënyrë që ato të mbeten të qasëshme për qëllime të kontrollit dhe kontrolleve zyrtare;

1.10.3 një sistem adekuat të sigurisë për të parandaluar ngrohjen e pamjaftueshme;

1.11. Për të parandaluar ri-kontaminimin e produktit të derivuar nga nënproduktet shtazore, duhet të ekzistojë një ndarje e qartë midis zonës së fabrikës ku materiali që hyn për procesim

shkarkohet, dhe zonave të lëna mënjanë për procesimin e atij produkti dhe magazinimin e produktit të derivuar.

2. Fabrika e procesimit duhet të ketë hapësira adekuate për pastrimin dhe dezinfektimin e kontejnerëve apo bombolave ku nënproduktet shtazore pranohen si dhe mjeteve të transportit, me të cilat ato transportohen.

3. Hapësirat adekuate duhet të sigurohen për dezinfektim të rrotave të automjeteve dhe pjesëve të tjera të tyre, sipas rastit, gjatë largimit nga sektori i ndyrë i fabrikës së përpunimit.

4. Të gjitha fabrikat e procesimit duhet të kenë një sistem të trajtimit të ujërave të ndotura që plotëson kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kompetent në pajtim me legjislacionin në fuqi.

5. Fabrika e procesimit duhet të ketë laboratorin e vet ose të përdorë shërbimet e një laboratorit të jashtëm. Laboratori duhet të jetë i pajisur për të kryer analizat e nevojshme dhe të jete i miratuar nga autoriteti kompetent në bazë të një vlerësimi të kapaciteteve të laboratorit për të kryer këto analiza, të jete i akredituar sipas standardeve të pranuara ndërkombëtarisht ose t'i nënshtrohet kontrolleve të rregullta nga autoriteti kompetent, për të vlerësuar kapacitetin e laboratorit për të kryer këto analiza.

6. Nëse në bazë të vlerësimit të rrezikut, vëllimi i produkteve të trajtuara kërkon praninë e rregullt ose të përhershëm të autoritetit kompetent, fabrikat e përpunimit duhet të kenë një dhomë të pajisur në mënyrë adekuate që mbyllet për përdorim ekskluziv të shërbimit të inspektimit.

Nënkapitulli 2

Trajtimi i ujërave të ndotura

1. Fabrikat e procesimit që përpunojnë materiale të Kategorise 1 dhe hapësirat tjera prej të cilave materialet e specifikuar me rrezik largohen, thertoret dhe fabrikat e procesimit që përpunojnë materiale të Kategorise 2 do të kenë një proces të para-trajtimit për mbajtjen dhe grumbullimin e materialit të kafshëve, si një hap fillestar në trajtimin e ujërave të ndotura.

2. Pajisjet e përdorura në procesin e para-trajtimit nga paragrafi 1 i këtij Nënkapitulli do të përbëhen nga kurthet e kullimit apo rrjetat me hapje për filtër me vrimë apo rrjetë me madhësi prej jo më shumë se 6 mm në perfundim të rrjedhës së procesit apo sistemeve ekuivalente që të sigurojë se grimcat e ngurta në ujërat e zeza që kalojnë përmes tyre nuk janë më të mëdha se 6 mm

3. Ujërat e ndotura nga hapësirat siç janë të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij Nënkapitulli duhet të hyjnë në një proces para-trajtimi që do të sigurojë që të gjitha ujërat e ndotura janë filtruar nëpër procese para se të drenazhohen jashtë hapësirave. Asnjë bluarje, tretje ose ndonjë përpunim tjetër ose aplikim i presionit e cila mund të lehtësojë kalimin e materialeve të ngurta të kafshëve nëpër procese para-trajtimit nuk lejohet të bëhet.

4. Të gjitha materialet shtazore që mbahen në procesin e para-trajtimit në hapësirat siç janë përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, do të grumbullohen dhe transportohen si materiale të

Kategorisë 1 ose Kategorisë 2, sipas rastit, dhe eliminohen në përputhje Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022.

5. Ujërat e ndotura që e kanë kaluar procesin e para-trajtimin në hapësirat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Nënkapitulli dhe ujërat e ndotura nga hapësirat e tjera që trajtojnë ose procesojnë nënproduktet shtazore, do të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, pa kufizime në përputhje me këtë Udhëzim Administrativ.

6. Përveç kërkesave të përcaktuara në paragrafin 5 të këtij nënkapitulli, autoriteti kompetent i detyron operatorët të trajtojnë ujërat e ndotura me origjinë në sektorin e ndyrë të fabrikës së procesimit dhe në fabrikat apo ndërmarjet që kryejnë operacione të ndërmjetme me materiale të Kategorisë 1 apo materiale të Kategorisë 2 ose bëjnë magazinimin e materialeve të Kategorisë 1 ose materialeve të Kategorisë 2, në përputhje me kushtet të cilat sigurojnë se rreziqet nga patogjenet janë të zvogëluar.

7. Pa cenuar paragrafin 1 deri në 6 të këtij nënkapitulli, ndalohet asgjësimi i nënprodukteve shtazore, duke përfshirë gjakun dhe qumështin, ose produkte të prejardhura përmes rrjedhës së ujërave të zeza. Megjithatë, materiali i kategorisë 3 që përbëhet nga llumi centrifugues ose ndarës mund të hidhet përmes rrjedhës së ujërave të zeza, me kusht që t'i nënshtrohet njërit prej trajtimeve për llumrat e centrifugës ose ndarësit të përcaktuar në pjesën III të Nënkapitullit 4 të kapitullit II të Shtojcës VIII. të këtij Udhëzimi Administrativ.

Nënkapitulli 3

Kërkesatm specifike për procesimin e materialeve të Kategorisë 1 dhe Kategorisë 2

Planimetria e fabrikave të përpunimit që procesojnë materiale të Kategorisë 1 dhe Kategorisë 2 duhet të sigurojë ndarjen e tërësishme të materialeve të Kategorisë 1 dhe Kategorisë 2 që nga pranimi lëndës së parë e deri në dërgim të produkti të derivuar që rezulton nga procesimi, përveç nëse një përzierje e materialeve të Kategorisë 1 dhe Kategorisë 2 është procesuar si material i Kategorisë 1.

Nënkapitulli 4

Kërkesat specifike për procesimin e materialeve të Kategorisë 3

1. Kërkesat si në vijin zbatohen krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara në Nënkapitullin 1 të kësaj Shtojce si:

1.1. Fabrikat e procesimit që procesojnë materiale të Kategorisë 3 nuk do të jenë të vendosura në të njëjtin vend si fabrikat e procesimit që procesojnë materiale të Kategorisë 1 dhe Kategorisë 2, përveç nëse gjendet në një ndërtesë krejtësisht të ndarë;

1.2. Megjithatë, autoriteti kompetent mund të autorizojë procesimin e materialit të Kategorisë 3 në një vend ku kryhet trajtimi ose procesimi i materialeve të Kategorisë 1 ose Kategorisë 2, nëse kontaminimi i kryqëzuar pengohet përmes:

1.2.1. planimetria e hapësirave, në veçanti hapësira e planifikuara për praninë dhe hapësira e trajtimit të mëtejshëm të lëndëve të para;

1.2.2. planimetria dhe menaxhimi i pajisjeve të përdorura për procesim, përfshirë planimetrinë dhe menaxhimin e linjave të veçanta të procesimit ose të procedurave të pastrimit të cilat përjashtojnë përhapjen e ndonjë rreziku të mundshëm për shëndetin publik dhe të kafshëve; dhe

1.2.3. planimetria dhe menaxhimi i zonave për magazinimin e përkohshëm të produkteve finale.

3. Fabrikat e procesimit që procesojnë materiale të Kategorisë 3 do të kenë të caktuar një hapësirë për të kontrolluar praninë e trupave të huaja, si materiali për paketim apo copat metalike, në nënprodukte shtazore apo produkte të derivuara, në qoftë se ato janë materiale të procesimit të cilat janë të destinuara për ushqim të kafshëve. Trupat e tilla të huaja, hiqen para ose gjatë procesimit.

KAPITULLI II

KËRKESAT PËR HIGJENË DHE PROCESIM

Nënkapitulli 1

Kërkesat e përgjithshme për higjienë

Përveç kërkesave të përgjithshme të higjienës të përcaktuara në Nenin 25 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr.05/2022, fabrikat e procesimit do të kenë në vend një program të dokumentuar të kontrollit të dëmtuesve për zbatimin e planifikimeve për mbrojtjen nga dëmtuesit, siç janë insektet, brejtësit dhe zogjtë, të përcaktuara në Nenin 25 paragraf 1 nënparagraf 1.3 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022.

Nënkapitulli 2

Kërkesat e përgjithshme për procesim

1. Matesit / regjistruarit e kalibruar me saktësi duhet të përdoren për të monitoruar vazhdimisht kushtet e procesimit. Regjistri duhet të mbahet për të treguar datën e kalibrimit të matesve / regjistruarëve.

2. Materiali që mund të mos katë marrë trajtimin e specifikuar termik, siç është materiali i shkarkuar në fillim apo rrjedhjet nga zierat, duhet të riqarkullohet nëpërmjet trajtimit termik apo të mbledhet dhe riprocesohet ose hudhet në përputhje me të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr.05/2022.

Nënkapitulli 3

Metodat e procesimit për materialet e Kategorisë 1 dhe Kategorisë 2

Metodat e procesimit për materialet e Kategorisë 1 dhe Kategorisë 2, përveç nëse autoriteti kompetent kërkon aplikimin e sterilizimit me presion (metoda 1), materialet e Kategorisë 1 dhe Kategorisë 2 do të procesohen në përputhje me metodat e procesimit 2, 3, 4 ose 5 sic përcaktohet në Kapitullin III të kësaj Shtojce.

Nënkapitulli 4

Procesimi i materialit të Kategorisë 3

1. Pikat kritike të kontrollit që përcaktojnë shkallën e trajtimeve termike të aplikuara në procesim do të përfshijnë për çdo metodë të procesimit siç është përcaktuar në Kapitullin III të kësaj Shtojce:

1.1 madhësia e copave të lëndës së parë;

1.2 temperatura e arritur në procesin termik;

1.3 presioni, nëse aplikohet në lëndën e parë;

1.4 kohëzgjatja e procesit të trajtimit termik ose shkalla e mbushjes me material në një sistem të vazhdueshëm. Standardet minimale të procesimit duhet të jenë të specifikuara për çdo pikë kritike të kontrollit të aplikueshme.

2. Në rast të trajtimeve kimike të cilat janë autorizuar nga autoriteti kompetent si metodë e procesimit 7 në pajtim me pikën G të Kapitullit III, pikat kritike të kontrollit që përcaktojnë sasinë e trajtimeve kimike të aplikuara do të përfshijnë përshtatjen e pH-së së arritur.

3. Të dhënat mbahen për të paktën dy vjet për të treguar se vlerat minimale të procesit për secilën pikë kritike të kontrollit janë aplikuar.

4. Materiali i Kategorisë 3 do të procesohet në përputhje me çdo metodë të procesimit 1 deri 5 ose metodën e procesimit 7, ose, në rast të materialit me origjinë nga kafshët akuatike, me çdo metodë të procesimit prej 1 deri 7, sic përcaktohet në Kapitullin III të kësaj Shtojce.

KAPITULLI III

METODAT STANDARDE TË PROCESIMIT

A. Metoda e procesimit 1 (sterilizimi me presion)

Zvogëlimi

1. Nëse madhësia e copave të nënprodukteve shtazore që do të procesohen është më e madhe se 50 milimetra, nën produktet shtazore duhet të zvogëlohen në madhësi duke përdorur pajisje adekuate, të vendosura ashtu që madhësia e copave pas zvogëlimit të mos jetë më e madhe se 50 milimetra. Efikasiteti i pajisjeve duhet të kontrollohet cdo ditë dhe gjendja e tyre të regjistrohet. Nëse kontrollat zbulojnë praninë e copave më të mëdha se 50 milimetra, procesi duhet të ndalet dhe riparimet të bëhen para se të rifillojë procesi.

Koha, temperatura dhe presioni

1. Nënproduktet shtazore me madhësi të copave jo më të mëdha se 50 milimetra duhet të ngrohen në temperaturën në thellesi më të lartë se 133 °C për të paktën 20 minuta pa ndërprerje në presion (absolut) prej të paktën 3 bar. Presioni duhet të prodhohet me evakuimin e gjithë ajrit në dhomën

e sterilizimit dhe zëvendësimin e ajrit me avull ('avull të ngopur'); trajtimi me ngrohje mund të aplikohet si proces i vetëm ose si fazë e procesit para ose pas sterilizimit.

2. Procesimi mund të kryhet në grumbull apo sisteme të vazhdueshme.

B. Metoda e procesimit 2

Reduktimi/zvogëlimi

1. Nëse madhësia e copave të nën produkteve shtazore që do të procesohen është më e madhe se 150 milimetra, nën produktet shtazore duhet të zvogëlohen në madhësi duke përdorur pajisje adekuate, të vendosura ashtu që madhësia e copave pas zvogëlimit të mos jetë më e madhe se 150 milimetra. Efikasiteti i pajisjeve duhet të kontrollohet cdo ditë dhe gjendja e tyre të regjistrohet. Nëse kontrollat zbulojnë praninë e copave më të mëdha se 150 milimetra, procesi duhet të ndalet dhe riparimet duhet të bëhen para se procesi të rifillojë.

Koha, temperatura dhe presioni

1. Pas zvogëlimit nën produktet shtazore duhet të ngrohen në atë mënyrë që të sigurohet se temperatura në thellësi më e lartë se 100°C është arritur për të paktën 125 minuta, temperatura në thellësi më e lartë se 110 °C është arritur për të paktën 120 minuta dhe temperatura në thellësi më e lartë se 120 °C është arritur për të paktën 50 minuta.

Temperaturat në thellësi mund të arrihen në mënyrë të njepasnjeshme ose nëpërmjet kombinimeve të rastësishme të periudhave kohore të treguara.

2. Procesimi duhet të kryhet në sistemin e grumbullit.

C. Metoda e procesimit 3

Zvogëlimi

1. Nëse madhësia e copave të nën produkteve shtazore që do të procesohen është më e madhe se 30 milimetra, nën produktet shtazore duhet të zvogëlohen në madhësi duke përdorur pajisje adekuate, të vendosura ashtu që madhësia e copave pas zvogëlimit të mos jetë më e madhe se 30 milimetra. Efikasiteti i pajisjeve duhet të kontrollohet cdo ditë dhe gjendja e tyre të regjistrohet. Nëse kontrollat zbulojnë praninë e copave më të mëdha se 30 milimetra, procesi duhet të ndalet dhe riparimet duhet të bëhen para se procesi të rifillojë.

Koha, temperatura dhe presioni

1. Pas zvogëlimit nën produktet shtazore duhet të ngrohen në atë mënyrë që të sigurohet se temperatura në thellësi më e lartë se 100°C është arritur për të paktën 95 minuta, temperatura në thellësi më e lartë se 110 °C është arritur për të paktën 55 minuta dhe temperatura në thellësi më e lartë se 120 °C është arritur për të paktën 13 minuta.

Temperaturat në thellësi mund të arrihen në mënyrë njepasnjeshme ose nëpërmjet kombinimeve të rastësishme të periudhave kohore të treguara.

2. Procesimi mund të kryhet në sistemin e grumbullit ose të vazhdueshëm.

D. Metoda e procesimit 4

Zvogëlimi

1. Nëse madhësia e copave të nën produkteve shtazore që do të procesohen është më e madhe se 30 milimetra, nën produktet shtazore duhet të zvogëlohen në madhësi duke përdorur pajisje adekuatë, të vendosura ashtu që madhësia e copave pas zvogëlimit të mos jetë më e madhe se 30 milimetra. Efikasiteti i pajisjeve duhet të kontrollohet cdo ditë dhe gjendja e tyre të regjistrohet. Nëse kontrollat zbulojnë praninë e copave më të mëdha se 30 milimetra, procesi duhet të ndalet dhe riparimet duhet të bëhen para se procesi të rifillojë.

Koha, temperatura dhe presioni

1. Pas zvogëlimit nën produktet shtazore duhet të vendosen në enë me yndyrë të shtuar dhe të ngrohet ashtu që të sigurohet se temperatura në thellësi më e lartë se 100°C është arritur për të paktën 16 minuta, temperatura në thellësi më e lartë se 110 °C është arritur për të paktën 13 minuta dhe temperatura në thellësi më e lartë se 120 °C është arritur për të paktën tetë (8) minuta dhe temperatura në thellësi më e lartë se 130° C është arritur për të paktën tre (3) minuta. Temperaturat në thellësi mund të arrihen në mënyrë të njepasnjeshme ose nëpërmjet kombinimeve të rastësishme të periudhave kohore të treguara.

2. Procesimi duhet të kryhet në sistemin e grumbullit ose të vazhdueshëm.

E. Metoda e procesimit 5

Zvogëlimi

1. Nëse madhësia e copave të nën produkteve shtazore që do të procesohen është më e madhe se 20 milimetra, nën produktet shtazore duhet të zvogëlohen në madhësi duke përdorur pajisje adekuatë, të vendosura ashtu që madhësia e copave pas zvogëlimit të mos jetë më e madhe se 20 milimetra. Efikasiteti i pajisjeve duhet të kontrollohet cdo ditë dhe gjendja e tyre të regjistrohet. Nëse kontrollat zbulojnë praninë e copave më të mëdha se 20 milimetra, procesi duhet të ndalet dhe riparimet duhet të bëhen para se procesi të rifillojë.

Koha, temperatura dhe presioni

1. Pas zvogëlimit nën produktet shtazore duhet të ngrohen derisa të koaguloen dhe pastaj shtypen ashtu që yndyra dhe uji të largohen nga materiali proteinik. Materiali proteinik duhet pastaj të ngrohet ashtu që të sigurohet se temperatura në thellësi më e lartë se 80 °C është arritur për të paktën 120 minuta dhe temperatura në thellësi më e lartë se 100 °C është arritur për të paktën 60 minuta.

Temperaturat në thellësi mund të arrihen në mënyrë të njepasnjeshme ose nëpërmjet kombinimeve të rastësishme të periudhave kohore të treguara.

2. Procesimi mund të kryhet në sistemin e grumbullit ose të vazhdueshëm.

F. Metoda e procesimit 6 (për nënproduktet shtazore të Kategorisë 3 me origjinë nga kafshët akuatike ose vetëm pakurizorët akuatik)

Zvogëlimi

1. Nën produktet shtazore duhet të zvogëlohen në madhësi cope që nuk është më e madhe se:

1.1. 50 mm, në rast të trajtimit me ngrohje në pajtim me paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 i kësaj pike F; ose

1.2. 30 mm, në rast të trajtimit me ngrohje në pajtim me nën paragrafin 2.2 të kësaj pike F.

2. Nenproduktet e tilla pastaj duhet të përzihen me acid formik për të reduktuar dhe mbajtur pH në 4,0 ose më ulët. Përzierja duhet të ruhet për të paktën 24 orë duke pritur trajtim të mëtejshëm.

Koha, temperatura dhe presioni

Pas reduktimit, përzierja duhet të ngrohet në:

2.1. Temperature në thellësi prej të paktën 90 ° C për së paku 60 minuta; ose

2.2. Temperature në thellësi prej të paktën 70 ° C për së paku 60 minuta.

3. Kur përdoret një sistem i vazhdueshëm i rrjedhjes, levizja tutje e produktit nëpër konvertuesin e ngrohjes duhet të kontrollohet me anë të komandave mekanike që kufizojnë zhvendosjen e tij në atë mënyrë që, në fund të operacionit të trajtimit me ngrohje produkti t'i jetë nënshtruar një cikli i cili është i mjaftueshëm në të dyjat parametrat kohë dhe temperaturë.

4. Procesimi mund të kryhet në grumbull apo sisteme të vazhdueshme.

G. Metoda e procesimit 7

1. Çdo metodë e procesimit e autorizuar nga autoriteti kompetent ku janë demonstruar kritere si në vijim nga operatori tek autoriteti:

1.1. identifikimi relevant i rreziqeve në materialin fillestar, dhe i rreziqeve potenciale sa i përket statusit të shëndetit të kafshëve të vendit të origjines ose metodes që do të përdoret në fabriken për përpunimin e nenprodukteve shtazore;

1.2. kapaciteti i metodës së procesimit për të zvogëluar ato rreziqe në një nivel i cili nuk paraqet ndonjë rrezik domethënës për shëndetin publik dhe të kafshëve;

1.3. marrja e mostrave të produktit final në baza ditore për një periudhë prej 30 ditësh të prodhimit në përputhje me standardet mikrobiologjike si në vijim:

1.3.1. mostrat e materialit të marra direkt pas trajtimit:

1.3.1.1. *Clostridium perfringens* mungese në 1 g të produktit;

1.3.1.2. mostrat e materialit të marra gjatë ose pas tërheqjes nga depoja:

1.3.1.3. Salmonella: mungese në 25g: $n=5$, $c=0$, $m=0$, $M=0$ Enterobacteriaceae: $n=5$, $c=2$; $m=10$; $M=300$ në 1 g ku:

1.3.1.4. n =numri i mostrave që do të testohet;

1.3.1.5. m =pragu i vlerës për numrin e baktereve; rezultati konsiderohet i kënaqshëm nëse numri i baktereve në të gjitha mostrat nuk e tejkalon m ;

1.3.1.6. M = vlera maksimale për numër të baktereve; rezultati konsiderohet i pakënaqshëm nëse numri i baktereve në një apo më shumë mostra është M apo më shumë; dhe

1.3.1.7. C = numri i mostrave numri i baktereve të të cilave mund të jetë midis m dhe M , mostrat ende konsiderohen të pranueshme nëse numri i baktereve i mostrave tjera është m ose më pak.

1.4. Detajet e pikave kritike të kontrollit nën të cilat secila fabrikë e procesimit është në përputhje me standardet mikrobiologjike, duhet të regjistrohen dhe mbahen ashtu që operatori dhe autoriteti kompetent mund të monitorojë operimin e fabrikës së procesimit. Informatat që do të regjistrohen dhe monitorohen duhet të përfshijnë madhësinë e copave, dhe temperaturën kritike, kohën absolute, profilin e presionit, shkallën e ngarkimit të lëndës së parë dhe shkallën e reciklimit të yndyrës.

1.5. Autoriteti kompetent do të pezullojë përgjithmonë ose përkohësisht zbatimin e metodave të përpunimit të përcaktuara në paragrafin 1 të kësaj pike G, nëse siguron prova se ndonjë nga rrethanat e specifikuar në paragrafin 1, nënparagrafin 1.1 ose 1.2 të kësaj pike G, ka ndryshuar ndjeshëm.

1.6. Autoriteti kompetent do të informojë autoritetin kompetent të çdo vendi tjetër me kërkesën e tij për informacionin që disponon sipas pikave 1 dhe 2 në lidhje me një metodë të autorizuar përpunimi.

KAPITULLI IV

METODAT ALTERNATIVE TË PROCESIMIT

Nënkapitulli 1

Kërkesat e përgjithshme

1. Materialet që rezultojnë nga përpunimi i materialeve të kategorisë 1 dhe 2 do të shënohen në mënyrë të përhershme në përputhje me kërkesat për shënimin e produkteve të përcaktuara në Kapitullin V të Shtojcës VI të këtij Udhëzimi Administrativ.

2. Megjithatë, një shenjë e tillë nuk kërkohet për materialet e përcaktuara në nënkapitullin 2 të këtij Kapitulli:

2.1. bionaftë e prodhuar në përputhje me pikën D;

2.2. materialet e hidrolizuara të përcaktuara në pikën H;

2.3. përzierjet e plehut organik të derrit dhe shpendëve me gëlqere të butë, të prodhuar në përputhje me pikën I;

2.4. lëndët djegëse të rinovueshme të prodhuara nga yndyrat e përpunuara, të cilat rrjedhin nga materialet e kategorisë 1 dhe të kategorisë 2, në përputhje me pikën J dhe L.

Nënkaptulli 2

Standardet e procesimit

A. Procesi i hidrolizës alkaline

1. materiali fillestar

Për këtë proces, nën produktet shtazore të të gjitha kategorive mund të përdoren.

2. metoda e procesimit

Hidroliza Alkaline do të kryhet sipas standardeve të procesimit si në vijim:

2.1. solucionin e hidroksidit natriumit (NaOH) ose hidroksidit kaliumit (KOH) (ose kombinimi i tyre) duhet të përdoret në një sasi që siguron ekuivalencën mesatare molare të peshës, llojit dhe përbërjes së nënprodukteve shtazore që do të treten.

2.2. në rast të yndyrës së lartë në nënprodukte shtazore që neutralizojnë bazën, baza e shtuar duhet të rregullohet ashtu që ekuivalenca molare e referuar është arritur.

2.3. nënproduktet shtazore duhet të vendosen në kontejner prej çeliku të përzier. Sasia e matur e alkalinit duhet të shtohet ose në formë të ngurte ose si tretje siç është përcaktuar në pikën nën paragrafin 2.1 të këtij paragrafi.

2.4. kontejneri duhet të mbyllet dhe nënproduktet shtazore dhe përzierja e alkalinit duhet të nxehet në temperaturën në thellësi prej të paktën 150°C dhe në shtypje (absolute) prej të paktën 5 bar, për të paktën:

2.4.1. tri orë pa ndërprerje;

2.4.2. gjashtë orë pa ndërprerje në rast të trajtimit të nënprodukteve shtazore të përcaktuara në Neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 nënparagrafët 1.1.1 dhe 1.1.2 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022.

2.4.3. Sidoqoftë, materialet e derivuara nga materialet e Kategorisë 1 që përbëhen nga kafshët e vrara në kontekst të masave të çrrenjosjes të TSE të cilat ose janë ripërtypëse që nuk kërkojnë testimin e TSE-së ose ripërtypës që janë testuar me rezultat negativ në pajtim me legjislacionin në fuqi mund të procedohet në përputhje me paragrafin 2, nënparagrafi 2.4 nën-paragrafi 2.1.1 i kësaj pike A; ose

2.4.4. një orë pa ndërprerje në rast të nënprodukteve shtazore që përbëhen nga materialet e peshkut ose shpezëve.

2.5. procesi duhet të kryhet në sistemin e grumbullit dhe materiali në enë duhet të përzihet vazhdimisht në mënyrë që të lehtësohet procesi i tretjes derisa indet të treten dhe eshtrat e dhëmbët të zbuten; dhe

2.6. nënproduktet shtazore duhet të trajtohen në atë mënyrë që kërkesat në lidhje me kohën, temperaturën dhe presionin janë arritur në të njëjtën kohë.

B. Procesi i hidrolizës me presion dhe temperature të lartë

1. materiali fillestar

Për këtë proces, materialet e Kategorisë 2 dhe Kategorisë 3 mund të përdoren.

2. Metoda e procesimit

Hidroliza me presion dhe temperaturë të lartë do të kryhet sipas standardeve të procesimit në vijim:

2.1. Nënproduktet shtazore duhet të nxehen në temperaturë në thellësi prej të paktën 180°C për së paku 40 minuta pa ndërprerje në presion (absolut) prej të paktën 12 bar, të nxehura me aplikim indirekt të avullit të reaktorit biolitik;

2.2. Procesi duhet të kryhet në grumbull dhe materiali në enë duhet të përzihet vazhdimisht; dhe

2.3. Nën produktet shtazore duhet të trajtohen në atë mënyrë që kërkesat në lidhje me kohën, temperaturën dhe presionin të arrihen në të njëjtën kohë.

C. Procesi i hidrolizës së biogazit me presion të lartë

1. Materiali fillestar

Për këtë proces nën produktet shtazore të të gjitha kategorive mund të përdoren.

2. Metoda e procesimit

Procesi i hidrolizës së biogazit me presion të lartë do të kryhet sipas standardeve të procesimit si në vijim:

2.1. Nënproduktet shtazore duhet së pari të procesohen duke përdorur metodën e procesimit 1 (sterilizimin me presion) siç është përcaktuar në Kapitullin III të kësaj Shtojce në një fabrikë të aprovuar të procesimit;

2.2. Pas procesit të referuar në nën paragrafin 2.1 të këtij paragrafi materialet pa yndyrë duhet të trajtohen në temperaturë prej të paktën 220°C për së paku 20 minuta në presion (absolut) prej të paktën 25 bar, të ngrohur me procedurën dy fazeshe, së pari me injektim direkt të avullit, së dyti në mënyrë indirekte në shkëmbyes të nxemjes me bosht të përbashkët;

2.3. Procesi duhet të kryhet në grumbull ose sistem të vazhdueshëm dhe materiali përzihet vazhdimisht;

2.4. Nënproduktet shtazore duhet të trajtohen në atë mënyrë që kërkesat në lidhje me kohën, temperaturën dhe presionin të arrihen në të njëjtën kohë;

2.5. Materiali rezultues duhet pastaj të përzihet me ujë dhe të fermentohet në mënyrë anaerobike (transformimi i biogazit) në reaktor të biogazit;

2.6. Në rast të materialit fillestar të Kategorisë 1, i gjithë procesi duhet të bëhet në të njëjtin vend dhe në sistem të mbyllur dhe biogazi i prodhuar gjatë procesit duhet të digjet shpejtë në të njëjtën fabrikë në minimum 900°C duke u përcjellë me ftohje të shpejtë ('shuarje').

D. Procesi i prodhimit të biodizelit

1. Materiali fillestar

Për këtë proces, fraksioni i yndyrës i derivuar nga nën produktet shtazore të të gjitha kategorive mund të perdoret.

2. Metoda e procesimit

Prodhimi i biodizelit do të kryhet sipas standardeve të procesimit si në vijim:

2.1. Përveç nëse vaji i peshkut ose yndyra e dervuar përdoren e të cilat janë prodhuar në pajtim me legjislacionin në fuqi e cila përcakton rregullat specifike të ushqimit me origjinë shtazore respektivisht, ndarjen e yndyrës së përfutur nga nën produktet shtazore duhet së pari duhet të procesohet duke përdorur:

2.2. në rast të materialeve të Kategorisë 1 ose 2, metoda e procesimit 1 (sterilizimi me presion) siç është përcaktuar në Kapitullin III të kësaj Shtojce; dhe

2.3. në rast të materialeve të Kategorisë 3, cilado nga metodat e procesimit 1 deri 5 ose metoda e procesimit 7 ose, në rast të materialit të derivuar nga peshku, metodat e procesimit 1 deri 7 siç janë përcaktuar në Kapitullin III të kësaj Shtojce;

3. Yndyra e procesuar duhet pastaj të procesohet tutje duke përdorur një nga metodat si në vijim:

3.1. një proces përmes së cilës yndyra e procesuar duhet të ndahet nga proteina dhe në rast të yndyrës me origjinë nga ripërtypësit, papastërtitë e patretshme të tepruara prej 0,15% me peshë duhet të largohen, dhe yndyra e procesuar duhet më pas të dorëzohet për esterifikim dhe transesterifikim. Sidoqoftë, esterifikimi nuk kërkohet për yndyrë të procesuar të derivuar nga materiali i Kategorisë 3. Për esterifikim pH duhet të zvogëlohet në më pak se 1 duke shtuar acid sulfurik (H_2SO_4) ose acid ekvivalent dhe përzierja duhet të ngrohet në temperaturë $72^{\circ}C$ për të paktën dy orë gjatë të cilat ajo duhet të përzihet intenzivisht.

Transesterifikimi duhet të kryhet duke rritur pH-në deri në 14 me hidroksid të kaliumit ose në një bazë ekvivalente në temperaturë prej $35^{\circ}C$ deri $50^{\circ}C$ për të paktën 15 minuta. Transesterifikimi do të kryhet dy herë në kushtet e përshkruara në këtë pikë duke përdorur një tretje të re bazike. Ky proces duhet të përcillet me rafinimin e produkteve përfshirë distilimin me vakum në temperaturë $150^{\circ}C$, që çon në biodizel;

3.2. procesi që përdor parametra ekuivalente të të procesit të autorizuar nga autoriteti kompetent.

E. Procesi Brookes i gazifikimit

1. Materiali fillestar

Për këtë proces, materiali i Kategorisë 2 dhe Kategorisë 3 mund të përdoren.

2. Metoda e procesimit

Gazifikimi i Brookes do të kryhet sipas standardeve të procesimit si në vijim:

2.1. Dhoma/hapesira e pas djegies duhet të ngrohet duke përdorur gaz natyror;

2.2. Nënproduktet shtazore duhet të ngarkohen në dhomën primare të gazifikatorit dhe dera duhet të jetë e mbyllur.

3. Dhoma primare nuk duhet të ketë ndonjë ndezës dhe duhet të ngrohet me anë të transferimit të nxehtësise me përçueshmëri nga pasndezësi, i cili duhet të jetë në dhomën primare. I vetmi ajr që pranohet në dhomën primare duhet të jetë nga tri valvula hyrëse të montuara në derën kryesore për të përmirësuar efikasitetin e procesit;

3.1. nën produktet shtazore duhet të avullohen në hidrokarbone komplekse dhe gazërat rezultuese duhet të kalojnë nga dhoma primare përmes një hapje të ngushtë në maje të murit të pasëm në zonat e përzierjes dhe thyerjes, ku ato duhet të zberthehen në elementet e tyre përbërëse. Në fund gazërat duhet të kalojnë në dhomën e pasndezjes ku ato duhet të digjen në flakë të ndezësit të dhezur me gaz natyror në prani të ajrit të tepërt;

3.2. secila njësi e procesit duhet të ketë dy djegës dhe dy ventilator sekondar me ajër për mbështetje në rast se djegësi apo ventilatori / feni prishen. Dhoma sekondare duhet të jetë e dizajnuar për të dhënë një kohë qëndrimi minimal prej dy sekondash në temperaturë prej të paktën $950^{\circ}C$ në të gjitha kushtet e djegies;

3.3. kur të braktiset dhoma sekondare gazërat e liruar duhet të kalojnë nëpër njomësin barometrik në bazën e raftit, i cili ftohë dhe hollon ato me ajrin e ambientit, duke mbajtur një presion konstant në dhomën primare dhe sekondare;

3.4. procesi duhet të kryhet gjatë një cikli 24 orësh, i cili përfshinë ngarkimin, përpunimin, ftohjen dhe heqjen e hirit. Në fund të ciklit mbetjet e hirit duhet të largohen nga dhoma primare me sistem të heqjes me vakum në qese të mbyllura dhe pllombuara para transportimit;

3.5. gazifikimi i materialit të ndryshëm nga nënproduktet shtazore nuk duhet të lejohet.

F. Djegia e yndyrës shtazore në procesin e ziersit termal

1. materiali fillestar

Për këtë proces, fraksioni i yndyrës i derivuar nga nënproduktet shtazore të të gjitha kategorive mund të përdoret.

2. Metoda e procesimit

Djegia e yndyrës shtazore në ziers termal do të kryhet sipas standardeve të përpunimit si në vijim:

2.1. Përveç nëse vaji i peshkut ose yndyra e renderuar përdoren të cilat janë prodhuar në përputhje me legjislacionin në fuqi i cili përcakton rregullat specifike të higjienës me origjinë shtazore, respektivisht, fraksioni i yndyrës i derivuar nga nënproduktet shtazore duhet së pari të procesohet duke përdorur:

2.1.1. në rast të fraksionit të yndyrës së materialeve të Kategorisë 1 dhe 2 që është synuar të digjet në fabrikë tjetër,

2.1.2. për ndarjen e yndyrës nga procesimi i ripërtypësve të cilët janë testuar me rezultat negativ në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kontrollin, Parandalimin dhe Çrrënjosjen e TSE-ve në Kosovë dhe nga përpunimi i kafshëve, përveç ripërtypësve të cilët kërkojnë testimin e TSE, me ndonjë nga metodat e përpunimit 1 deri në 5 siç përcaktohet në Kapitullin III të kësaj Shtojce;

2.1.3. për fraksionin e yndyrës nga procesimi i ripërtypësve tjerë, metoda e përpunimit 1 siç është përcaktuar në Kapitullin III të kësaj Shtojce; dhe

2.1.4. në rast të materialeve të Kategorisë 1 dhe 2 të synuara për djegie brenda fabrikës së njejtë dhe në rast të materialit të Kategorisë 3, secila nga metodat e procesimit prej 1 deri 5 ose metoda e procesimit 7; në rast se materialet janë të derivuara nga peshku, metodat e procesimit prej 1 deri 7 siç është përcaktuar në Kapitullin III të kësaj Shtojce;

2.1.5. Ndarja e yndyrës duhet të ndahet nga proteina dhe në rast të yndyrës me origjinë nga ripërtypësit që synohet të digjet në fabrikë tjetër, papastërtitë e patretshme me teper se 0,15% në peshë duhet të largohen;

2.1.6. Pas procesit të referuar në nën paragrafin 2.1 dhe 2.2 të kësaj pike F yndyra duhet të:

2.1.6.1. avullohet në një kazan me avull dhe zihen në një temperaturë prej të paktën 1 100 °C për të paktën 0,2 sekonda , ose;

2.1.6.2. përpunohet duke përdorur parametra ekuivalent të procesit të autorizuar nga autoriteti kompetent;

2.1.7. Djegia e materialit me origjinë shtazore tjetër prej yndyrës shtazore nuk duhet të lejohet;

2.1.8. Djegia e yndyrës së derivuar nga materialet e Kategorisë 1 dhe Kategorisë 2 duhet të bëhet në fabrikën e njejtë ku yndyra renderohet me qëllim të përdorimit të energjisë së gjeneruar për procese të renderimit. Sidoqoftë, autoriteti kompetent mund të autorizojë lëvizjen e asaj yndyre në fabrika tjera për djegie nëqoftëse:

2.1.8.1. fabrika e destinimit është e autorizuar për djegie;

2.1.8.2. procesimi i ushqimit ose ushqimit të kafshëve në një fabrikë të miratuar në hapësira të njejta bëhet në kushte strikte të ndarjes;

2.1.8.3. Djegia duhet të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi Për mbrojtjen e mjedisit, në veçanti, duke iu referuar dispozitave të këtij legjislacioni në lidhje me teknikat më të mira në dispozicion për kontrollë dhe monitorim të emetimeve.

G. Procesi termomekanik i prodhimit të biokarburantit

1. materiali fillestar

Për këtë proces, plehu dhe përmbajtja e traktit të tretjes dhe materiali i Kategorisë 3 mund të përdoren.

2. Metoda e përpunimit

Prodhimi i biokarburantit termomekanik do të bëhet sipas standardeve të procesimit si në vijim:

2.1. nënproduktet e kafshëve duhet të ngarkohen në një konvertues dhe më pas të trajtohen në një temperaturë prej 80 °C për një periudhë prej tetë orësh. Gjatë kësaj periudhe, materiali duhet të zvogëlohet vazhdimisht në përmasa duke përdorur pajisje të përshtatshme për gërryerje mekanike;

2.2. materiali duhet të trajtohet pastaj në temperaturë prej 100 °C për të paktën dy orë;

2.3. madhësia e copave të materialit rezultues nuk duhet të jetë më e madhe se 20 milimetra;

2.4. nënproduktet shtazore duhet të trajtohen në atë mënyrë që kërkesat në lidhje me kohën, temperaturën dhe presionin të përcaktuara në nënparagrafin 2.1 dhe 2.2 të këtij paragrafi arrihen në të njëjtën kohë;

2.5. gjatë trajtimit me ngrohje të materialit, uji i avulluar duhet vazhdimisht të nxjerret nga hapësira me ajër përmbi biokarburant dhe duhet të kalohet nëpër kondenzatorin e çeliktë. Kondenzati duhet të mbahet në temperaturë prej të paktën 70°C për të paktën një orë para se të derdhet si ujë i ndotur/ujera te zeza;

2.6. pas trajtimit me ngrohje të materialit, biokarburanti rezultues nga shendrruesi duhet pastaj të lirohet dhe automatikisht të bartet me transportues të mbuluar plotësisht dhe të mbyllur për në incinerim ose ko-incinerim në të njëjtin vend;

2.7. procesi duhet të kryhet në formë të Lotit.

I. Trajtimi me gëlqere i plehut të derrave dhe shpendëve

Materialet fillestare

1. Për këtë proces, pleh organik, siç referohet në nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, mund të përdoret me origjinë nga derri dhe ai i shpendëve

2. Metoda e përpunimit

2.1. përmbajtja e lëndës së thatë të plehut organik duhet të përcaktohet duke përdorur metodën CEN EN 12880:2000 "Karakterizimi i llumrave". Përcaktimi i mbetjeve të thata dhe përmbajtjes së ujit". Për këtë proces, përmbajtja e lëndës së thatë duhet të jetë ndërmjet 15% dhe 70%.

2.2. sasia e gëlqeres që duhet të shtohet duhet të përcaktohet në atë mënyrë që të arrihet një nga kombinimet e kohës dhe temperaturës të përcaktuara në nënparagrafin 2.6 të këtij paragrafi.

2.3. madhësia e grimcave të nënprodukteve shtazore që do të përpunohen nuk duhet të jetë më e madhe se 12 mm. Nëse është e nevojshme, grimcat e plehut organik duhet të zvogëlohen në madhësi në atë mënyrë që të arrihet madhësia maksimale e grimcave.

2.4. plehu duhet të përziehet me gëlqere të shpejtë (CaO) e cila ka një reaktivitet mesatar deri në të lartë prej më pak se gjashtë minuta për të arritur një rritje të temperaturës prej 40 °C sipas kritereve në testin e reaktivitetit 5.10 në CEN EN 459-2:2002 metodë.

Përzierja duhet të kryhet me dy miksera që punojnë në linjë, me dy vida për mikser.

Të dy mikserët duhet:

- 2.4.1. kanë një diametër vide prej 0,55 m dhe një gjatësi vidë prej 3,5 m;
 - 2.4.2. funksionojnë me një fuqi prej 30 kë dhe një shpejtësi rrotullimi të vidës prej 156 rpm;
 - 2.4.3. kanë një kapacitet trajtimi prej 10-ton në orë. Kohëzgjatja mesatare e përzierjes duhet të jetë afërsisht dy minuta
- 2.5. përbërja duhet të përzihet për një periudhë prej të paktën 6 orë në një grumbull me një madhësi minimale prej 2 tonësh.
- 2.6. në pikat e monitorimit që duhet të futen në rezervë, duhet të kryhen matje të vazhdueshme për të demonstruar se përzierja në rezervuar arrin një pH prej të paktën 12 gjatë një prej periudhave kohore në vijim, gjatë së cilës periudhë një nga temperaturat përkatëse të më poshtme duhet të arrihet:
- 2.6.1. 60 ° C për 60 minuta; ose
 - 2.6.2. 70°C për 30 minuta.
- 2.7. procesi duhet të kryhet në formë grumbulli.
- 2.8. Duhet të vendoset një procedurë e përhershme me shkrim e bazuar në parimet HACCP.
- 2.8.1. sipas kërkesave si ne vijim, me anë të një vërtetimi Operatorët mund t'i demonstrojnë autoritetit kompetent, se një proces duke përdorur një pajisje përzierëse e cila është e ndryshme nga pajisja përzierëse e përcaktuar në nënparagrafin 2.4 të paragrafit 2 ose duke përdorur gëlqere (CaOMgO) në vend të gëlqeres së shpejtë, është të paktën po aq efikase sa procesi i përcaktuar në nënparagrafët 2.1 deri në 2.8 të këtij paragrafi:

Ky vërtetim duhet:

- 2.8.1.1. demonstrojë se duke përdorur pajisjen e përzierjes së ndryshme nga ajo e përmendur në nënparagrafin 2.4 të këtij paragrafi ose gëlqere, sipas rastit, mund të prodhohet një përzierje me pleh organik që arrin parametrat për pH, kohën dhe temperaturën e referuar në nënparagrafin 2.6 të këtij paragrafi;
- 2.8.1.2. të bazohet në monitorimin e kohës dhe temperaturës në bazë, në mes dhe në maje të stokut, me një numër përfaqësues të pikave monitoruese (të paktën katër pika monitorimi në zonën bazale, të cilat janë të vendosura maksimumi 10 cm mbi bazën dhe në një maksimum 10 cm poshtë majës, një pikë monitorimi në gjysmën e mesit midis bazës dhe majës së grumbullit, dhe katër pika monitorimi në zonën margjinale në krye të grumbullit, të cilat janë të vendosura në maksimum prej 10 cm nën sipërfaqe dhe në maksimum 10 cm poshtë majës së materialit);

2.8.1.3. të kryhet gjatë dy periudhave prej të paktën 30 ditësh, nga të cilat njëra duhet të jetë në stinën e ftohtë të vitit në vendin gjeografik ku do të përdoret pajisja e përzierjes

J. Procesi katalitik me shumë hapa për prodhimin e lëndëve djegëse të rinovueshme

1. Materiali fillestar

1.1. për këtë proces, mund të përdoren materialet si në vijim:

1.1.1. yndyrna të përpunuara të përfituara nga materialet e kategorisë 2, të cilat janë përpunuar duke përdorur metodën e përpunimit 1 - sterilizimi me presion;

1.1.2. vaj peshku ose yndyrna të përpunuara që rrjedhin nga materialet e kategorisë 3, të cilat janë përpunuar duke përdorur:

1.1.2.1 ndonjë nga metodat e përpunimit 1 deri në 5 ose metoda e përpunimit 7; ose

1.1.2.2. në rastin e materialit që përfitohet nga vaji i peshkut, ndonjë nga metodat e përpunimit 1 deri në 7.

1.1.3. vaj peshku ose yndyrë të përpunuar të cilat janë prodhuar në përputhje me legjislacionin në fuqi Për përcaktimin e rregullave specifike për higjienën e ushqimit me origjinë shtazore, respektivisht.

1.2. për këtë proces ndalohet përdorimi i yndyrave të përpunuara që përfitohen nga materialet e kategorisë 1

2. Metoda e përpunimit

2.1. yndyra e përpunuar duhet t'i nënshtrohet një trajtimi paraprak i cili përbëhet nga:

2.1.1. zbardhja e materialeve të centrifuguara duke i kaluar nëpër një filtër argjile;

2.1.2. heqja e papastërtive të mbetura të patretshme me anë të filtrimit.

2.2. materialet e para-trajtuara duhet t'i nënshtrohen një procesi katalitik me shumë hapa, i cili përbëhet nga një hap hidro-deoksigjenizimi, i ndjekur nga një hap izomerizimi. Materialet duhet të nënshtrohen në një presion së paku 20 bar në një temperaturë prej të paktën 250 °C për të paktën 20 minuta.

K. Procesi i konservimit të materialit të peshkut

1. Materialet fillestare

Për këtë proces, mund të përdoren vetëm nënproduktet e fituara nga kafshët akuatike si ne vijim:

2.4. Materialet e kategorisë 2 të përcaktuara në nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 nënparagrafi 1.6.1 dhe 1.6.3 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022;

2.5. Materialet e kategorisë 3.

2. Metoda e përpunimit

2.1. Materialet që do të trajtohen do të mblidhen në fermat e akuakulturës dhe objektet e përpunimit të ushqimit në baza ditore dhe pa vonesa të panevojshme, të grira ose të copëtuara, dhe më pas t'i nënshtrohen silazhimit në një pH prej 4 ose më poshtë, me acid formik ose acid tjetër organik të autorizuar në përputhje me legjin për mirëqenien e kafshëve. Silazhi i peshkut që rezulton duhet të jetë një suspension i pjesëve të kafshëve akuatike të lëngëzuara nga veprimi i enzimave endogjene në prani të acidit të shtuar. Proteinat e kafshëve akuatike duhet të reduktohen në njësi më të vogla të tretshme, nga enzimat dhe acidi, në mënyrë që të parandalohet prishja mikrobike. Materiali i silazhuar transportohet në fabrikën e përpunimit.

2.2. Në fabrikën e përpunimit, materiali i konzervuar i kafshëve akuatike duhet të futet me tubacione në depozita të mbyllura deponimi. Koha e inkubacionit duhet të jetë të paktën 24 orë në një pH prej 4 ose më poshtë përpara se të kryhet trajtimi termik. Para trajtimit termik, konzervimi i kafshëve akuatike duhet të ketë një pH prej 4 ose më të ulët dhe të ketë një madhësi grimcash më të vogël se 10 mm pas një filtrimi ose tretje në fabrikë. Gjatë përpunimit duhet t'i nënshtrohet nxehjes paraprake në një temperaturë mbi 85 °C, e ndjekur nga inkubimi në një enë të izoluar për të marrë 85 °C në të gjithë materialin e peshkut për 25 minuta. Procesi duhet të zhvillohet në një linjë të mbyllur prodhimi me rezervuar dhe tubacione.

L. Hidrotrajtim katalitik me shumë hapa për prodhimin e lëndëve djegëse të rinovueshme

1. Materialet fillestare

1. Për këtë proces, mund të përdoren vetëm nënproduktet e përcaktuara të fituara nga kafshët akuatike:

1.1. Materialet e kategorisë 2 të përcaktuara në nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 nënparagrafi 1.6.1 dhe 1.6.3 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022;

1.2. Materialet e kategorisë 3.

2. Para se të jepet autorizimi, operatorit, procedura e përhershme me shkrim e përcaktuar në nenin 29, paragrafi 1 deri në 3 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, duhet të vlerësohet nga autoriteti kompetent.

2. Metoda përpunuese

2.1. Materialet që do të trajtohen do të mblidhen në fermat e akuakulturës dhe objektet e përpunimit të ushqimit në baza ditore dhe pa vonesa të panevojshme, të grira ose të copëtuara, dhe më pas t'i nënshtrohen konzervimit në një pH prej 4 ose më poshtë, me acid formik ose acid tjetër organik të autorizuar në përputhje me legjislacionin për kafshët. Silazhi i peshkut që rezulton duhet të jetë një tretje i pjesëve të kafshëve akutike të lëngëzuara nga veprimi i enzimave endogjene në prani të acidit të shtuar. Proteinat e kafshëve akuatike duhet të reduktohen në njësi më të vogla të tretshme, nga enzimat dhe acidi, në mënyrë që të parandalohet prishja mikrobike. Materiali i konzervuar transportohet në fabrikën e përpunimit.

2.2. Në fabrikën e përpunimit, materiali i konzervuar i kafshëve akuatike duhet të futet me tubacione në depozita të mbyllura magazinimi. Koha e inkubacionit duhet të jetë të paktën 24 orë në një pH prej 4 ose më poshtë përpara se të kryhet trajtimi termik. Para trajtimit termik, procedura e konzervimit të kafshëve akuatike duhet të ketë një pH prej 4 ose më të ulët dhe të ketë një madhësi grimcash më të vogël se 10 mm pas një filtrimi ose zbutje /tretje në fabrikë. Gjatë përpunimit duhet t'i nënshtrohet nxehjes paraprake në një temperaturë mbi 85 °C, e ndjekur nga inkubimi në një enë të izoluar për të arritur 85 °C në të gjithë materialin e peshkut për 25 minuta. Procesi duhet të zhvillohet në një linjë të mbyllur prodhimi me tanke dhe tubacione

2.3. Para se të jepet autorizimi nga autoriteti kompetent, duhet të vlerësohet procedura e përhershme me shkrim e operatorit e përcaktuar në nenin 29, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 deri në 1.3 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, duhet të vlerësohet nga autoriteti kompetent.

Nënkapitulli 3

Asgjësimi dhe përdorimi i produkteve të derivuara

Produktet e derivuara nga procesimi:

Materiali i Kategorisë 1 do të:

1.1. asgjësohet në përputhje me nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 nënparagrafi 1.1.1 dhe 1.1.2 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022;

1.2. asgjësohet me groposje në deponi të mbeturinave të autorizuar;

1.3. shndërruar në biogaz. Në këtë rast, mbetjet e tretjes duhet të asgjësohen në përputhje me nën-nënparagrafin 1.1.1 ose 1.1.2 të këtij nënparagrafi, përveç rasteve kur materiali rezulton nga përpunimi në përputhje me paragrafin 2, nënparagrafin 2.1 ose 2.2 të këtij Nënkapitulli ku mbetjet mund të përdoret në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 2, nënparagrafi 2.1 ose paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, nënparagrafi 2.2.3 i këtij neni sipas rastit; ose

1.4. procesohen tutje në derivate yndyrore për përdorim, tjetër prej ushqimit.

Materialet e Kategorisë 2 ose Kategorisë 3 do të:

1.1. asgjësohet siç parashikohet në paragrafin 1, nënparagrafi 1.1, nënparagrafi 1.1.1 ose 1.1.2, me ose pa përpunim paraprak siç përcaktohet në nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1 dhe 1.2 dhe nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) – Nr. 05/2022;

1.2. të përpunuara më tej në derivate yndyrore për përdorime të tjera përveç ushqimit;

1.3. përdoren si fertilizues organik ose përmirësues të tokës; ose

1.4. kompostohen ose shndërrohen në biogaz.

2. Materialet që rezultojnë nga përpunimi në përputhje me:

2.1. procesin e hidrolizës alkaline të përcaktuar në pikën A të Nenkapitullit 2 mund të transformohet në fabrikën e biogazit dhe pastaj të digjen shpejt në minimum 900 grad përcjellur me ftohje të shpejtë ku materiali i përcaktuar në nenin 8 paragrafi 1 dhe nënparagrafi 1.2 i Udhëzimit Administrativ 05/2022 është përdorur si material fillestar, transformimi në biogas do të bëhet në të njëjtin vend si përpunimi dhe në sistem të mbyllur.

3. procesi i prodhimit të biodizelit mund të jetë:

3.1. në rast të biodizelit dhe të mbetjeve nga destilimi i biodizelit, të përdorur si karburant pa kufizime sipas këtij Udhëzimi administrativ;

3.2. në rast të sulfat kaliumit, të përdorur për prodhim të produkteve të përfituara për aplikim në tokë;

3.3. në rast të glicerinës të përfitur nga materiali i Kategorisë 1 ose Kategorisë 2 i cili është përpunuar në përputhje me metodën e përpunimit 1 siç është përcaktuar në Kapitullin III, të të kësaj Shtojce,

3.3.1. përdoret për qëllime teknike;

3.3.2. transformuar në biogaz, në të cilin rast mbetjet e tretjes mund të aplikohen në tokë brenda territorit kombëtar, në varësi të vendimit të autoritetit kompetent, ose

3.3.3. përdoret për denitrifikimin në një impiant për trajtimin e ujërave të zeza, në të cilin rast mbetjet e denitrifikimit mund të aplikohen në tokë në përputhje me legjislacionin në lidhje me trajtimin e ujërave të zeza urbane;

3.3.4. në rastin e glicerinës që përfitohet nga materiali i kategorisë 3.

3.3.5. përdoret për qëllime teknike,

3.3.6. transformohet në biogaz, me ç'rast mbetjet e tretjes mund të aplikohen në tokë, ose

3.3.7. përdoret për ushqim, me kusht që glicerina të mos rrjedh nga materiali i kategorisë 3 të referuar në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.14, 1.15 dhe 1.16 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 i cili për nën produktet e kafshëve dhe produktet e përfuara prej tyre që nuk janë të destinuara për konsum njerëzor.

4. Procesi katalitik me shumë hapa për prodhimin e lëndëve djegëse të rinovueshme mund të jetë:

4.1. në rastin e benzinës dhe lëndëve tjera djegëse që përfitohen nga procesi, që përdoren si lëndë djegëse pa kufizime sipas këtij Udhëzimi Administrativ;

4.2. në rastin e argjilës së përdorur nga zbardhja dhe llumi nga procesi i para-trajtimin të referuar në pikën J, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 i Nënkapitullit 2 të këtij Kapitulli;

4.3. asgjësohen me djegie ose bashkëdjegie;

4.4. shndërruar në biogaz;

4.5. kompostohen ose përdoren për prodhimin e produkteve të përfuara të cilat janë të përcaktuara në nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1., nën-paragrafi 1.1.1 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022;

4.6. përzierja e trajtuar me gëlqere e plehut organik të derrit dhe shpendëve mund të aplikohet në tokë si pleh organik i përpunuar;

4.7. Produkti përfundimtar që përfitohet nga sillazhimi i materialit të peshkut mund të:

4.7.1. për materialet e Kategorisë 2, që përdoren për qëllimet e përcaktuara në nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafët 1.1 deri 1.4 dhe 1.7 deri 1.9 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 pa përpunim të mëtejshëm ose si ushqim për kafshët e përcaktuara në nenin 18 ose nenin 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. nën- nën -paragrafi 1.1.2 i këtij Udhëzimi Administrativ; ose

4.7.2. për materialet e kategorisë 3, që përdoren për qëllimet e përcaktuara në nenin 14 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022;

5.1. hidrotrajtimi katalitik me shumë hapa për prodhimin e lëndëve djegëse të rinovueshme mund të jetë:

5.1.1. në rastin e naftës së rinovueshme, karburantit të rinovueshëm të avionëve, propanit të rinovueshëm dhe benzinës së ripërtëritshme që rezulton nga procesi, që përdoret si lëndë djegëse pa kufizime sipas këtij Udhëzimi Administrativ;

5.1.2. në rastin e llumit të gomës dhe argjilës zbardhuese të përdorur nga procesi i para-trajtimin të përcaktuar në pikën L, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 i Nënkapitullit 2 të këtij kreu:

5.1.2.1. asgjësohet në përputhje me nenin 12, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 ose 1.2 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022,

5.1.2.2. Asgjësohen me groposje në deponinë e autorizuar;

5.1.2.3. transformohet në biogaz, me kusht që mbetjet e tretjes nga transformimi i biogazit të asgjësohen me djegie, bashkë-djegje ose groposje në një vendgroposje / Deponi të autorizuar,

5.1.2.4. përdoret për qëllime teknike nga neni 36, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nënparagrafi 1.1.1 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr.05/2022.

6. Çdo mbetje, përveç nënprodukteve shtazore dhe produkteve të përfituara, të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij nënkapitulli, që rezultojnë nga përpunimi i nënprodukteve shtazore në përputhje me këtë seksion, të tilla si llumi, përmbajtja e filtrit, hiri dhe mbetjet e tretjes, duhet të asgjësohet në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 dhe me këtë Udhëzim Administrativ.

SHTOJCA III

TRANSFORMIMI I NËNPRODUKTEVE SHTAZORE DHE PRODUKTEVE TË DERIVUARA NË BIOGAS, KOMPOST

KAPITULLI 1

KËRKESAT E APLIKUESHME NË FABRIKA

Nënkapitulli 1 Fabrikat e biogazit

1. Fabrika e biogazit duhet të jetë e pajisur me njësinë e pasterizimit/higjenizimit, e cila nuk mund të tejkalohet nga nën produktet shtazore ose produktet e përfituara që hyjnë me madhësi maksimale të copave prej 12 mm para se të hyjnë në njësi, me:

1.1. matës, për monitorim që temperatura prej 70°C arrihet gjatë kohës prej 1 ore;

1.2. mjetet për regjistrim, për të regjistruar vazhdimisht rezultatet e matjeve të monitorimit të përcaktuara në nën paragrafin 1.1. të këtij paragrafi dhe

1.3. sistemin adekuat për të parandaluar ngrohjen e pamjaftueshme.

2. Me përjashtim të paragrafit 1 të këtij nënkapitulli, një njësi pasterizimi/higjenizimi nuk do të jetë e detyrueshme për impiantet e biogazit që transformojnë vetëm:

2.1. material të Kategorisë 2 që është procesuar në pajtim me metodën e procesimit 1 siç është përcaktuar në Kapitullin III të Shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ;

2.2. material të Kategorisë 3 që është procesuar në pajtim me çdo metodë të procesimit prej 1 deri 5 ose metodë të procesimit 7, ose në rast të materialit me origjinë nga kafshët akuatike, çdo metodë të procesimit prej 1 deri 7, siç është përcaktuar në Kapitullin III të Shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ;

2.3. material të Kategorisë 3 që i është nënshtruar pasterizimit/higjienizimit në ndonjë fabrikë tjetër të aprovuar;

2.4. nën produkte shtazore që mund të përdoren si lëndë e parë pa procesim në pajtim me Nenin 13 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 dhe me këtë Udhëzim Administrativ, nëse autoriteti kompetent nuk konsideron se ato paraqesin rrezik të përhapjes së ndonjë sëmundje të transmetueshme serioze. për njerëzit ose kafshët;

2.5. nën produkte shtazore që i janë nënshtruar procesit të hidrolizës alkaline siç është përcaktuar në pikën A të Nënkapitullit 2 të Kapitullit IV të Shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ;

2.6. nënproduktet shtazore si në vijim, nëse janë autorizuar nga autoriteti kompetent:

2.6.1. nënproduktet shtazore të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, të cilat i janë nënshtruar përpunimit siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi Për higjienën e produkteve ushqimore në kohën kur ato janë të destinuara për qëllime tjera përveç konsumi njerëzor;

2.6.2. nënproduktet shtazore të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022; ose

2.6.3. nënproduktet shtazore të cilat transformohen në biogaz, ku mbetjet e tretjes më pas kompostohen ose përpunohen ose asgjësohen në përputhje me këtë Udhëzim Administrativ.

3. Nëse fabrika e biogazit është e vendosur në ose afër hapësirave ku kafshët e fermës mbahen dhe fabrika e biogazit nuk përdor vetëm plehun, qumështin ose kulloshtrenë që del nga ato kafshë, fabrika do të vendoset në një distancë nga zona ku kafshët e tilla mbahen.

4. Ajo distancë do të caktohet në mënyrë që të sigurohet se nuk ka rrezik të papranueshëm për bartjen e sëmundjeve të transmetueshme në njerëz ose kafshë nga fabrika e biogazit.

5. Në të gjitha rastet, duhet të jetë një ndarje totale fizike mes fabrikës së biogazit dhe kafshëve, ushqimit dhe shtrojes së tyre, ku është e nevojshme.

6. Çdo fabrikë e biogazit duhet të ketë laboratorin e vet ose përdorë laborator të jashtëm. Laboratori duhet të jetë i pajisur për të kryer analizat e nevojshme dhe të jetë i aprovuar nga autoriteti kompetent, të jetë i akredituar sipas standardeve të pranuar ndërkombëtarisht ose t'i nënshtrohet kontrollave të rregullta nga Autoriteti Kompetent.

Nënkapitulli 2

Fabrikat e kompostimit

1. Fabrika e kompostimit duhet të jetë e pajisur me reaktor të mbyllur për kompostim ose zonë të mbyllur, e cila nuk mund të tejkalohet nga nën produktet shtazore ose produktet e derivuara që hyjnë në fabrikë, dhe ajo duhet të jetë e pajisur si në vijim:
 - 1.1. matesit për monitorim të temperaturës në raport me kohën;
 - 1.2. regjistruarit për të regjistruar, ku është e nevojshme vazhdimisht, rezultatet e matjeve të monitorimit të përcaktuara në nënparagrafi 1.1 i këtij paragrafi;
 - 1.3. sistem adekuat të sigurisë për të parandaluar ngrohjen e pamjaftueshme;
2. Me anë të derogimit nga paragrafi 1, llojet e tjera të kompostimit mund të lejohen nëse ato:
 - 2.1. menaxhohen në atë mënyrë që i gjithë materiali në sistem të arrijë parametrat e kërkuara të kohës dhe temperaturës, sipas nevojës duke përfshirë, monitorimin e vazhdueshëm të parametrave; ose
 - 2.2. transformojnë vetëm materialet e përcaktuara në paragrafin 2 të Nënkapitullit 1 të këtij Kapitulli ; dhe plotësojnë të gjitha kërkesat relevante të këtij Udhëzimi Administrativ.
3. Nëse fabrika e kompostimit është e vendosur në ose afër hapësirave ku kafshët e fermës mbahen dhe fabrika e kompostimit nuk përdor vetëm plehun, qumështin ose kulloshtrenë që dalin nga këto kafshë, fabrika e kompostimit do të vendoset në distancë prej zonës ku mbahen kafshët.
4. Ajo distancë do të caktohet në mënyrë që të sigurohet se aty nuk ka rrezik të papranueshëm për bartjen e sëmundjeve të transmetueshme tek njerëzit ose kafshët nga fabrika e kompostimit.
5. Në të gjitha rastet, duhet të ketë ndarje totale fizike mes fabrikës së kompostimit dhe kafshëve, ushqimit dhe shtrojes së tyre, aty ku është e nevojshme.
6. Çdo fabrikë e kompostimit duhet të ketë laboratorin e vet ose përdorë laborator të jashtëm. Laboratori duhet të jetë i pajisur për të kryer analizat e nevojshme dhe të jetë i aprovuar nga autoriteti kompetent, të jetë i akredituar sipas standardeve të pranura ndërkombëtarisht ose t'i nënshtrohet kontrollave të rregullta nga autoriteti kompetent.

KAPITULLI II

KËRKESAT E HIGJENËS TË APLIKUESHME NË FABRIKAT E BIOGAZIT DHE KOMPOSTIMIT

1. Nënproduktet shtazore duhet të transformohen sa më shpejtë të jetë e mundur pas arritjes në fabrikën e biogazit apo kompostimit. Ato duhet të magazinohen si duhet deri në trajtim.

2. Kontejnerët, enët - bombolet dhe automjetet e përdorura për transportimin e materialeve të patrajtuara duhet të pastrohen dhe dezinfektohen në një zonë të caktuar. Ajo zonë duhet të vendoset ose planifikohet ashtu që të parandalohet rreziku nga kontaminimi i produkteve të trajtuara.
3. Masat preventive ndaj zogjëve, brejtësve, insekteve ose dëmtuesve tjerë duhet të meren në mënyrë sistematike. Një program i dokumentuar i kontrollit të dëmtuesve duhet të përdoret për atë qëllim.
4. Procedurat e pastrimit duhet të dokumentohen dhe vendosen për të gjitha pjesët e hapësirave. Pajisjet e përshtatshme dhe mjetet e pastrimit duhet të sigurohen për pastrim.
5. Kontrolla e higjienës duhet të përfshijë inspektimet e rregullta të ambientit dhe pajisjeve. Oraret e inspektimit dhe rezultatet duhet të dokumentohen.
6. Instalimet dhe pajisjet duhet të mbahen në gjendje të mirë të riparimit dhe pajisjet e matjes duhet të kalibrohen në intervale të rregullta.
7. Mbetjet e tretjes dhe kompostimit duhet të trajtohen dhe magazinohen në fabrikë të biogazit ose kompostimit në atë mënyrë që të parandalohet rikontaminimi.

KAPITULLI III

PARAMETRAT E TRANSFORMIMIT

Nënkapitulli 1

Parametrat standarde të transformimit

1. Materiali i Kategorisë 3 i cili përdoret si lëndë e parë në fabrikën e biogazit të pajisur me njësinë e pasterizimit dhe higjienizimit duhet të iu nënshtrohen kërkesave minimale në si ne vijim:
 - 1.1. madhësia maksimale e copave para hyrjes në njësi: 12 mm;
 - 1.2. temperatura minimale në të gjitha materialet në njësi: 70°C; dhe
 - 1.3. koha minimale në njësi pa ndërprerje: 60 minuta.
2. Sidoqoftë, qumështi, produktet me bazë qumështi, produktet e derivuara të qumështit, kulloshtira dhe produktet e kulloshtirës, mund të përdoren pa pasterizim dhe higjienizim si lëndë e parë në fabrikën e biogazit, nëse autoriteti kompetent nuk konsideron se ato paraqesin rrezik për përhapjen e ndonjë sëmundje serioze të transmetueshme të njerëzit apo kafshët.
3. Nënparagrafët 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1 të këtij neni do të zbatohen edhe për materialin e kategorisë 2 i cili futet në impiantin e biogazit pa përpunim paraprak në përputhje me nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, nënparagrafi 1.5.2 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022.

4. Materiali i Kategorisë 3 i cili përdoret si lëndë e parë në fabrikën e kompostimit duhet t'i nënshtrohet kërkesave minimale si në vijim:

4.1. madhësia maksimale e copave para hyrjes në reaktorin e kompostimit: 12mm;

4.2. temperatura minimale në të gjitha materialet në reaktor: 70°C; dhe

4.3. koha minimale pa ndërprerje: 60 minuta.

5. Kërkesat minimale të përcaktuara në nënparagrafin 4.2 dhe 4.3 të paragrafit 4 të këtij neni do të zbatohen edhe për materialin e kategorisë 2 i cili kompostohet pa përpunim paraparak në përputhje me nenin 13, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, nënparagrafi 1.5.2 i. Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022.

Nënkapitulli 2

Parametrat alternative të transformimit për fabrikat e biogazit dhe kompostimit

1. Autoriteti kompetent mund të autorizojë përdorimin e parametrave tjere prej parametrave të përcaktuara në paragrafin 1 të Nënkapitullit 1 të Kapitullit I të kësaj Shtojca, përveç parametrave standarde të transformimit, nëqoftëse aplikanti për përdorim të tillë demonstroi se parametrat e tillë sigurojnë zvogëlim adekuat të rreziqeve biologjike. Ky demonstrim do të përfshijë një validim, i cili do të kryhet në pajtim me kërkesat si në vijim:

1.1. identifikimi dhe analizat e rreziqeve të mundshme, përfshirë ndikimin e materialit hyrës, bazuar në përshkrimin e plotë të kushteve dhe parametrave të transformimit;

1.2. vlerësimi i rrezikut, i cili vlerëson se si kushtet specifike të transformimit të përcaktuara nënparagrafi 1.1 i këtij paragrafi janë arritur në praktikë në situata normale dhe atipike;

1.3. Validimi i procesit të synuar me matjen e zvogëlimit të zbatueshmërisë dhe infektueshmërisë së:

1.3.1. organizmave tregues endogjen gjatë procesit, ku treguesi (indikatori) është:

1.3.1.1. prezent në mënyrë konsistente në lëndë të parë me numra të lartë,

1.3.1.2. jo më pak rezistent në nxemje në aspektet letale (e vdekjes) të procesit të transformimit, por gjithashtu jo më shumë rezistent në mënyrë domethënëse se sa patogjenet për të cilin janë duke u përdorur për monitorim;

1.3.1.3. relativisht i lehtë për tu përcaktuar, identifikuar dhe konfirmuar; ose

1.3.1.4. organizëm ose virus testues i karakterizuar mire, gjatë ekspozimit, që hyn në trup testues të përshtatshëm në materialin fillestar.

1.4. Validimi i procesit të synuar i përcaktuar në nënparagrafi 1.3 i këtij paragrafi duhet të demonstrojë se procesi arrin zvogëlimin e rrezikut të përgjithshëm në vijim:

1.4.1. për proceset termale dhe kimike me:

1.4.1.1. zvogëlimin e 5log 10 të *Enterococcus fecalis* ose *Salmonella* Senftenberg (775W, H2S negative);

1.4.1.2. zvogëlimin e titrit të infektivitetit të viruseve termorezistent si parvovirusi prej së paku 3 log10, kurdo që ato janë identifikuar si hazard relevant; dhe sa i përket proceseve kimike gjithashtu me:

1.4.1.3. një zvogëlim të parazitëve rezistent si vezët e *Ascaris* spp. Prej së paku 99,9 % (3 log 10) të fazave të suksesshme - zbatueshme;

1.5. hartimi i një programi të plotë kontrolli duke përfshirë procedurat për monitorimin e funksionimit të procesit të përcaktuar në nënparagrafin 1.3 të këtij paragrafi;

1.6. masat që sigurojnë monitorimin dhe mbikqyrjen e vazhdueshme të parametrave relevant të procesit të përcaktuar në programin e kontrollit gjatë operimit të fabrikës. Detajet mbi parametrat relevant të procesit të përdorura në fabrikën e biogazit apo kompostimit si dhe pikat tjera kritike të kontrollit duhet të regjistrohen dhe mbahen ashtu që pronari, operatori ose përfaqësuesi i tyre dhe autoriteti kompetent mund të monitorojnë operimin e fabrikës. Shënimet (të dhënat) nga operatori duhet t'i vihen në dispozicion autoritetit kompetent sipas kërkesës. Informacioni në lidhje me një proces të autorizuar sipas kësaj pike sipas kërkesës duhet t'i vihet në dispozicion Komisionit Evropian.

1.7. me përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, në pritje të miratimit të rregullave të përcaktuara në nenin 15, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, nënparagrafi 2.1.2 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, autoriteti kompetent mund të autorizojë përdorimin e kërkesave specifike të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë Kapitull, me kusht që ato të garantojnë një efekt ekuivalent në lidhje me reduktimin e patogjenëve, për:

1.7.1. mbeturinat hotelerike të përdorura si nën produkt i vetëm shtazor në fabrikën e biogazit apo kompostimit; dhe

1.8. përzierjet e mbeturinave hotelerike me materialet në vijim:

1.8.1. plehun;

1.8.2. përmbajtjet e traktit tretës të ndara nga trakti i tretës;

1.8.3. qumështin;

1.8.4. produktet me bazë të qumështit;

1.8.5. produktet e derivuara nga qumështi;

1.8.6. kulloshtira;

1.8.7. produktet e kulloshtres;

1.8.8. vezet;

1.8.9. produktet e vezëve;

1.8.10. nënproduktet shtazore të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, të cilat i janë nënshtruar përpunimit siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi Për higjienën e produkteve ushqimore;

1.8.11. përzierjet e nënprodukteve shtazore të përcaktuara në paragrafin 2, nënparagrafin 2.2 të këtij nënkapitulli me materialet e nënprodukteve me origjinë jo shtazore.

1.9. Kur materialet e përcaktuara në paragrafin 2, nënparagrafi 2.2. të këtij nënkapitulli ose produktet e derivuara të përcaktuara në nenin 10 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 janë i vetmi material fillestar me origjinë shtazore që trajtohet në një fabrikë biogazi ose kompostimi, autoriteti kompetent mund të autorizojë përdorimin e kërkesave specifike të ndryshme nga ato të specifikuara në këtë Kapitull me kusht që ai:

1.9.1. konsideron se mbetjet e tretjes ose komposti janë materiale të papërpunuara dhe i obligon operatorët që t'i trajtojnë ato në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, dhe këtë Udhëzim Administrativ ose, në rastin e mbetjeve të kompostimit ose tretjes që rrjedhin nga mbetjet e ushqimit, të rikuperohen ose asgjësohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mjedis.

1.10. Operatorët mund të vendosin në treg mbetjet e tretjes dhe kompostit, të cilat janë prodhuar sipas parametrave të cilët janë autorizuar nga autoriteti kompetent:

1.10.1. në pajtim me paragrafin 1 të këtij nënkapitulli;

1.10.2. në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 të këtij nënkapitulli.

Nënkaptulli 3 **Standardet për mbetjet e tretjes dhe kompostit**

1. Mostrat përfaqësuese të mbetjeve të tretjes ose kompostit të marra gjatë ose;

1.1. menjëherë pas transformimit në fabrikën e biogazit ose kompostimit në fabrikën e kompostimit me qëllim monitorimin e procesit duhet të jetë në përputhje me standardet si në vijim:

1.1.1. *Escherichia coli*: $n = 5$, $c = 1$, $m = 1\ 000$, $M = 5\ 000$ në 1 g; ose

1.1.2. *Enterococcaceae*: $n = 5$, $c = 1$, $m = 1\ 000$, $M = 5\ 000$ në 1 g; dhe.

1.2. Mostrat reprezentative të mbetjeve të tretjes ose kompostit të marra gjatë ose kur tërhiqen nga magazina duhet të plotësojnë standardet si ne vijim:

1.2.1. Salmonella: mungese in 25 g; $n = 5$; $c = 0$; $m = 0$; $M = 0$;

1.2.2. Ku në rast të nënparagrafit 1.2 të këtij paragrafi:

1.2.2.1. n = numri i mostrave që do të testohen;

1.2.2.2. m = pragu i vlerës për numrin e baktereve;

1.2.2.3. rezultati konsiderohet i kënaqshëm nëse numri i baktereve në të gjitha mostrat nuk e tejkalon m ;

1.2.2.4. M = vlera maksimale për numrin e baktereve;

1.2.2.5. rezultati konsiderohet i pakënaqshëm nëse numri i baktereve në një ose më shumë mostra është M ose më teper; dhe

1.2.2.6. c = numri i mostrave numri bakterial i të cilave mund të jetë midis m dhe M , mostra ende konsiderohet e pranueshme nëse numri bakterial i mostrave tjera është m ose më pak.

1.3. Mbetjet e tretjes ose kompostit, të cilat nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara ne paragrafin 3, nën paragrafi 3.2 të Nënkapitullit 2 të këtij Kapitulli, do të rinënshtrohen transformimit ose kompostimit, dhe në rast të Salmonellës do të trajtohen ose hedhen në pajtim me udhëzimet e autoritetit kompetent.

3. Kur nënproduktet shtazore transformohen në biogaz ose kompostohen së bashku me materiale që nuk janë me origjinë shtazore, autoriteti kompetent mund të autorizojë operatorët të marrin mostra përfaqësuese pas pasterizimit të përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.1 i Nënkapitullit 1 të Kapitullit I. të kësaj Shtojce ose pas kompostimit të përcaktuar në paragrafin 1 të Nënkapitullit 2 të kreut I të kësaj shtojce, sipas rastit, dhe përpara se të bëhet përzierja me materiale që nuk janë me origjinë shtazore, me qëllim monitorimin e efikasitetit të transformimit ose kompostimit. të nënprodukteve shtazore, sipas rastit.

SHTOJCA IV

RREGULLAT SPECIALE MBI HULUMTIMIN, USHQYERJEN, GRUMBULLIMIN DHE ASGJASIMIN

KAPTILLULLI I

RREGULLAT E VEQANTA MBI MOSTRAT PËR HULUMTIM DHE QELLIME TJERA

Nënkapiulli 1

Mostrat e hulumtimit dhe diagnostikimit

1. Operatorët do të sigurojnë se ngarkesat e mostrave të hulumtimit dhe diagnostikimit janë të shoqëruara me dokument komercial, i cili duhet të specifikojë:
 - 1.1. përshkrimin e materialit dhe origjinën e llojit të kafshës;
 - 1.2. kategorinë e materialit;
 - 1.3. sasinë e materialit;
 - 1.4. vendin e origjinës dhe vendin e dërgimit të materialit;
 - 1.5. emrin dhe adresën e dërguesit;
 - 1.6. emrin dhe adresën e marrësit dhe të përdoruesit.
2. Përdoruesit që trajtojnë mostrat hulumtuese dhe diagnostikuese do të marrin të gjitha masat e nevojshme për të shmangur përhapjen e sëmundjeve të transmetueshme të njerëzit ose kafshët gjatë trajtimit të materialeve nën kontrollin e tyre, posaqërisht me anë të aplikimit të praktikave të mira laboratorike.
3. Çdo përdorim i mëpasëm i mostrave të hulumtimit dhe diagnostikimit për qëllime tjera prej atyre të përcaktuara në paragrafi 1, nënparagrafi 1.38 i nenit 3 të këtij Udhëzimi Administrativ do të ndalohet.
4. Përveç nëse ato mbahen për qëllime të referimit, mostrat e hulumtimit dhe diagnostikimit dhe çdo produkt i derivuar nga përdorimi i atyre mostrave do të hedhen:
 - 4.1. si mbeturina me incinerim ose koincinerim;
 - 4.2. në rastin e nënprodukteve shtazore ose produkteve të përfituara të përcaktuara në nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nën-nën paragrafi 1.1.4, neni 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 dhe 1.4 dhe neni 9 dhe 10 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 të cilat janë pjesë e kulturave qelizore, kiteve laboratorike ose mostrave laboratorike, me një trajtim në kushte që janë të paktën ekuivalente me metodën e vërtetuar për avull autoklava dhe asgjësimi i mëpasshëm si mbeturina ose ujëra të zeza në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi;
 - 4.3. me sterilizimin nën presion dhe asgjësimin ose përdorimin e mëvonshëm në përputhje me nenet 12, 13 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022.
5. Përdoruesit që trajtojnë mostrat e hulumtimit dhe diagnostikimit do të mbajnë një regjistër të ngarkesave të mostrave të tilla. Regjistri do të përfshijë informatat e përcaktuara në paragrafi 1 i këtij neni dhe datën dhe metodën e hedhjes së mostrave dhe të çdo produkti të derivuar.

6. Duke përjashtuar paragrafët 1, 4 dhe 5 të këtij nenkapitulli, autoriteti kompetent mund të pranojë trajtimin dhe asgjësimin e mostrave kërkimore dhe diagnostikuese për qëllime edukative nën kushte të tjera që sigurojnë që të mos krijohen rreze të papranueshme për shëndetin publik ose të kafshëve.

Nenkapitulli 2

Mostrat e tregtisë dhe njësitë e ekspozimit

1. Mostrat e tregtisë dhe artikujt e ekspozuar mund të transportohen, përdoren dhe asgjësohen vetëm në përputhje me paragrafët 1 deri në 4 dhe 6 të Nenkapitullit 1 të këtij kapitulli.

2. Përveç nëse mostrat e tregtisë mbahen për qëllime të referimit, pasi të jenë përfunduar studimet apo analizat e veçanta, ato do të:

2.1. ridërgohen në Shtetin e origjinës;

2.2. dërgohen në Shtet tjetër ose vend të tretë, nëse dërgesa e tillë është autorizuar paraprakisht nga autoriteti kompetent i atij Shteti ose vendit të tretë të destinimit; ose

2.3. asgjësohet ose përdoret në përputhje me nenet 12, 13 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022.

3. Pas përfundimit të ekspozitës ose të veprimtarisë artistike, artikujt e ekspozuar do të ridërgohen në vendin e origjinës, do të dërgohen ose asgjësohen, në përputhje me paragrafin 2 të këtij nenkapitulli.

KAPITULLI II

REGULLAT E VEÇANTA TË USHQYERJES

Nenkapitulli 1

Kërkesat e përgjithshme

1. Materialet e kategorive 2 dhe 3 të përcaktuara në nenin 18, paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, mund t'u ushqehen kafshëve. të përcaktuara në paragrafin 1, nënparagrafi 1.1, 1.2, 1.4, 1.6, 1.7, 1.8 të atij neni, duke iu nënshtruar respektimit të paktën me kushtet si vijon, përveç kushteve të përcaktuara nga autoriteti kompetent në përputhje me nenin 18, paragrafi 1. të atij Udhëzimi Administrativ.

2. Nënproduktet e kafshëve do të transportohen te përdoruesit ose në qendrat e grumbullimit në përputhje me nenet 1 dhe 3 të kreut I të Shtojcës VI të këtij Udhëzimi Administrativ.

3. Qendrat e grumbullimit do të regjistrohen nga autoriteti kompetent, nëqoftëse:

3.1. janë në përputhje me kërkesat për impiantet që kryejnë operacionet e ndërmjetme të përcaktuara në kapitullin II të Shtojcës VII të këtij Udhëzimi Administrativ; dhe

3.2. ato kanë hapësira adekuate për shkatërrimin e materialeve të papërdorura, ose i dërgojnë ato në një fabrikë të aprovuar të procesimit ose në një fabrikë të aprovuar të incinerimit dhe koincinerimit në pajtim me këtë udhëzim administrativ.

4. Autoriteti Kompetent mund të autorizojë përdorimin e fabrikës së procesimit për material të Kategorisë 2 si qendër të grumbullimit.

5. Operatorët e qendrave të grumbullimit që furnizojnë me material, tjetër prej nënprodukteve shtazore me origjinë prej kafshëve akuatike dhe nga pakurizorët akuatikë, duhet të sigurojnë përdoruesit final se ai i nënshtrohet njërit nga trajtimet si në vijim:

5.1. denatyrimit me një tretesire me agjent ngjyrosës;

5.2. tretesira duhet të jetë i asaj fuqie që ngjyrosja në materialin e shenjuar të jetë qartë i dukshëm dhe nuk zhduket kur materialet me ngjyra i nënshtrohen ngrirjes ose ftofjes, dhe e gjithë sipërfaqja e të gjitha pjesëve të materialit duhet të jetë e mbuluar me tretesire të tillë, me anë të zhytjes së materialit, ose duke e spërkatur me sprej apo aplikimit të tretesires në ndonjë menyre të ndryshme;

5.3. sterilizimit me zierje ose avullim nën presion derisa secila pjesë e materialit të jetë zier tërësisht; ose

5.4. çdo trajtimi apo përpunimi tjetër të autorizuar nga autoriteti kompetent përgjegjës për operatorin.

Nënkapitulli 2

Ushqyerja e llojeve të caktuara të kafshëve në stacionet e ushqyerjes

1. Autoriteti kompetent mund të autorizojë përdorimin e materialit të Kategorisë 1 të përcaktuar në nenin 18, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 për ushqimin e specieve të rrezikuara dhe të mbrojtura në stacionet e ushqimit në kushtet si në vijim:

1.1. materiali duhet tu jepet për ushqyerje:

1.1.1. njërit nga speciet në vijim të zogjëve nekrofagus në territorin e Republikës së Kosovës;

1.1.2. një nga speciet e rendit të mishngrënësve që janë të listuara në legjislacionin specifik për ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës dhe florës së egër në zona të veçanta të ruajtjes që janë krijuar sipas atij legjislacioni specifik; ose

1.1.3. një nga speciet e rendit Falconiformes ose Strigiformes, të cilat janë të përcaktuara në legjislacionin specifik për ruajtjen e shpendëve të egër, në zona të veçanta të mbrojtjes që janë krijuar sipas atij legjislacioni specifik;

1.1.4. Autoriteti kompetent i ka dhënë autorizimin operatorit përgjegjës për stacionin e ushqyerjes.

1.2. Autoriteti kompetent do të jap një autorizim të tillë në qoftëse:

1.2.1. ushqimi nuk përdoret si mënyrë alternative e hudhjes së materialeve të specifikuara me rrezik ose hudhjes së ripertypseve së ngordhur që përmbajnë material të tillë që paraqet rrezik të TSE-së;

1.2.2. ekziston një sistem adekuat i mbikëqyrjes për TSE-të siç është përcaktuar në legjislacionin në fuqi për Kontrollin, Parandalimin dhe Çrrënjosjen e TSE-ve në Kosovë që përfshin testimin e rregullt laboratorik të mostrave për TSE;

1.3. Autoriteti kompetent duhet të sigurojë koordinimin me çdo autoritet tjetër kompetent që është përgjegjës për mbikëqyrjen e kërkesave të përcaktuara në autorizim;

1.4. Autoriteti kompetent duhet të jetë i kënaqur, në bazë të vlerësimit të situatës specifike të specieve në fjalë dhe habitatit të tyre, se statusi i konzervimit të specieve do të përmirësohet;

1.5. Autorizimi i dhënë nga autoriteti kompetent duhet:

1.5.1. t'i referohet emrit të species që aktualisht është në fjalë;

1.5.2. përshkruaje detajisht lokacionin e stacionit të ushqyerjes në zonën gjeografike ku ushqyerja zhvillohet; dhe

1.5.3. suspendohet 1.5.3. menjëherë në rast të:

1.5.3.1. një rast lidhur dhe të dyshuar apo konfirmuar për shpërndarjen e TSE-së derisa rreziku të përjashtohet, ose

1.5.3.2. mos përputhjes me ndonjë rregull të përcaktuar në këtë Udhëzim Administrativ

1.6. Operatori përgjegjës për ushqyerje do të:

1.6.1. dedikojë një zonë për ushqyerje e cila është e mbyllur dhe në të cilën qasja është e kufizuar për kafshë të specieve që do të konservohen, nëse është e përshtatshme me ndarje ose mënyra tjera të cilat korrespondojnë me format natyrore të ushqyerjes së atyre specieve;

1.6.2. të sigurojë që trupat e pranueshëm të gjedhit dhe të paktën 4% e trupave të pranueshëm të deleve dhe dhive të destinuara për t'u përdorur për ushqim janë testuar para atij përdorimi me rezultat negativ, në programin e monitorimit të TSE të kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi Për Kontrollin, Parandalimin dhe Çrrënjosjen e TSE-ve në Kosovë; dhe

1.6.3. mban regjistra të paktën për numrin, natyrën, peshën e vlerësuar dhe origjinën e karakaseve të kafshëve të përdorura për ushqim, datën e ushqyerjes, lokacionin ku është zhvilluar ushqyerja dhe nëse e zbatueshme, rezultatet e testeve të TSE-së.

Nënkapitulli 3

Ushqyerja e kafshëve të egra jashtë stacioneve të ushqyerjes

1. Autoriteti kompetent mund të autorizojë përdorimin e materialit të Kategorisë 1 që përbëhet nga trupat e plotë ose pjesët e kafshëve të ngordhura që përmbajnë materiale specifike të rrezikshme jashtë stacioneve të ushqyerjes, nëse është e përshtatshme pa grumbullim paraprak të kafshëve të ngordhura, për ushqyerje të kafshëve të egra të përcaktuara në pikën paragrafi, nënparagrafi 1.1 i Nënkapitullit 2 të kësaj Shtojce, nën kushtet si në vijim:

1.1. Autoriteti kompetent duhet të sigurohet, në bazë të një vlerësimi të situatës specifike të specieve në fjalë dhe habitatit të tyre, se statusi i konservimit të species do të përmirësohet;

1.2. Autoriteti kompetent duhet të identifikojë në autorizim, pronat ose tufat brenda një zone të ushqyerjes të definuar gjeografikisht nën kushtet si në vijim:

1.2.1. zona e ushqyerjes duhet të mos zgjerohet në zonat ku zhvillohet kultivimi intenziv i kafshëve në ferma;

1.2.2. kafshët e fermave në prona ose tufa në zonën e ushqyerjes duhet të jenë nën mbikqyrje të rregullt të një veterineri zyrtar në lidhje me prevalencën e TSE-së dhe të sëmundjeve të transmetueshme tek njerëzit apo kafshët;

1.2.3. ushqyerja duhet të pezullohet menjëherë në rast të:

1.2.3.1. lidhjes së dyshuar apo konfirmuar me përhapjen e TSE-së në pronë ose tufë, derisa rreziku të mund të përjashtohet;

1.2.3.2. epidemisë së dyshuar apo konfirmuar të një sëmundje serioze të transmetueshme të njerëzit apo kafshët në një pronë apo tufë, derisa rreziku të mund të përjashtohet; ose

1.2.3.3. mos përputhjes me ndonjë nga rregullat e dhëna në këtë udhëzim administrativ.

1.3. Autoriteti kompetent duhet të specifikojë në autorizim:

1.3.1. masat e duhura për të parandaluar transmetimin e TSE-së dhe sëmundjeve të transmetueshme nga kafshët e ngordhura të njerëzit apo kafshët tjera, siç janë masat e shenjuara në menyrat e ushqyerjes së specieve që do të konservohen, kufizimet sezonale të ushqyerjes, kufizimet e lëvizjes për kafshët e fermave dhe masat tjera që synojnë kontrollimin e rreziqeve të mundshme të transmetimit të sëmundjeve bartëse të njerëzit apo

kafshët, siç janë masat në lidhje me speciet e pranishme në zonën e ushqyerjes për ushyerjen e të cilave nën produktet shtazore nuk përdoren;

1.3.2. përgjegjësitë e personave ose entiteteve në zonën e ushyerjes që asistojnë në ushqyerje ose përgjegjësit për kafshët e fermave, në lidhje me masat e përcaktuar në nënparagrafin 2.4.1. të këtij nën paragrafi;

1.3.3. kushtet për shqiptimin e dënimeve të përcaktuar në nenin 50 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 të cilat janë të zbatueshme për shkelje të masave të përcaktuar në nënparagrafin 2.4.1 nga personat ose subjektet e përcaktuar në nënparagrafin 2.4.2 të këtij paragrafi 2.

1.4. Aty ku ushqyerja kryhet pa grumbullim paraprak të kafshëve të ngordhura, një vlerësim i shkallës së mortalitetit të mundshme të kafshëve në ferma, të cilat janë në zonën e ushqyerjes, dhe të kërkesave për ushqyerje të kafshëve të egra duhet të bëhet, si bazë për vlerësimin e rreziqeve potenciale të transmetimit të sëmundjeve.

Nënkapitulli 4

Ushqyerja e kafshëve të kopshtit zoologjik me material të Kategorisë 1

1. Autoriteti kompetent mund të autorizojë përdorimin e materialit të Kategorisë 1 që përbëhet nga trupat e plotë ose pjesët e kafshëve të ngordhura që përmbajnë material specifik të rrezikshëm dhe përdorimin e produkteve të derivuara nga kafshët e kopshteve zoologjike nën kushtet si në vijim:

1.1. autoriteti kompetent duhet t'i ketë dhënë autorizim operatorit përgjegjës për ushqyerje. Autoriteti kompetent do të japë autorizim të tillë nëqoftëse:

1.1.1. ushqyerja nuk është përdorur si mënyrë alternative e hudhjes së materialeve specifike të rrezikshme ose hudhje e trupave së ripërtypësve të ngordhur që përmban materiale të tilla që paraqesin rrezik nga TSE;

1.1.2. kur përdoret materiali i Kategorisë 1 që përbëhet nga trupa të tërë ose pjesë të kafshëve të ngordhura që përmbajnë materiale të rrezikut të specifikuar, me origjinë nga gjedhi, sistemi i duhur i mbikëqyrjes për TSE-të siç përcaktohet në legjislacionin për ushqim për kontrollin, parandalimin dhe çrrënjosja e TSE-ve në Kosovë është duke përfshirë testimin e rregullt laboratorik të mostrave për TSE;

1.2. Autorizimi i dhënë nga autoriteti kompetent duhet menjëherë të pezullohet në rast të:

1.2.1. lidhjes së dyshuar ose konfirmuar me përhapjen e TSE-së derisa rreziku të mund të përjashtohet; ose

1.2.2. mos-përputhje të ndonjëres nga rregullat e dhëna në këtë udhëzim administrativ;

1.2.3. operatori përgjegjës për ushqyerje të kafshëve do të:

1.2.3.1. magazinojë materialin që do të përdoret për ushqyerje dhe do të kryej ushqyerjen në një zonë të mbyllur dhe të rrethuar për të siguruar se asnjë kafshë mishëngrënëse, tjetër prej kafshëve të kopshtit zoologjik për të cilat është dhënë autorizimi, nuk kanë qasje në materialin për ushqyerje;

1.2.3.2. sigurojë se kafshët ripërtypëse të synuara të përdoren për ushqyerje janë përfshirë në pragramin e monitorimit të TSE-së të kryer në pajtim me legjislacionin në fuqi për kontrollin, parandalimin dhe çrrënjosjen e TSE-ve në Kosovë;

1.2.3.3. mbajë regjistra për të paktën numrin, natyrën, peshën e vlerësuar dhe origjinën e trupave të kafshëve të përdorura për ushqyerje, rezultatet e testeve të TSE-së dhe datën e ushqyerjes.

KAPITULLI III

REGULLAT E VEÇANTA PËR GRUMBULLIM DHE HUDHJE

Nënkapitulli 1

Regullat e veçanta të hudhjes të nën produktet shtazore

1. Nëse autoriteti kompetent autorizon asgjësimin e nënprodukteve shtazore në vend në përputhje me nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, asgjësimi i tillë mund të bëhet:

1.1. me djegie ose groposje në hapësirat nga të cilat e kanë origjinën nënproduktet shtazore;

1.2. në vendgroposje të autorizuar;

1.3. me djegie ose groposje në vendin i cili minimizon rrezikun për shëndetin e kafshëve, atë publik dhe për mjedisin, nëqoftëse vendi është i lokalizuar brenda gamës së distancës së mjaftueshme për të mundësuar autoritetin kompetent të menaxhoj parandalimin e rrezikut për shëndetin e kafshëve, atë publik dhe për mjedisin.

2. Djegia e nënprodukteve shtazore në lokacionet e përcaktuar në nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, duhet të kryhen në mënyrë të tillë që të sigurohet që ato të digjen:

2.1. në grumbull të konstruktuar siç duhet dhe nën produktet shtazore të jenë redukuar në hi;

2.2. pa rrezikuar shëndetin e njeriut;

2.3. pa përdorur proceset ose metodat të cilat mund të dëmtojnë ambientin, posaçërisht kur ato mund të rezultojnë në reziqe për ujë, ajër, tokë, bimë dhe kafshë ose nëpërmjet zhurmës ose aromave;

2.4. në kushte të cilat sigurojnë se hiri i rezultuar është hedhur me groposje në vendgroposje të autorizuar.

3. Groposja e nënprodukteve shtazore në vendet e përcaktuar në nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, duhet të kryhen për të siguruar që ato të groposen:

3.1. në atë mënyrë që kafshët mishëngrënëse ose gjithçka ngrënëse nuk mund të kenë çasje në to;

3.2. në vendgroposje të autorizuar ose në ndonjë vend tjetër që nuk rrezikon shëndetin e njeriut dhe duke përdorur proceset ose metodat të cilat nuk dëmtojnë mjedisin, posaçërisht kur ato mund të rezultojnë me rrezik në ujë, ajër, tokë, bimë dhe kafshë, ose nëpërmjet zhurmës ose aromave.

4. Me rastin e asgjësimit në pajtim me nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.5 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, lëvizja e nënprodukteve shtazore nga vendi i origjinës në vendin e asgjësimit duhet të kryhet sipas kushteve në vijim:

4.1. nënproduktet shtazore janë transportuar me kontejnerë të sigurtë, që nuk rrjedhin ose me automjete;

4.2. ngarkimi dhe shkarkimi i nën produkteve shtazore mbikqyret nga autoriteti kompetent, nëse është e përshtatshme;

4.3. rrotat e automjetit janë dezinfektuar kur kanë lëshuar vendin e origjinës;

4.4. kontejnerët dhe automjetet e përdorura për transportimin e nën produkteve shtazore janë pastruar dhe dezinfektuar tërësisht pas shkarkimit të nënprodukteve shtazore; dhe

4.5. përcjellje adekuate për automjetet, testimi për rrjedhje dhe mbulimi i dyfishtë janë të siguruar, nëse është e nevojshme.

Nënkapitulli 2

Djegia dhe groposja e nën produkteve shtazore në zonat e thella

1. Përqindja maksimale e përmendur në nenin 19, paragrafi 2 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, nuk duhet të kalojë sa vijon:

1.1. 10% të popullatës së gjedhit (*bovine*) të Republikës së Kosovës;

1.2. 25% e popullatës së dhenëve dhe dhive (*ovine dhe kaprine*) Republikës së Kosovës;

1.3. 10% e popullatës së derrit (*porcine*) Republikës së Kosovës;
dhe

1.4. një përqindje e popullatës të llojit tjetër i cili është përcaktuar nga autoriteti kompetent, në bazë të vlerësimit të rreziqeve të mundshme për shëndetin publik dhe të kafshëve të cilat dalin nga asgjësimi kafshëve të atyre specieve me djegie ose groposje në vendndodhje.

Nënkapitulli 3

Djedia dhe groposja e bletëve dhe nën produkteve të bletarisë

Në rastin e bletëve dhe nënprodukteve të bletarisë, autoriteti kompetent mund të autorizojë asgjësimin duke djegur ose groposur në vendndodhje, siç përcaktohet në nenin 19, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, me kusht që të merren të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që djegia ose groposja nuk rrezikon shëndetin e kafshëve ose njerëzve dhe mjedisin.

KAPITULLI IV

ASGJËSIMI ME MENYRA TE TJERA

1. Me përjashtim të nenit 14 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, autoriteti kompetent mund të autorizojë mbledhjen, transportin dhe asgjësimin e Materialeve të kategorisë 3 të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 i këtij Udhëzimi Administrativ me mjete të ndryshme nga djegia apo groposja me kusht që:

1.1. materialet nuk tejkalojnë një vëllim prej 20 kg për javë nga ndërmarrja apo fabrika ku materialet grumbullohen, pa marrë parasysh llojin e origjinës së materialeve;

1.2. materialet grumbullohen, transportohen dhe hudhen me menyra që parandalojnë transmetimin e rreziqeve të papranueshme për shëndetin publik dhe të kafshëve;

1.3. autoriteti kompetent kryen kontrolla të rregullta, përfshirë kontrollat e regjistrave të mbajtura nga operatorët, në ndërmarrje apo fabrika ku materialet grumbullohen, për të siguruar përputhjen me dispozitat e Kapitulli.

SHTOJCA V

FORMATI STANDARD PËR APLIKIMIN PËR METODA ALTERNATIVE

KAPITULLI I

Përdorimi i gjuhës

1. Aplikimet për autorizim të metodave alternative të përdorimit ose hudhjes së nën produkteve shtazore ose produkteve të derivuara siç janë përcaktuar në Nenin 20 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 - aplikacionet do të dorëzohen në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

2. Palët e interesuara që dorëzojnë aplikacione të tilla në një gjuhë të ndryshme nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, do të vërtetojnë përkthimin zyrtar të aplikacionit të tyre.

KAPITULLI II

Përmbajtja e aplikimit

1. Aplikimet do të përmbajnë të gjitha informatat në lidhje me pikat si në vijim, në mënyrë që t'i lejoje autoritetin kompetent të vlerësoj sigurinë e metodës së tyre alternative të propozuar:

1.1. kategoritë e nënprodukteve shtazore të cilat synohen që t'i nënshtrohen metodës;

1.2. tërë procesit;

1.3. rreziqet biologjike për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve të përfshira, dhe

1.4. shkalla e reduktimit të rrezikut që duhet të arrihet nga procesi.

2. Kërkesa e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij kapitulli duhet të:

2.1. përfshijë pikat e aplikueshme në nenet 8, 9 dhe 10 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, duke përfshirë statusin fizik të atyre materialeve dhe, nëse është e aplikueshme, çdo para-trajtim të cilit i janë dorëzuar këto materiale dhe që tregon çdo material tjetër përveç nënprodukteve shtazore që do të përdoren në proces;

2.2. përfshijnë një protokoll HACCP dhe një diagram rrjedhës që tregon qartë hapat individualë të procesit, identifikon parametrat kritikë për çaktivizimin e patogjenëve përkatës si temperatura, presioni, koha e ekspozimit, rregullimi i vlerës së pH dhe madhësisë së grimcave dhe plotësohet nga teknika në fletët e të dhënave të pajisjeve të përdorura gjatë procesit;

2.3. identifikojnë dhe karakterizojnë rreziqet biologjike për shëndetin e njerëzve dhe kafshëve të përfaqësuara nga kategoritë e nënprodukteve shtazore që synohen t'i nënshtrohen metodës;

2.4. tregojnë se rreziqet biologjike më rezistente që lidhen me kategorinë e materialeve që do të përpunohen reduktohen në çdo produkt të prodhuar gjatë procesit, duke përfshirë ujërat e zeza, të paktën në masën e arritur nga standardet e përpunimit të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ për të njëjtën kategori të nënprodukteve shtazore. Shkalla e reduktimit të rrezikut duhet të përcaktohet me matje të drejtpërdrejta të vërtetuara, përveç rasteve kur modeli ose krahasimi me procese të tjera janë të pranueshme.

3. Matjet e vërtetuara të drejtpërdrejta të përcaktuar në paragrafin 2, nënparagrafi 2.4 të këtij Kapitulli do të nënkuptojnë:

3.3. matja e reduktimit të qëndrueshmërisë të:

3.3.1. organizmave endogjenë gjatë procesit, ku treguesi është:

3.3.1.1. i pranishëm vazhdimisht në lëndën e parë në numër të lartë;

3.3.1.2. jo më pak rezistent ndaj aspekteve vdekjeprurëse të procesit të trajtimit, por gjithashtu jo dukshëm më rezistent se patogjenët për të cilët përdoret për të monitoruar;

3.3.1.3. relativisht e lehtë për t'u llogaritur, identifikuar dhe konfirmuar; ose

3.3.1.4. duke përdorur një organizëm testues ose virus të karakterizuar mirë të futur në një trup të përshtatshëm testues në materialin fillestar. Nëse përfshihen disa hapa trajtimi, duhet të kryhet një vlerësim mbi shkallën në të cilën hapat individualë të reduktimit të titrit janë shtues, ose nëse hapat e hershëm në proces mund të komprometojnë efikasitetin e hapave të mëpasshëm;

3.3.1.5. raportimi i rezultateve të plota nga duke përshkruar në detaje metodologjinë e përdorur;

3.3.1.6. përshkrimi i natyrës së mostrave të cilat janë analizuar;

3.3.1.7. që tregon se numri i mostrave të analizuar është përfaqësues;

3.3.1.8. arsyetimi i numrit të testeve të kryera dhe përzgjedhja e pikave matëse;

3.3.1.9. që tregon ndjeshmërinë dhe specifikën e metodave të zbulimit të përdorura;

3.3.1.10. sigurimin e të dhënave për përsëritshmërinë dhe ndryshueshmërinë statistikore të matjeve të marra gjatë eksperimenteve;

3.3.1.11. duke justifikuar, nëse përdoret rëndësinë e zëvendësuesve të prionit;

3.3.1.12. duke treguar, kur në mungesë të matjeve të drejtpërdrejta, përdoren modele ose krahasime me procese të tjera, se faktorët që çojnë në uljen e rrezikut janë të mirënjohur dhe modeli i reduktimit të rrezikut është i vendosur mirë.

3.3.1.13. sigurimi i të dhënave për të gjithë procesin mbi matjet e drejtpërdrejta të të gjithë faktorëve që çojnë në reduktimin e rrezikut, të cilët tregojnë se këta faktorë janë aplikuar në mënyrë homogjene në të gjithë grupin e trajtuar.

3.4. Plani HACCP i përcaktuar në paragrafin 2, nënparagrafi 2.2 i këtij Kapitulli duhet të bazohet në parametrat kritikë që përdoren për të zvogëluar rrezikun, në veçanti:

3.4.1. temperatura;

3.4.2. presioni;

3.4.3. koha, dhe

3.4.4. kriteret mikrobiologjike.

4. Kufijtë kritikë të ruajtur në planin HACCP duhet të përcaktohen, bazuar në rezultatet e vërtetimit eksperimental dhe/ose të modelit të ofruar.

5. Nëse funksionimi i suksesshëm i procesit mund të demonstrohet vetëm duke iu referua parametrave teknikë që lidhen posaçërisht me pajisjet e përdorura në proces, plani HACCP duhet të përfshijë gjithashtu kufijtë teknikë që duhet të përmbushen, në veçanti marrjen e energjisë, numrin e pompës, goditjet ose doza e kimikateve.

6. Duhet të jepet informacion mbi parametrat kritikë dhe teknikë që do të monitorohen dhe regjistrohen në mënyrë të vazhdueshme ose pas intervaleve të përcaktuara dhe mbi metodat e përdorura për matje dhe monitorim.

7. Duhet të merret parasysh ndryshueshmëria e parametrave në kushte tipike prodhimi.

8. Plan HACCP duhet të pasqyrojë kushtet normale dhe jonormale/emergjente të funksionimit duke përfshirë një ndarje të procesit dhe duhet të specifikojë veprimet e mundshme korrigjuese që do të zbatohen në rastin e kushteve jonormale/emergjente të funksionimit.

9. Aplikimet duhet të përmbajnë gjithashtu informacion të mjaftueshëm për:

9.1. rreziqet që lidhen me proceset e ndërrarura, dhe veçanërisht në rezultatin e një vlerësimi të ndikimeve të mundshme indirekte, të cilat mund të:

9.1.1. ndikojnë në nivelin e reduktimit të rrezikut të një procesi të caktuar;

9.1.2. paraqiten nga transporti ose ruajtja e çdo produkti të krijuar gjatë procesit dhe nga asgjësimi i sigurt i produkteve të tilla, duke përfshirë ujërat e zeza.

9.2. rreziqet që lidhen me përdorimin përfundimtar të synuar të produkteve, në veçanti:

9.2.1. duhet të specifikohet përdorimi përfundimtar i synuar i çdo produkti të krijuar gjatë procesit;

9.2.2. rreziqet e mundshme për shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve dhe ndikimet e mundshme në mjedis duhet të vlerësohen në bazë të reduktimit të rrezikut të vlerësuar në përputhje me paragrafin 2, nënparagrafi 2.4 të këtij Kapitulli.

10. Kërkesat duhet të dorëzohen me prova të dokumentuara në veçanti:

10.1. një diagram rrjedhës që tregon funksionimin e procesit;

10.2. provat e përcaktuara në paragrafin 2, nënparagrafi 2.4 i këtij Kapitulli, si dhe prova të tjera që synojnë të vërtetojnë informacionin e dhënë në kuadër të aplikacionit siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij kreu.

11. Aplikimet duhet të përfshijnë një adresë kontakti për palën e interesuar, e cila duhet të përfshijë emrin dhe adresën e plotë, numrin e telefonit dhe/ose faksit dhe/ose adresën e postës elektronike të një personi të caktuar që është përgjegjës si ose në emër të palës së interesuar.

SHTOJCA VI

GRUMBULLIMI, TRANSPORTI DHE GJURMUESHMERIA

KAPITULLI I

GRUMBULLIMI DHE TRANSPORTI DHE GJËRMUESHËRIA

Nënkapitulli 1

Automjetet dhe kontejnerët

1. Që nga pika fillestare në zinxhirin e prodhimit të përcaktuar në nenin 4, paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, nënproduktet e kafshëve dhe produktet e përfituara të mblidhen dhe transportohen në ambalazhe të reja të mbyllura ose në kontejnerë ose automjete të mbuluara që nuk rrjedhin.

2. Automjetet dhe kontejnerët e ripërdorshëm, dhe të gjitha njësitë e ripërdorshme të pajisjeve ose mjeteve që vijnë në kontakt me nënproduktet shtazore ose produktet e derivuara, tjera përveç produkteve të derivuara që janë plasuar në treg në pajtim me legjislacioni specifik për vendosjen në treg dhe përdorimin e ushqimit për kafshë dhe që janë magazinuar dhe transportuar në pajtim me legjislacioni specifik për higjienën e ushqimit duhet të mirëmbahen në gjendje të pastër.

3. Në veçanti, përveç nëse janë dedikuar për bartje të nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara të caktuara në një mënyrë që shmang kryqkontaminimin, ato duhet të jenë:

3.1. të pastra dhe të thara para përdorimit; dhe

3.2. pastrohen, lahen dhe dezinfektohen pas çdo përdorimi në atë masë të nevojshme për të shmangur kryqkontaminimin.

4. Kontejnerët e ripërdorshëm duhet të dedikohen për bartje të nënprodukteve shtazore ose produkteve të derivuara të caktuara në masën e nevojshme për të shmangur kryqkontaminimin.

5. Kontejnerët e ripërdorshëm mund të përdoren, nëqoftëse autoriteti kompetent ka autorizuar përdorimin e tillë:

5.1. për bartjen e nënprodukteve të ndryshme shtazore ose produkteve të derivuara nëqoftëse ato janë pastruar dhe dezinfektuar midis përdorimeve të ndryshme në atë mënyrë që parandalon kryqkonatimin;

5.2. për transportin e nënprodukteve shtazore ose produkteve të përfituara të përcaktuar në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) – Nr. 05/2022 i cili përcakton rregullat shendetësore për nën produkte shtazore dhe produkteve të përfituara prej tyre të cilat nuk janë për konsum njerëzor pas përdorimit të tyre nuk mund të përdoren për

transportin e produkteve të destinuara për konsum njerëzor, për të parandaluar kontaminimin e tërthort/ indirekt.

6. Materiali për paketim duhet të trajtohet, me incinerim ose me mënyra tjera në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Nënkapitulli 2

Kushtet e temperatures

1. Transporti i nën produkteve shtazore të destinuara për prodhimin e materialit të ushqimit të kafshëve ose ushqimit të papërpunuar për kafshë shoqëruese duhet të bëhet në temeperaturë të duhur, në rast të në produkteve shtazore nga mishi dhe produktet e mishit që kanë qenë të destinuara për qëllime përveç konsumimit nga njeriu, në maksimum prej 7°C, në mënyrë që të shmanget ndonjë rrezik për shëndetin e kafshëve ose atë publik.

2. Materiali i papërpunuar i Kategorisë 3 i destinuar për prodhimin e materialit të ushqimit ose për ushqim të kafshëve shoqëruese duhet të magazinohet dhe transportohet i ftohtë, i ngrirë ose i sillazhuar, përveç nëse:

2.1. ai procesohet brenda 24 orëve pas grumbullimit ose pas përfundimit të magazinimit në formë të ftohtë apo ngrirë, nëse transporti i mëtutjeshëm bëhet në mjete të transportit në të cilat mbahet temperatura e ruajtjes;

2.2. në rast të qumështit, produkteve me bazë të qumështit ose produkteve të përfituara nga qumështi të cilat nuk i janë nënshtruar ndonjë trajtimi të përcaktuar në Pjesën I të Nenit 4 të Kapitullit II të Shtojcës VIII të këtij Udhëzimi Administrativ transportohet i ftohur dhe në kontejnerë të izoluar, përveç nëse rreziqet mund të zbuten me masa tjera, për shkak të karakteristikave të materialit.

3. Dizajni i automjeteve të përdorura për transport me frigorifer duhet të sigurojë ruatjen e temperaturës së duhur gjatë gjithë transportit, dhe të lejojë që temperatura të monitorohet.

Nënkapitulli 3

Derogimi për grumbullimin dhe transportin e materialit të Kategorisë 3 që përbëhet nga qumështi, produktet me bazë të qumështit dhe produktet e derivuara nga qumështi

Nënkapitulli 1 i këtij Kapitulli nuk do të zbatohet për grumbullimin dhe transportin e materialit të Kategorisë 3 që përbëhet nga qumështi, produktet me bazë qumështi dhe produktet me prejardhje nga qumështi nga operatorët e ndërmarrjeve të përpunimit të qumështit të aprovuara sipas legjislacionit në fuqi për rregullat specifike për higjienën e ushqimit me origjinë shtazore, ku ata marrin produkte të cilat i kanë dorëzuar më parë dhe që u kthehen atyre, veçanërisht nga klientët e tyre.

Nënkapitulli 4

Derogimi për grumbullimin dhe transportin e plehut

Duke përjashtuar nënkapitullin 1 të këtij Kapitulli autoriteti kompetent mund të pranojë grumbullimin dhe transportin e plehut organik të transportuar ndërmjet dy pikave të vendosura në të njëjtën fermë ose ndërmjet fermerëve dhe përdoruesve në kushte të tjera që parashikojnë parandalimin e rreziqeve të papranueshme për publikun dhe shëndetin e kafshëve.

KAPITULLI II IDENTIFIKIMI

1. Të gjitha masat e nevojshme duhet të merren për të siguruar se:

1.1. ngarkesat e nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara janë të identifikueshme dhe mbahen të ndara dhe të identifikueshme gjatë grumbullimit ku nënproduktet shtazore burojnë edhe gjatë transportimit;

1.2. një substancë shënjuese për identifikimin e nënprodukteve shtazore ose produkteve të derivuara të një kategorie specifike përdoret vetëm për atë kategori për të cilën përdorimi i saj kërkohet me këtë Udhëzim Administrativ, ose është përcaktuar sipas paragrafit 4 të Kapitullit II të kësaj Shtojce;

1.3. ngarkesat e nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara dërgohen nga Republika e Kosovës në një vend tjetër në paketime, kontejnerë ose automjete të cilat janë të dukshëm dhe, të paktën gjatë periudhës së transportit, të koduar me ngjyrë që nuk shlyhet për shfaqjen e informatave, siç është përcaktuar në këtë Udhëzim Administrativ, në sipërfaqe ose pjesë të sipërfaqes së paketimit, kontejnerit ose automjetit, ose në një etiketë ose simbol të aplikuar në to si në vijim:

1.3.1. në rast të materialeve të Kategorisë 1, duke përdorur ngjyrën e zezë;

1.3.2. në rastin e materialeve të Kategorisë 2 (përveç plehut dhe përmbajtjes së traktit të tretjes), duke përdorur ngjyrën e verdhë;

1.3.3. në rast të materialeve të Kategorisë 3, duke përdorur ngjyrën e gjelbër për të siguruar se ajo është qartazi e dallueshme nga ngjyrat e tjera;

1.3.4. në rast të ngarkesave të importuara, ngjyra e përcaktuar për materialin respektiv nën nënparagrafet 1.3.1, 1.3.2 dhe 1.3.3 të këtij paragrafi, që prej kohës kur ngarkesa ka kaluar pikën kufitare të inspektimit të hyrjes së parë në territorin e Republikës së Kosovës.

2. Gjatë transportit dhe magazinimit, një etiketë e ngjitur në paketim, kontejner ose automjet duhet:

2.1.1. të tregojë qartë kategorinë e nënprodukteve shtazore ose produkteve të derivuara; dhe

2.1.2. të shënohet me fjalët të dukshme dhe të lexueshme të shfaqura në paketim, kontejner ose automjet, si në vijim:

2.1.2.1. në rast të materialit të Kategorisë 3, **‘jo për konsum nga njeriu’**;

2.1.2.2. në rast të materialit të Kategorisë 2 (përveç plehut dhe përmbajtjes së traktit të tretjes) dhe produkteve të derivuara nga materiali i Kategorisë 2, **‘jo për konsum nga kafshët’**, kur materiali i Kategorisë 2 për ushqyerjen e kafshëve të percaktuara në Nenin 18 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) -05/2022, nën kushtet e siguruara ose parashtruara në pajtim me atë Nen, etiketa do të tregojë më mirë **‘për ushqyerjen e...’** të kompletuar me emrin e llojit specifik të atyre kafshëve për ushqyerjen e të cilave materiali synohet;

2.1.3. në rast të materialit të Kategorisë 1 dhe produkteve të derivuara nga materiali i Kategorisë 1 ku ato janë destinuar për:

2.1.3.1. asgjësim, **‘vetëm për hudhje’**;

2.1.3.2. prodhimin e ushqimit për kafshë shoqëruese, **‘vetëm për prodhimin e ushqimit për kafshë shoqëruese’**;

2.1.3.3. prodhimin e produkteve të derivuara të percaktuara në nenin 36 të ‘Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) 05/2022, vetëm **‘për prodhimin e produkteve të derivuara. Jo për konsum nga njeriu apo kafshët apo për aplikim në tokë’**;

2.1.3.4. në rast të qumështit, produkteve me bazë të qumështit, produkteve të derivuara nga qumështi, kulloshtira dhe produktet e kulloshtirës, **‘jo për konsum njerëzor’**;

2.1.3.5. në rast të xhelatinës së prodhuar nga materiali i Kategorisë 3, **‘xhelatinë e përshtatshme për konsum nga kafshët’**;

2.1.3.6. në rast të kolagjenit të prodhuar nga materiali i Kategorisë 3, **‘kolagjen i përshtatshëm për konsum nga kafshët’**;

2.1.3.7. në rast të ushqimit të papërpunuar për kafshë shoqëruese, **‘vetëm si ushqim për kafshë shoqëruese’**;

2.1.3.8. në rast të peshkut dhe produkteve të derivuara nga peshku të synuara për ushqim të peshkut, dhe të trajtuar dhe paketuar para distribuimit, emri dhe adresa e origjinës së ndërmarrjes së prodhimit të ushqimit, të shënohet qartë dhe lexueshëm, dhe

2.1.3.9. në rast të ushqimit për peshk nga peshqit e egër, duke pasur të shënuara fjalët **‘përmban ushqim peshku vetëm nga peshku i egër – mund të përdoret për ushqyerjen e peshqëve të fermave të të gjitha llojeve’**;

2.1.3.10. në rast të ushqimit të peshkut nga peshqit e kultivuar, pasur të shënuara fjalët **‘përmban ushqim peshku vetëm nga peshku i kultivuar i llojit [...] - mund të përdoret vetëm për ushqyerjen peshqëve të kultivuar të llojeve tjera të peshkut’**;

2.1.3.11. në rast të ushqimit të peshkut nga peshku i egër dhe nga peshku i kultivuar, duke pasur të shënuara fjalët **‘përmban ushqim peshku nga peshku i egër dhe peshku i kultivuar i llojeve [...] - mund të përdoret vetëm për ushqyerje të peshkut të kultivuar të llojeve tjera të peshkut’**;

2.1.3.12. në rast të produkteve të gjakut nga ekuida-njëthundrakët për qëllime tjera prej atij në ushqim, **‘gjaku dhe produktet e gjakut nga ekuida-njëthundrakët. Jo për konsum nga njeriu apo kafshët’**;

2.1.3.13. në rast të brirëve, thundrave dhe materialeve tjera për prodhimin e fertilizuesve organik dhe pasuruesve të tokës të percaktuar në Shtojcën XIII kapitulli II nënkapitulli 12 i këtij Udhëzimit Administrativ ‘jo për konsum nga njeriu apo kafshët’;

2.1.3.14. në rast të fertilizuesve organik dhe pasuruesve të tokës, **‘fertilizuesit organik ose pasuruesit e tokës/jo kullotje e kafshëve të fermave apo përdorim barishteve të prera gjatë së paku 21 ditëve pas aplikimit’**;

2.1.3.15. në rast të materialit të përdorur për ushqyerje në pajtim me Shtojcën V Kapitulli II nënkapitulli 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) -05/2022, emri dhe adresa e qendrës së grumbullimit, dhe shenja **‘jo për konsum nga njeriu’**;

2.1.3.16. në rast të plehut dhe përmbajtjes së traktit të tretjes, **‘pleh’**;

2.1.3.17. në rast të produkteve të ndërmjetme, në paketim të jashtëm, duke pasur të shënuara fjalët **‘vetëm për produkte medicinale/produkte medicinale veterinare/pajisje medicinale/ pajisje medicinale aktive të implantueshme/ pajisje medicinale për diagnostikim *in vitro*/ reagjent laboratorik’**;

2.1.3.18. në rast të mostrave për hulumtim dhe diagnostikim, fjalët **‘për qëllim të hulumtimit dhe diagnostikimit’**, në vend të tekstit të etiketës së percaktuar në nënparagrafin 2.1 të paragrafit 2 të këtij kapitulli;

2.1.3.19. në rast të mostrave të tregtimit, fjalët **‘mostrat e tregtimit jo për konsum nga njeriu’**, në vend të tekstit të etiketës së percaktuar në nënparagrafin 2.1 të paragrafit 2 të këtij kapitulli;

2.1.3.20. në rast të njësive të ekspozimit, fjalët **‘njësi e ekspozimit jo për konsum nga njeriu’**, në vend të tekstit të etiketës së percaktuar në nënparagrafin 2.1 të paragrafit 2 të këtij kapitulli.

2.2.18 në rastin e vajit të peshkut për prodhimin e produkteve medicinale të përmendura në kreun XIII të shtojcës XI të këtij Udhëzimi Administrativ, fjalët “VAJ PESHKU PËR PRODHIM TË PRODUKTEVE MJEKËSORE”, në vend të tekstit të etiketës të përcaktuar në nënparagrafin 2.1 të këtij paragrafi

2.2.19 në rastin e plehut i cili i është nënshtruar trajtimit me gëlqere të përcaktuar në pikën I të seksionit 2 të kreut IV të aneksit II të këtij udhëzimi administrativ, fjalët ‘Përzierje PLEH-GELQERE-’;

2.2.20 në rastin e plehut të përpunuar i cili i është nënshtruar trajtimit të përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.2 dhe 1.3 të seksionit 2 të kreut I të aneksit IX të këtij Udhëzimi Administrativ, fjalët “PLEH I PËRPUNUAR”

2.2.21 në rastin e materialeve për detoksifikim të përmendura në kreun VII të shtojcës VI të këtij Udhëzimi Administrativ, fjalët: “MATERIALE TË DETYRAVE PËR DETOXIFIKIM. JO I PËRSHTATSHËM PËR PLASIM NË TREG”;

2.1.4. Etiketa e përcaktuar në nën paragrafin 2.2.11 nënparagrafin 2.2 të paragrafit 2 të këtij kapitulli nuk do të kërkohet për fertilizuesit organik dhe pasuruesit e tokës në vijim:

1.4.4.1. në paketimet e gatshme-për-shitje jo më të mëdha se 50 kg në peshë për përdorim nga konsumatori final; ose

1.4.4.2. në qese të mëdha jo më të rënda se 1000 kg në peshë, nëqoftëse:

1.4.4.2.1. ato janë autorizuar nga Autoriteti Kompetent për aplikim në tokë në Republikën e Kosovës;

1.4.4.2.2. shënohet në qese se ato nuk janë të destinuara për aplikim në tokë në të cilën kafshët e fermave kanë qasje.

1.4.4.2.3. Megjithatë:

1.4.4.2.4. paragrafët 1 dhe 2 të Kapitullit II të kësaj shtojce nuk do të aplikohen për identifikimin e materialit të Kategorisë 3 që përbëhet nga qumështi, produktet me bazë të qumështit dhe produktet e derivuara nga qumështi, nga ndërmarrjet e procesimit të qumështit të cilat janë aprovuar në pajtim me legjislacionin në fuqi të cilat pranojnë produkte që paraprakisht i kanë dërguar në treg dhe të cilat u janë kthyer atyre, posaqërisht nga konsumatorët e tyre;

1.4.4.2.5. autoriteti kompetent mund të pranojë identifikimin e plehut i cili transportohet midis dy pikave të vendosura në të njejtën fermë ose ndërmjet fermave dhe përdoruesve, në mënyra tjera, me anë të derogimit nga paragrafi 1 dhe 2 i kapitulli II të kësaj shtojce.

1.4.3. ushqimet e kombinuara të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ushqimin për kafshë nga nënproduktet shtazore ose nga produktet e derivuara dhe të cilat janë paketuar dhe plasuar në treg si ushqim për kafshë në pajtim me legjislacionin në fuqi për ushqimin për kafshë nuk është e nevojshme që pajtjetër të identifikohen në pajtim me paragrafin 1 të kapitullit II të kësaj Shtojce.

KAPITULLI III

DOKUMENTET KOMERCIALE DHE CERTIFIKATAT SHËNDETËSORE

1. Gjatë transportit, një dokument komercial në pajtim me modelin e përcaktuar në këtë Kapitull, ose, kur kërkohet me këtë Udhezim Administrativ, certifikata shëndetësore duhet të shoqërojë nënproduktet shtazore dhe produktet e derivuara.

2. Dokumentet ose certifikatat e tilla nuk do të jenë të nevojshme, në qoftëse:

2.1. tregtarët me pakice furnizojnë përdoruesit final përveç operatorët e biznesit me produkte të derivuara nga materiali i Kategorisë 3 dhe fertilizuesit organik dhe pasuruesit e tokës brenda territorit të Republikës së Kosovës;

2.2. qumështi, produktet me bazë qumështi dhe produktet e derivuara nga qumështi të cilat janë materiale të Kategorisë 3 janë grumbulluar dhe kthyer tek operatorët e ndërmarrjeve të procesimit të qumështit, të cilat janë aprovuar në pajtim me legjislacionin në fuqi nëse ata operatorë pranojnë produkte, në veçanti nga konsumatorët e tyre, të cilët më parë i kanë furnizuar;

2.3. ushqimet e kombinuara të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për ushqimin për kafshë, të prodhuara nga nënproduktet shtazore ose nga produktet e derivuara, plasohen në treg të paketuara dhe etiketuara në pajtim me legjislacionin në fuqi për ushqimin për kafshë.

2.4. Dokumenti komercial duhet të prodhohet në tri kopje (një origjinal dhe dy kopje).

2.5. Origjinali duhet të shoqërojë dergesën deri në destinacionin final.

2.6. Pranuesi duhet ta ruaj origjinalin;

2.7. Prodhuesi duhet të mbajë një të njëjtë kopje dhe transportuesi tjetër;

2.8. Autoriteti Kompetent mund të kërkojë dëshminë e arritjes së dergesës i cili sigurohet nga sistemi TRACES ose me një kopje të katërt të dokumentit komercial i cili dërgohet prapa nga pranuesi të prodhuesit.

2.9. Certifikatat shëndetësore duhet të lëshohen dhe nënshkruhen nga Autoriteti Kompetent.

2.10. Dokumenti komercial në pajtim me formën e përcaktuar në paragrafin 8 të këtij kapitulli do të shoqërojë nënproduktet shtazore dhe produktet e derivuara që nga pika e fillimit në

zinxhirin e prodhimit të percaktuar në Nenin 4 paragrafin 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) -05/2022 gjatë transportimit.

2.11. Përveç autorizimit të komunikimit të informates me anë të një sistemi alternativ sic është percaktuar nënparagrafin e 2 të Nenit 21 paragraf 3 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) – Nr.05/2022 autoriteti kompetent mund të autorizojë që nënproduktet shtazore dhe produktet e derivuara që janë transportuar në teritorin e saj të shoqërohen me:

2.11.1. dokument tjetër komercial, në letër ose formë elektronike, nëqoftëse një dokument i tillë komercial përmban informatat e percaktuara në paragrafin 6 nënparagrafi 6.6 të Kapitullit III të kësaj shtojce;

2.11.2. dokument komercial në të cilin sasia e materialit është e shprehur në peshë ose vëllim të materialit apo në numër të paketimeve.

2.11.3. Regjistrat dhe dokumentet komerciale relevante dhe certifikatat shëndetësore do të mbahen për një periudhë se paku (2) dy vite për prezentim tek autoriteti kompetent.

2.12. Forma e dokumentit komercial do të përmbajë:

2.12.1. dokumentet komerciale do të përmbajnë të dhënat sipas formatit të percaktuar në këtë Kapitull, duke përfshirë dëshmitë që kërkohen për transportin e nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara;

2.12.2. ato duhet të hartohen në të gjitha gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës dhe sipas nevojës, në gjuhën zyrtare të shtetit të destinimit. Gjithashtu mund të shoqërohet nga dokument komercial të përkthyer zyrtarisht dhe që paraprakisht sipas dakordimit me autoritetin kompetent të destinimit;

2.12.3. origjinali i secilit dokument komercial do të përbëhet nga një fletë e vetme, në të dy anët, ose, ku kërkohet më shumë tekst do të jetë në atë formë që të gjitha fletët që nevoiten do të jenë detyrimisht pjesë e tërësisë së pandashme;

2.12.4. nëse për arsye të identifikimit të njësive të dergesës, bashkangjiten fletë shtesë në dokumentin komercial, këto fletë gjithashtu do të konsiderohen se formojnë pjesë të dokumentit origjinal duke aplikuar nënshkrimin e personit përgjegjës për dergesën, në secilën faqe;

2.12.5. kur dokumenti komercial, duke përfshirë fletet shtesë të percaktuara në nënparagrafin 8.4 të këtij nënparagrafi, përbëhet prej më shumë se një faqe, secila faqe do të numrohet –(numri i faqes) së (numri total i faqeve) – në fund të faqes dhe do të mbajë numrin e kodit të dokumentit i cili është caktuar nga personi përgjegjës i shënuar në krye të faqes;

2.12.6. origjinali i dokumentit komercial duhet të kompletohet dhe nënshkruhet nga personi përgjegjës;

2.12.7. dokumenti komercial duhet të kete te specifikuar:

2.12.8. datën në të cilën materiali është marrë nga hapësirat;

2.12.9. përshkrimin e materialit;

2.12.10. përfshirë identifikimin e materialit sipas njërës prej kategorive të percaktuara në Nenet 8, 9 dhe 10 Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) -Nr.05/2022;

2.12.11. llojin e kafshëve dhe referencën specifike në pikën e aplikueshme në Nenin 10 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR)-Nr.05/2022 për materialin e Kategorisë 3 dhe produktet e derivuara nga ai material që janë të destinuara për ushqyerjen e kafsheve dhe,

2.12.12. nëse është e aplikueshme, numri i matrikulit të kafshës;

2.12.13. sasia e materialit, në vëllim, peshë ose numër të paketimeve;

2.12.14. emrin dhe adresën e fabrikës apo ndermarjes vendin e origjinës së materialit, prej nga materiali është dërguar dhe numrin e aprovimit ose regjistrimit; aty ku është e mundur sipas Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) 05/2022, si të jetë e aplikueshme, dhe natyra dhe metodat e trajtimit;

2.12.15. emrin dhe adresën dhe numrin e regjistrimit të transportit të materialit;

2.12.16. në rastin e transportit në kontejnerë, numrin e plotë të identifikimit të kontejnerit ("kodi BIC") i lëshuar në përputhje me kërkesat e Bureau International des Containers et du Transport Intermodal;

2.12.17. në rast të eksportit të proteinave shtazore të përpunuara dhe produkteve që përmbajnë proteina shtazore të përpunuara siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për kontroll dhe eradikim të sëmundjes së TSE-së, duhet të përmbajë pikën e daljes nga Republika e Kosovës.

2.12.18. Ngjyra e nënshkrimit të personit përgjegjës do të jetë e ndryshme prej asaj të printimit.

2.13. Numri i referencës së dokumentit dhe numri lokal i referencës do të lëshohet vetëm një herë për të njëjtën dergese.

Dokumenti Komercial

Për transport të nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara që nuk synohen për konsum nga njeriu në pajtim me këtë Udhëzim Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022 në territorin e Republikës së Kosovës dhe vendeve të tjera.

Dokument Komercial

Për transportin brenda Republikës së Kosovës të nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara që nuk janë të destinuara për konsum nga njeriu në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) - Nr. 00/2020 që përcakton rregullat shëndetësore për nënproduktet shtazore dhe produktet e derivuara që nuk janë të destinuara për konsum nga njeriu

REPUBLIKA E KOSOVËS

Dokument Komercial

Pjesa I: Detajet e dërgesës së dërguar	I.1. Dërguesi				II.2. Referenca e dokumentit Nr.		II.2. Referenca lokale Nr.	
	Emri				I.3. Autoriteti Kompetent Qendror			
	Adresa							
	Numri i miratimit ose i regjistrimit							
	Kodi Postar							
	I.5. Marrësi				I.6. Tregtuesi i regjistruar			
	Emri				Emri			
	Adresa				Numri i regjistrimit			
	Kodi postar				Adresa			
	Numri i miratimit ose i regjistrimit				Kodi postar			
Tel.				Vendi				
I.7.								
I.8. Vendi i origjinës		Kodi ISO	I.8. Rajoni i origjinës		Kodi	I.10. Vendi i destinacionit		Kodi ISO
						I.11. Rajoni i destinacionit		Kodi
I.11. Vendi i origjinës				I.13. Vendi i destinacionit				
Objekti ☐				Objekti ☐				
Emri.				Emri.				
Numri i miratimit ose i regjistrimit				Numri i miratimit ose i regjistrimit				
Adresa				Adresa				
Kodi Postar				Kodi Postar				
I.13. Vendi i ngarkimit				I.15. Data e nisjes				
I.16. Mjetet e transportit				I.17. Transportuesi				
Aeroplan ☐ Anije ☐ Vagon hekurudhor ☐				Emri				
Automjet rrugor ☐ Tjetër ☐				Numri i miratimit ose i regjistrimit				
Identifikimi:				Adresa				
				Vendi i kodit postar				
I.18. Përshkrimi i mallit						I.19. Kodi i mallit (kodi CN)		
I.21. Temperatura e produktit						I.20. Sasia totale		
Ambienti ☐ i ftohtë ☐ i ngrohtë ☐ Temperatura e kontrolluar ☐						I.22. Numri i pakove		
I.23. Numri i vules nese eshte nje vule e vendosur nga autoriteti kompetent dhe numri ID i BIC i kontejnerit						I.24. Lloji i paketimit		

I.25. Mallrat e certifikuara për: Ushqim për kafshët ☐ Përdorimi i ushqimit për kafshët shtëpiake ☐ Plehurat organike/përmirësuesit e tokës ☐ Përdorimi teknik ☐ Dergesa i nënshtrohet kërkesave të përcaktuara në Rregulloren (EC) Nr. 999/2001 ☐ Kategoria 3 vaj peshku/ushqim peshku me nivel(e) të tepërta të dioksinës dhe/ose PCB-ve të destinuara për detoksifikim sipas Rregullores (BE) 2015/786. ☐					
I.26.			I.27. Për tranzit nëpër Republikën e Kosovës ☐		
I.28. Eksport ☐ Shtet tjetër Kodi ISO Pika e daljes. Kodi			I.29.		
I.30.					
I.31. Identifikimi i mallrave					
Numri i miratimit të objekteve					
Speciet	Natyrë e mallit	Kategoria	Lloji i trajtimit	Fabrika e prodhimit	Numri i grupit

II. Informacion shëndetësor	II.a. Numri i referencës së certifikatës	II.b.
II.1. Deklaratë nga dërguesi Unë, veterineri zyrtar i nënshkruar, deklaroj atë Deklaratë nga dërguesi , i nënshkruarit, deklarojnë se: Natyra e mallit: Futni një mall të zgjedhur nga lista e mëposhtme: "nënproduktet e bletarisë", "produktet e gjakut", "gjak", Informacion shëndetësor II.a. Referenca e certifikatës Nr. II.b. II.1.1. informacioni në Pjesën I është faktikisht i saktë; II.1.2. janë marrë të gjitha masat paraprake për të shmangur kontaminimin e nënprodukteve shtazore ose produkteve të derivuara me agjentë patogjenë dhe ndotje të kryqëzuar ndërmjet kategorive të ndryshme. Shënime Pjesa I: - Referenca e kutisë I.1: Personi juridik ose fizik që urdhëron transportin e treguar në dokumentin e kërkuar nga Konventa relative au Contract de Transport International de Marchandises par Route (CMR). - Referenca e kutisë I.5: Personi juridik ose fizik për të cilin është destinuar ngarkesa. - Referenca e kutisë I.6 [opsionale, nëse është e përshtatshme]: Emri i tregtarit të regjistruar, adresa, numri i regjistrimit. - Referenca e kutisë I.9 dhe I.11: nëse është e përshtatshme. - Referenca e kutisë I.12, I.13: numri i miratimit ose numri i regjistrimit. Në rast se: - produktet që i nënshtrohen nenit 48(3) të Rregullores (KE) Nr. 1069/2009 vetëm një fabrikë magazinimi, djegieje ose bashkëdjegieje - vaji i peshkut ose ushqimi i peshkut i Kategorisë 3 të destinuar për detoksifikim sipas Rregullores (BE) 2015/786 tregojnë numrin e miratimit të bimës së destinacionit sipas Rregullores (EC) Nr. 183/2005 ose Rregullores (BE) 2015/786. - Referenca e kutisë I.14: plotësoni nëse është ndryshe nga I.1. dhe I.12. - Referenca e kutisë I.17: numri i regjistrimit ose miratimit të transportuesit aktual. Nëse ky është i njëjti informacion si në Kutinë I.6, përdorni vetëm kutinë I.17. - Referenca e kutisë I.23: në rastin e transportit në kontenier, numri i plotë i identifikimit të kontejnerit ("kodi BIC") është i detyrueshëm. - Referenca e kutisë I.25: përdorim teknik: çdo përdorim tjetër përveç konsumit të kafshëve ose plehrave organike ose përmirësuesve të tokës OF/SI. Produktet teknike nuk mund të përdoren në ushqim, ushqim për kafshët shtëpiake ose OF/SI. - Referenca e kutisë I.31: Llojet e kafshëve: Për materialet e Kategorisë 3 dhe produktet e derivuara prej tyre të destinuar për përdorim si material ushqimor. Zgjidhni nga të mëposhtmet: Aves, Ruminants, Suidae, Mammalia të tjerë, Pesca, Mollusca, Crustacea, Insecta (specie, nëse është e përshtatshme), Jovertebrorë të tjerë, Lloje të përziera jo-ripërtypëse, Lloje të përziera që përmbajnë ripërtypës. Natyra e mallit: Futni një mall të zgjedhur nga lista e mëposhtme: "nënproduktet e bletarisë", "produktet e gjakut", "gjak", "mielli i gjakut", "mbetjet e tretjes", "përmbajtja e traktit tretës", "përtpjetet e qenve", "mielli i peshkut", "të brendshmet aromatizuese", "xhelatinë", "karshi", "gëzofët dhe lëkurat", "proteinat e hidrolizuara", "plehrat organike/përmirësuesit e tokës", "ushqimi për kafshët shtëpiake", "proteina shtazore e përpunuar", "proteina shtazore nga - produkte për prodhimin e ushqimit për kafshët shtëpiake", "ushqimi i papërpunuar për kafshët shtëpiake", "yndymat e përpunuara", "plehrash", "plehu i përpunuar", "vaji i peshkut", "produktet e qumështit", "produktet e kolostrumit", "centrifuga ose llumi ndarës nga përpunimi i qumështit", "dikalciumfosfati", "trikalciumfosfati", "kolagjeni", "produktet e vezëve", "serumi i kuajve", "trofetë e lojës", "lesh", "flokët", "pushkat e derrit", "pendët", "nënprodukte shtazore për përpunim", "produkte me prejardhje", "miell mishi dhe kockash", "kufoma", "plehu organik", "derivatet e yndyrës", "glicerina", "ish-lëndët ushqimore", "mbeturinat e ushqimit", "vaji i përdorur për gatim", "gëzofët dhe lëkurat e trajtuara", "mjetet e rritjes", "kafshët shtëpiake të ngordhura", "kafshët e ngordhura", "lëndët e mëparshme të ushqimit për kafshë", "[natyra e ABP ose DP] e përzier me mbetje jo të rrezikshme [kodi EURL]", "vezë", "përbërja e prodhimit", "embrione në vezë ose jo". Kategoria: Specifikoni materialet e kategorive 1, 2 ose 3. Në rastin e materialit të kategorisë 3 të destinuar për përdorim si ushqim për kafshë, tregoni pikën e nenit 10 të Rregullores (KE) Nr 1069/2009 që i referohet nënproduktit të kafshëve në fjalë (p.sh. neni 10(a), neni 10(b) etj.) Në rastin e materialit të kategorisë 3 për përdorim në ushqimin e papërpunuar për kafshë, tregoni "3a", "3b(i)" ose "3b(ii)" në varësi të faktit nëse nënproduktet shtazore referohen në nenin 10(a) ose në nenin 10(6)(i) ose (ii) të Rregullores (EC) Nr. 1069/2009. Në rastin e lëkurave dhe produkteve që rrjedhin prej tyre, tregoni "3b(iii)" ose "3(n)" në varësi të faktit nëse nënproduktet shtazore ose produktet e prejardhura përmenden në nenin 10(b)(iii) ose në Nen		

Kategoria:

Specifikoni materialet e kategorive 1, 2 ose 3.

Në rastin e materialit të kategorisë 3 të destinuar për përdorim si ushqim për kafshë, tregoni piken e nenit 10 të Rregullores (KE) Nr 1069/2009 që i referohet nënproduktit të kafshëve në fjalë (p.sh. neni 10(a), neni 10(b) etj.).

Në rastin e materialit të kategorisë 3 për përdorim në ushqimin e përpunuar për kafshë, tregoni "3a", "3b(i)" ose "3b(ii)" në varësi të faktit nëse nënproduktet shtazore referohen në nenin 10(a) ose në nenin 10(6)(i) ose (ii) të Rregullores (EC) Nr. 1069/2009.

Në rastin e lëkurave dhe produkteve që rrjedhin prej tyre, tregoni "3b(iii)" ose "3(n)" në varësi të faktit nëse nënproduktet shtazore ose produktet e derivuara referohen në nenin 10(b)(iii) ose në nenin 10(n) të Rregullores (KE) Nr. 1069/2009.

Lloji i trajtimit: Për gëzofet dhe lëkurat e trajtuara tregoni trajtimin:

(a) për të thara:

"(b)" për të thara me kripe ose të lagura me kripe për të paktën 14 ditë përpara dërgimit;

"(c)" për karbonat natriumi.

Për materialet e kategorisë 1 dhe 2, përshkruani metodën e përpunimit ose të transformimit. Tregoni metoda përkatëse të përpunimit (zgjidhni një metodë nga 1 deri në 5 të referuara në kapitullin III ose një metodë alternative referuar Kapitullit IV të Shtojcës IV të Rregullores (BE) Nr 142/2011) ose menyrë e përpunimit për pleh organik i përpunuar i referuar në Shtojcën XI të tij dhe tregon datën e shënimit GTH si të zbatueshme.

Për materialet e kategorisë 3 të destinuara për përdorim në ushqim, referojuni seksionit përkatës të Shtojcës X të Rregullores (BE) Nr. 142/2011.

Për produktet e derivuara nga materiali i kategorisë 3 të destinuara për përdorim në ushqim për kafshë, tregoni metodën përkatëse standarde të përpunimit (zgjidhni një metodë nga 1 deri në 7 të referuar në Kapitullin III të Shtojcës IV të Rregullores (BE) Nr. 142/2011 në rastin e proteinave shtazore të përpunuara (PAP)), një metodë alternative referuar Kapitullit IV të Shtojcës IV në rast të ensilimit, ose përshkruani natyrën dhe metodat e trajtimit të përcaktuara në Kapitullin II të Shtojcës X të Rregullores (BE) Nr. 142/2011.

Vaji i peshkut ose ushqimi i peshkut për detoksifikimin duhet të etiketohet si "vaj peshku ose ushqim peshku me nivel(e) të tepërta të dioksinave dhe/ose PCB-ve në përputhje me Shtojcën I të Direktivës 2002/32/KE të destinuara për detoksifikimin në një ndërmarrje të miratuar".

Numri i grupit: Futni numrin e serisë ose numrin e etiketës së veshit, nëse është e aplikueshme.

Fabrika e prodhimit: në rastin e PAP-it dhe materialeve të tjera për ushqim, tregoni fabrikën e përpunimit

Pjesa II:

Nenshkrimi duhet të jetë me ngjyrë të ndryshme nga ajo e printimit.

Nenshkrimi

Bërë me
(vendi) (data)

.....
(nenshkrimi i personit përgjegjës të vendit të origjinës)
(emri, me shkronja të mëdha)

KAPITULLI IV REGJISTRAT

Nënkapitulli 1 Dispozitat e përgjithshme

1. Regjistrat siç janë përcaktuar në Nenin 22 paragrafin 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr-05/2022 për nënproduktet shtazore dhe produktet e derivuara, përveç ushqimeve të kombinuara për kafshë të cilat janë prodhuar nga nënproduktet shtazore ose produktet e derivuara dhe të cilat janë plasuar në treg në pajtim me legjislacionin në fuqi për ushqim për kafshë që do të përmbajë:

1.1. përshkrimin e:

1.1.1. Llojet e kafshëve për materialin e Kategorisë 3 dhe produkteve të derivuara nga ai, të destinuara për përdorim si material për ushqim të kafshëve dhe, nëse është e aplikueshme, në rast të karkasëve dhe kokave, numri i matrikulit;

1.2. sasisë së materialit;

1.2.1. në rast të regjistrave të mbajtur nga cilido person që ngarkon nënprodukte shtazore ose produkte të derivuara, informatat si në vijim:

1.2.1.1. datën në të cilën materiali është marrë nga hapësirat;

1.2.1.2. emrin dhe adresën e transportuesit dhe të pranuesit dhe, nëse e aplikueshme, numrin e aprovimit ose regjistrimit të tyre;

1.3. në rast të regjistrave të mbajtura nga cilido person që transporton nënprodukte shtazore ose produkte të derivuara, informatat si në vijim:

1.3.1. datën në të cilën materiali është marrë nga hapësirat;

1.3.2. vendin e origjinës së materialit, prej nga materiali është dërguar;

1.3.3. emrin dhe adresën e pranuesit dhe, nëse e aplikueshme, numrin e aprovimit ose regjistrimit;

1.4. në rast të regjistrave të mbajtur nga cilido person që pranon nënproduktet shtazore ose produktet e derivuara, informatat si në vijim:

1.4.1. datën e pranimi të materialit;

1.4.2. vendin e origjinës së materialit, prej nga materiali është dërguar;

1.4.3. emrin dhe adresën e transportuesit.

2. Me anë të derogimit nga paragrafi 1 i nënkapitullit 1 të këtij nënkapitulli, operatorët nuk kanë nevojë të mbajnë informatat e përcaktuara në paragrafin 1, nënparagraf 1.1 dhe nënparagraf 1.2 nën nënparagraf 1.2.1 dhe nënparagrafin 1.3 dhe nën-nënparagrafin 1.3.1 dhe 1.3.3 nën nënparagrafin 1.4 dhe 1.4.2 dhe 1.4.3 ndaras, nëse ata mbajnë një kopje të dokumentit komercial të përcaktuar në Kapitullin III të kësaj shtojce për secilën dërgesë dhe vënë në dispozicion informatën e tillë së bashku me informatat e tjera të kërkuara në paragrafin 1 të këtij Nënkapitulli.

3. Operatorët e fabrikave të incinerimit dhe fabrikave të ko-incinerimit do të mbajnë regjistrat e sasive dhe kategorisë së nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara të incineruara ose ko-incineruara, si të jetë e aplikueshme, dhe datën në të cilën ato operime janë kryer.

Nënkapitulli 2

Kërkesat shtesë në rast të përdorimit për qëllime të veçanta të ushqyerjes së kafshëve

1. Përveç regjistrave të kërkuara në pajtim me nënkapitullin 1 të këtij kapitulli, operatorët do të mbajnë regjistrat si në vijim në lidhje me materialin relevant nëse nënproduktet shtazore përdoren për qëllime të veçanta të ushqyerjes së kafshëve në pajtim me Kapitullin II të shtojcës IV:

1.1. në rast të përdoruesve final, sasia e përdorur, kafshët që synohen të ushqehen me të dhe datën e përdorimit;

1.2. në rast të qendrave të grumbullimit;

1.3. sasinë e trajtuar ose përpunuar në pajtim me pikën 4 të Nënkapitullit 1 të Kapitullit I të Shtojcës IV;

1.4. emrin dhe adresën e secilit përdorues final që përdor materialin;

1.5. hapësirat në të cilat materiali është marrë për përdorim;

1.6. sasia e dërguar; dhe

1.7. datën në të cilën materiali është dërguar.

Nënkapitulli 3

Kërkesat për aplikimin e fertilizuesve të caktuar organik dhe pasuruesve të tokës

1. Personi përgjegjës për tokën në të cilën aplikohen fertilizuesit organik dhe pasuruesit e tokës, përveç materialeve të përcaktuara në paragrafin 2 nënparagraf 2.2, Nenit 6 të këtij Udhëzimi Administrativ aplikohet dhe në të cilën kafshët e fermave kanë qasje ose nga të cilat bari prehet për ushqyerje të kafshëve të fermave, do të mbajë regjistra të këtyre si në vijim për një periudhë prej të së paku dy (2) vite:

1.1. sasinë e fertilizuesve organik dhe pasuruesve të tokës që janë aplikuar;

1.2. datën në të cilën fertilizuesit organik dhe pasuruesit e tokës janë aplikuar në tokë dhe vendet e një aplikimi të tillë;

1.3. datat, pas aplikimit të fertilizuesve organik ose pasuruesve të tokës, në të cilat bagëtia është lejuar të kullojë në tokën ose në të cilën tokë janë prerë barishtet që do të përdoren për ushqyerje të kafshëve.

Nënkapitulli 4

Kërkesat për nënprodukte shtazore të derivuara nga kafshët akuatike dhe ushqyerja e peshqëve

1. Fabrikat e procesimit që prodhojnë ushqim të peshkut ose ushqim tjetër (për kafshë) me origjinë nga kafshët akuatike do të mbajnë regjistra si në vijim:

1.1. sasinë e prodhuar çdo ditë;

1.2. llojet e origjinës, përfshirë një tregues nëse kafshët akuatike janë zënë në egërsi apo prodhuar në akuakulturë;

1.3. në rast të ushqimit të peshkut nga peshqit e fermave që synohet për ushqyerje të peshqve të fermave të species tjetër, emrin shkencor të species së origjinës.

Nënkapitulli 5

Kërkesat për djegien dhe groposjen e nënprodukteve shtazore

1. Në rast të djegies ose groposjes së nënprodukteve shtazore siç është përcaktuar në Nenin 19 paragraf 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022 personi përgjegjës për djegie ose groposje të tillë do të mbajë regjistra si në vijim:

1.1. sasinë, kategoritë dhe speciet e nënprodukteve të kafshëve të djegura apo groposura;

1.2. datën dhe vendin e djegies dhe groposjes.

KAPITULLI V

SHËNJIMI I PRODUKTEVE TË CAKTUARA TË DERIVUARA

1. Në fabrikat e procesimit të materialit të Kategorisë 1 ose Kategorisë 2, produktet e derivuara do të shënjohen në mënyrë të përherëshme me gliceroltriheptanoat (GTH) në atë mënyrë që:

1.1. GTH shtohet në produkte të derivuara që i janë nënshtruar trajtimit paraprak termik higjienik në temperaturë në brendi prej së paku 80°C dhe mbesin më pas të mbrojtura nga rikontaminimi;

1.2. të gjitha produktet e derivuara përmbajnë në mënyrë homogjene nëpër gjithë substancën një koncentrim minimal prej së paku 250 mg GTH për kg yndyrë.

2. Operatorët e fabrikave të procesimit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij kapitulli do të kenë të vendosur një sistem të monitorimit dhe regjistrimit të parametrave të përshtatshëm për të demonstruar tek autoriteti kompetent se koncentrimi minimal homogjen i kërkuar i GTH-së është arritur. Ai sistem i monitorimit dhe regjistrimit do të përfshijë përcaktimin e përmbajtjes së GTH-së së paprekur si triglicerid në një ekstrakt 40-70 të petroleum-eterit të pastruar të GTH-së nga mostrat e marrura në intervale të rregullta.

3. shënjimi me GTH nuk do të kërkohet për:

3.1. produktet të derivuara të lëngta të destinuara për fabrika të biogazit apo kompostimit;

3.2. biodizel të prodhuar në pajtim me pikën D të Nënkapitullit 2 të Kapitullit IV të Shtojcës II;

3.3. produktet e derivuara të fituara në pajtim me Nenin 12 paragraf 1 nënparagraf 1.1, nënparagraf 1.1.2 dhe nënparagraf 1.2, nënparagraf 1.2.2 dhe Nenin 13, paragraf 1, nënparagraf 1.2, dhe Nenin 16, paragraf 1, nënparagraf 1.5, të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) NR-05/2022, ku produktet e tilla janë:

3.3.1. lëvizjen me një sistem të mbyllur të shiritave, i cili nuk duhet të tejkalohet, dhe sigurimi i një sistemi të tillë është autorizuar nga autoriteti kompetent, nga fabrika e procesimit;

3.3.2. incinerim ose ko-incinerim direkt dhe të menjëhershëm;

3.3.3. përdorim të menjëhershëm në pajtim me një metodë të aprovuar për nënprodukte shtazore të Kategorisë 1 dhe Kategorisë 2 në pajtim me Kapitullin IV të Shtojcës II të këtij Udhëzimit Administrativ; ose

3.3.4. synohen për hulumtim dhe qëllime tjera specifike siç janë përcaktuar në Nenin 17 të këtij Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) 05/2022 të cilat janë autorizuar nga autoriteti kompetent.

4. Derivatet e rinovueshme të prodhuara nga yndyrat e renderuara të derivuara nga materialet e Kategorive 1 dhe 2 në përputhje me pikën J dhe L të nënkapitullit 2 kapitullit IV të Shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ.

KAPITULLI VI

TRANSPORTI I KAFSHËVE SHOQËRUESE TË NGORDHURA

Kushtet e transportit të një kafshe shoqëruese të ngordhur për djegie në një stabiliment ose impiant të vendosur në një vend tjetër do të autorizohen paraprakisht nga autoriteti kompetent i destinacionit të vendit ose në rastin e rajonit kufitar të një vendi tjetër që ka një kufi të përbashkët me Republikën e Kosovës do të lidhet me marrëveshje dypalëshe për kushtet e transportit.

SHTOJCA VII

KËRKESAT E APLIKUESHME PËR NDËRMARRJE TË CAKTUAR TË APROVUARA DHE REGJISTRUARA

KAPITULLI I

PRODHIMI I USHQIMIT PËR KAFSHËT SHOQËRUESE

1. Ndërmarrjet për përpunimin e ushqimit për kafshët shoqëruese të përcaktuara në nenin 24 paragraf 1 nënparagraf 1.5 të këtij Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) 05/2022 duhet të kenë hapësira adekuate për:

1.1. deponimin dhe trajtimin e sigurtë të materialeve të sjellura, dhe

1.2. hudhjen e mbeturinave të pa përdorura të nën produkteve shtazore pas prodhimit në pajtim me këtë Udhëzim Administrativ, ose ky material duhet dërguar në një ndërmarrje për incenerim, ko-incenerim, procesim ose në rast të kategorisë 3 në biogas ose ndërmarrje për kompostim sipas nenit 12, 13 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) 05/2022 dhe këtij Udhëzimi Administrativ.

KAPITULLI II

MANIPULIMI ME NËN PRODUKTE SHTAZORE PAS GRUMBULLIMIT TË TYRE

1. Kërkesat nga ky kapitull aplikohen tek deponimi i nënprodukteve shtazore të përcaktuara në nenin 24 paragraf 1, nënparagraf 1.9 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) 05/2022 dhe të operacioneve si në vijim pas grumbullimit të nën produkteve shtazore të përcaktuara në nenin 24 paragraf 1, nënparagraf 1.8 të Udhëzimit Administrativ 05/2022 si:

1.1. ndarja;

1.2. coptimi;

1.3. ftofja;

1.4. ngrirja;

1.5. kryposja dhe proceset tjera preservative;

1.6. heqja e lëkurës dhe gëzofit;

1.7. largimi i materialeve të rrezikshme të specifikuara;

1.8. operacionet që përfshijnë nënproduktet shtazore në përputhje me obligimet e dalura nga legjislacioni veterinarë siq është egzaminimi pas therjes ose marrja e mostrave;

1.9. higjienizimi/pasterizimi i nën produkteve shtazore të destinuara për transformim në biogas ose kompostim para transformimit ose kompostimit sipas Shtojcës III;

1.10. sitjen.

2. Proceset e tranzicionit fazor të materialeve të kategorisë 3, si termokoagulimi i gjakut, centrifugimi i gjakut, hidroliza e thundrave, qimeve të derrit, puplave dhe flokëve, të destinuara për përpunim me metodat e përpunimit të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ.

Nënkapitulli 1 Kërkesat e përgjithshme

1. Objektet dhe hapsirat në të cilat zhvillohen operimet e drejtëpërdrejta duhet plotësuar së paku kërkesat si në vijim:

1.1. ato duhet të jenë të ndara në mënyrë adekuate nga kalimet nëpër të cilat mund të shpërndahet kontaminimi nga hapsirat tjera siq janë thertoret;

1.2. Plani i ndërmarrjes duhet siguruar ndarje totale të kategorisë 1 dhe kategorise 2 nga materialet e kategorisë 3 respektivisht prej pranimit deri tek dërgimi përveq nëse ndërtesa është plotësisht e veçantë.

2. Ndërmarrja duhet të ketë hapsirën e mbuluar për pranimin dhe dërgimin e nën produkteve shtazore , përjashtimisht kur derdhja e tyre bëhet përmes instalimeve të cilat parandalojnë shpërndarjen e rreziqeve për shëndetin publiku dhe shëndetin e kafshëve , siq janë gypat e mbyllur për nën produkte shtazore të lëngëta.

3. Ndërmarrja duhet të jetë e konstruktuar në mënyrë që të pastrohet dhe dezinfektohet lehtë.

4. Dyshemeja duhet të jetë e shtruar ashtu që të mundësoj kullimin e lëngjeve.

5. Ndërmarrja duhet të ketë hapsirat adekuate duke përfshirë banjot, dhomat për ndërrimin e veshjes, lavamanet për punëtorët dhe zyret për personelin që ushtron kontrollet zyrtare.

6. Ndërmarrja duhet të ketë mbrojtjen adekuate ndaj brejtësve, insekteve dhe zogjëve.

7. Aty ku e nevojshme, ndërmarrja duhet të ketë hapsirat adekuate të ruajtjes me temperaturë të kontrollueshme dhe kapacitet të mjaftueshëm për mirëmbajtjen e nën produkteve shtazore në temperaturë të duhur të dizajnuar për lejimin e monitorimit dhe shenimit të atyre teperaturave.

8. Ndërmarrja duhet të ketë hapsirat për pastrimin dhe dezinfektimin e kontejnerëve dhe bombolave në të cilat nënproduktet shtazore pranohen si dhe automjeteve me të cilat ato transportohen, si dhe duhet të ketë edhe hapsira për dezinfektimin e rrotave të automjeteve.

Nënkapitulli 2

Kërkesat e higjienës

1. Ndarja e nënprodukteve shtazore duhet të bëhet në mënyrë që të shmanget ç'do rrezik të përhapjes së sëmundjeve të kafshëve.
2. Gjatë gjithë kohës së ruajtjes, nënproduktet shtazore duhet të mbahen dhe ruhen ndaras nga materialet tjera në mënyrë të parandalimit të përhapjes së patogjeneve.
3. Nënproduktet shtazore duhet deponuar në rregull duke përfshirë kushtet e duhura të ftohjes deri në destinacionin final.

Nënkapitulli 3

Standardet perpunuese për higjienizim/pasterizim

Higjienizimi/pasterizimi i përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafit 1.9 të këtij kapitulli duhet të bëhet në pajtim me standardet e procesimit të përcaktuar në paragrafin 1 të Nënkapitullit 1 të Kapitullit 1 nga Shtojca III ose në pajtim me parametrat alternative të transformimit të cilët janë autorizuar në pajtim me pikën 1 të Nënkapitullit 2 të kapitullit III të të njejtës Shtojce.

KAPITULLI III

KËRKESAT PËR DEPONIMIN E PRODUKTEVE TË DERIVUARA

Nënkapitulli 1

Kërkesat e përgjithshme

1. Objektet dhe hapsirat për deponimin e produkteve të derivuara duhet përmbushur së paku kërkesat si në vijim:

1.1. Objektet dhe hapsirat për deponimin e produkteve të derivuara nga materialet e kategorisë 3 nuk duhet të jenë në të njejtin vend ku janë edhe hapsirat për deponimin e produkteve nga kategoria 1 ose kategoria 2, përveq nëse kontaminimi i terthortë është i parandaluar me anë të dizajnit apo menaxhimit të hapsirave sikur të ishin objekte të veqanta/ndara.

2. Objektet duhet të:

2.1. kenë hapsirë të mbuluar për pranimin dhe dërgimin e produkteve të derivuara përveq nëse produktet e derivuara janë:

2.1.1. të larguara përmes instalimeve të cilat parandalojnë shpërndarjen e rrezikut për shëndetin publik dhe shëndetin e kafshëve, sikurse nëpër gypa për produkte të lëngshme;

2.2.2. të pranuar të paketuara sikurse në qese të mëdha ose kontejnerë apo transportues të siguruar që nuk rrjedhin.

3. Jenë të konstruktura në mënyrë që të pastrohen dhe dezinfektohen lehtë. Dyshemeja të mundësojë drenimin e lëngjeve.
4. Të kenë hapsirat adekuate, përfshirë banjot, dhomat e zhveshjes dhe pastrimit për punonjës.
5. Kenë rregullimin adekuat të mbrojtjes nga dëmtuesit sikur se insektet brejtësit dhe shpezët.
6. Objekti duhet të ketë hapsirat adekuate për pastrimin dhe dezinfektimin e kontenjerëve dhe bombolave me të cilat janë pranuar produktet e derivuara si dhe automjetet, përveq anijeve, me të cilat janë transportuar.
7. Produktet e derivuara duhet të deponohen deri në destinimin final të tyre.

Nënkapitulli 2

Kërkesat specifike për deponimin e qumështit, produktet në bazë të qumështit dhe produktet e derivuara nga qumështi

Deponimi i produkteve të përcaktuara në Pjesën II të Nënkapitullit 4 të kapitullit II të Shtojcës VIII duhet vendoset në temperaturë të duhur për ta shmangur qdo rrezik për shëndetin publik dhe shëndetin e kafshëve, në ndërmarrje deponuese të caktuar të aprovuar ose regjistruar apo në deponi të veqar të një ndërmarrjeje të aprovuar ose regjistruar.

Mostrat e produkteve finale të marura gjatë deponimit ose dërgimit nga deponia, duhet së paku të përputhen me standardet mikrobiologjike të përcaktuar në kapitullin I të Shtojcës VIII të këtij Udhëzimi Administrativ.

KAPITULLI IV

OPERATORËT E REGJISTRUAR

1. Operatorët e ndërmarrjeve të regjistruara duhet të operojnë me nën-produktet shtazore dhe produktet e derivuara nën kushtet si në vijim:
 - 1.1. Objektet duhet të jenë të konstruktura në mënyrë që të mundësojnë pastrimin dhe dezinfektimin efikas;
 - 1.2. Objektet duhet të kenë rregullimin adekuat të mbrojtjes nga dëmtuesit sikur se insektet, brejtësit dhe shpezët;
 - 1.3. Instalimet dhe pajisjet duhet të mbahen në kushte të mira higjienike;
 - 1.4. Nën-produktet shtazore dhe produktet e derivuara duhet të jenë të deponuara nën kushte të cilat parandalojnë kontaminimin.
2. Operatorët duhet të mbajnë shenimet në të cilat kanë qasje autoriteti kompetent.
3. Operatorët e regjistruar për transportimin e nën-produkteve shtazore dhe produkteve të derivuara, përveq atyre ndërmjet hapsirave të të njejtë operatorë, duhet:

3.1. të kenë informatën në dispozicion me qëllim të identifikimit të automjetit të tyre me të cilën mundësohet verifikimi i përdorimit të automjetit për transportimin e nën-produkteve shtazore ose produkteve të derivuara;

3.2. duhet të pastrojnë dhe dezinfektojnë automjetet e tyre;

3.3. duhet të ndërmarrin masat e nevojshme për parandalimin e kontaminimit dhe shpërndarjes së sëmundjeve.

SHTOJCA VIII

MATERIALET E USHQIMIT TË KAFSHËVE

KAPITULLI I KËRKESAT E PËRGJITHSHME PËR PËRPUNIM DHE VENDOSJE NË TREG

1. Standardet mikrobiologjike për produktet e derivuara.

2. Standardet në vijim duhet aplikuar për produktet e derivuara.

3. Mostrat nga prodhimet finale të mara nga deponimi ose nxjerrja nga ndërmarrja e përpunimit duhet përmbushur standardet si në vijim:

3.1. Salmonella: mungesë në 25g: $n=5$, $c = 0$, $m = 0$, $M = 0$;

3.2. Enterobacteriaceae: $n = 5$, $c = 2$, $m = 10$, $M = 300$ në 1 g ku:

3.2.1. n =numri i mostrave të cilat duhet testuar;

3.2.2. m =vlera e pragut për numrin e bakterieve; rezultati konsiderohet i kënaqshëm nëse numri i bakterieve në të gjitha mostrat nuk tejkalon m ; M =vlera maksimale për numrin e bakterieve; rezultati konsiderohet i pakënaqshëm nëse numri i baktereve në një ose më shumë mostra është M ose më shumë; dhe

3.2.3. c =numri i mostrave numërimi i baktereve it ë cilave mundet të jetë në mes m dhe M , mostra ende mund të konsiderohet e pranueshme nëse numërimi i baktereve të mostrave tjera është m ose më i vogël.

4. Ndërkaq, standardet mikrobiologjike të përcaktuara në këtë kapitull nuk aplikohen për vajërat e përpunuara dhe vajin e peshkut nga përpunimi i nën produkteve, atëherë kur proteina shtazore e përpunuar, e cila është e nxjerë gjatë të njëjtit procesim, është subjekt i mostrimit për të siguruar përputhshmërinë me këto standarde.

KAPITULLI II

KËRKESAT SPECIFIKE PËR PROTEINET E PROCESUARA SHTAZORE DHE PRODUKTET TJERA TË DERIVUARA

Nënkapitulli 1

Kërkesat specifike për proteinet e procesuara

A. Lënda e parë

1. Vetëm nënproduktet shtazore të cilat janë material të kategorisë 3 ose produktet e derivuara nga materialet e tilla, të tjera nga materialet e kategorisë 3 të përcaktuara në nenin 10, paragraph 1, nënparagraf 1. 14, 1.15 dhe 1.16 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) 05/2022, mund të shfrytëzohen për prodhimin e proteinës së procesuar shtazore.

2. Proteinat shtazore e përpunuar e përftuar nga insektet e kultivuara, e destinuar për prodhimin e ushqimit për kafshët e kultivuara, përveç kafshëve të gëzofit, mund të merret vetëm nga llojet e insekteve si ne vijim:

2.1. Miza *Hermetia illucens*, dhe miza e zakonshme e shtëpisë *Musca domestica*;

2.2. Krimbi *Tenebrio molitor*, dhe Krimbi *Alphi tobius diaperinus*;

2.3. Insektet si *Acheta domesticus*, *Gryllodes sigillatus* dhe *Gryllus assimilis*.

2.4. Krimbi i mëndafshët -*Bombyx mori*.

B. standardet e procesimit

1. Proteinat e procesuara shtazore me origjinë nga gjitarët duhet pranuar në metodën 1 të procesimit (sterilizimi me shtypje) siq është i përcaktuar në kapitullin III të Shtojcës II.

2. Megjithatë, gjaku i derrave ose fraksione të gjakut të derrave për prodhimin e miellit të gjakut mundet të pranohet në vend të sëcilës nga metodat e procesimit nga 1 deri 5 ose metodën e procesimit 7 siq është përcaktuar në kapitullin III të Shtojcës II, duke theksuar se në rast të metodës 7 të procesimit, trajtimi me nxehtësi nëpër tërë substancën duhet të aplikohet me temperaturë prej 80 °C;

3. Proteinat e shtazore me origjinë nga gjitarët.

4. Mund të pranohen me cilëndo nga metodat e procesimit nga 1 deri 5 ose metodën e procesimit 7, siq është e përcaktuar në kapitullin III të Shtojcës II, duke theksuar se më pastaj do të hudhet ose përdoret sikur lëndë për djegje.

5. Atëherë kur është e destinuar vetëm për përdorim sikur ushqim për kafshët shoqëruese, mund të pranohet në secilën nga metodat prej 1 deri 5 të procesimit ose metodën 7 të procesimit, siq është e përcaktuar në kapitullin III të Shtojcës II, duke theksuar se duhet:

5.1. Të transportohet në kontejnerë të dedikuar të cilët nuk përdoren për transportin e nën produkteve shtazore ose ushqimin për kafshe të fermës, dhe

5.2. Të dërguara drejtëpërsëdrejti nga ndërmarrja e procesimit të materialeve të kategorisë 3 tek ndërmarrja për ushqim të kafshëve shoqëruese ose tek deponia e aprovuar e ruajtjes nga e cila dërgohet drejtëpërsëdrejti në ndërmarrjen për ushqim të kafshëve;

5.3. proteinet shtazore të procesuara nga jo gjitarët, me përjashtim të miellit të peshkut, duhet pranuar në secilën nga metodat prej 1 deri 5 të procesimit ose metodën 7 të procesimit, siq është e përcaktuar në kapitullin III të Shtojcës II;

6. Mielli i peshkut duhet pranuar:

6.1. Me secilën nga metodat e procesimit të përcaktuara në kapitullin III të Shtojcës II ose

6.2. Me metodë tjetër e cila siguron se produkti përmbush standardet mikrobiologjike për produktet e derivuara të përcaktuara në kapitullin I të këtij Shtojca.

C. Deponimi

1. Proteinat shtazore të procesuara duhet të pakëtohen dhe deponohen në qese të reja ose të sterilizuara ose të deponohen në hapësira adekuate të deponimit.

2. Produktet nëpër shirite, ashensorë dhe në deponi duhet mbrojtur nga kontaminimi i mundshëm.

3. Pajisjet për manipulimin me proteinat e procesuara shtazore duhet mirëmbahen në kushte të pastërta dhe thata dhe duhet të kenë pikat për inspektim për të mundësuar ekzaminimin për pastërti. Të gjitha hapsirat duhet zbratur dhe pastruar rregullisht deri në masë së parandalimit të kontaminimit.

4. Proteinat e procesuara shtazore duhet mbajtur të thara. Rrjedhja dhe kondenzimi në hapsirat e deponimit duhet parandaluar.

Nënkapitulli 2 Kërkesat specifike për produktet e gjakut

• Lënda e pare

Vetëm gjaku i përcaktuar në nenin 10 paragraf 1, nënparagraf 1.1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) Nr.05/2022, mund të përdoret për prodhimin e produkteve të gjakut.

• Standardet e procesimit

1. Produktet e gjakut mund të pranohen:

1.1. me cilëndo nga metodat e procesimit 1 deri 5 ose metodën 7 të procesimit të përcaktuar në kapitullin III të Shtojcës II, ose

1.2. me metodë tjetër e cila siguron se produkti përmbush standardet mikrobiologjike për produktet e derivuara të përcaktuara në kapitullin I të kësaj Shtojce.

Nënkapitulli 3

Kërkesat specifike për yndyrërat e procesuara, vaji i peshkut dhe derivatet yndyrore nga materialet e kategorisë 3

• **A.Lënda e parë**

1. Yndyrërat e procesuara

1.1. Vetëm materialet e kategorisë 3, të tjera nga materialet e kategorisë 3 të përcaktuara në nenin 10 paragraf 1, nënparagraf 1.14, 1.15 dhe 1.16 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, mund të përdoren për prodhimin e yndyrëve të procesuara.

2. Vaji i peshkut

2.1. Vetëm materialet e kategorisë 3 të përcaktuara në nenin 10 paragraf 1, nënparagraf 1.5 dhe 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr.05/2022 dhe materialet e kategorisë 3 të kafshëve me origjinë akuatike të përcaktuara në nenin 10 paragraf 1, nënparagraf 1.5 dhe 1.6 të këtij Udhëzimit Administrativ mund të përdoren për prodhimin e vajit të peshkut.

B.Standardet e procesimit.

1. Nëse vaji i peshkut ose yndyrërat e përpunuara janë prodhuar në harmoni me legjislacionin në fuqi për përcaktimin e rregullave specifike të higjines së ushqimit me prejardhje shtazore, yndyrërat e procesuara duhet të prodhohen me metodën e procesimit prej 1 deri 5 ose metodën e procesimit 7, ndërsa vaji i peshkut mund të prodhohet:

1.1. Duke përdorur metodat 1 deri 7 të përcaktuara në kapitullin III të Shtojcës II, ose

1.2. Në harmoni me metodë tjetër e cila siguron se produkti përmbush standardet mikrobiologjike për produktet e derivuara të përcaktuara në kapitullin I të kësaj Shtojce.

2. Yndyrat e procesuara të derivuara nga ruminantët duhet të pastrohen në atë mënyrë që niveli maksimal i papastërtive totale të mbetura të mos kalojë 0.15% të peshës.

3. Derivatet e yndyrave nga yndyrërat e procesuara ose vaji i peshkut të derivuara nga kategoria 3 duhet prodhuar në harmoni me një nga metodat e procesimit të përcaktuara në Kapitullin III të Shtojcës II.

- **C.Kërkesat higjienike**

1. Kur yndyrërat e procesuara ose vaji i peshkut është i paketuar, transporti duhet të bëhet në kontejnerë të rinjë ose kontejnerë duhet të jenë të pastruar dhe dezinfektuar për të parandaluar kontaminimin dhe të ndërmiren të gjitha masat për të parandaluar rikontaminimin.
2. Kur transporti i këtyre produkteve kërkohet të bëhet në sasi më të mëdha duhet që gypat, pompat dhe tanket e përdorura ose qdo kontejner tjetër i përdorur për transportim të produkteve nga ndërmarrja e përpunimit ose direkt në anije apo në fabrikë duhet pastruar para përdorimit.

Nënkapitulli 4

Kërkesa specifike për qumështin, kulloshtërën dhe disa produkte të tjera që përfitohen nga qumështi ose kulloshtira

Pjesa I

Kërkesat e përgjithshme

- **A.Lëndë e parë**

1. Vetëm qumështi i përcaktuar në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, përveç centrifugës ose llumit ndarës dhe qumështi i përcaktuar në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 dhe 1.8 i këtij Udhëzimi Administrativ mund të përdoret për prodhimin e qumështit, produkteve me bazë qumështi dhe produkteve me prejardhje nga qumështi.
2. Kulloshtira mund të përdoret vetëm me kusht që të ketë origjinën nga kafshë që nuk kanë shfaqur ndonjë shenjë sëmundjeje të transmetueshme përmes kulloshtërës te njerëzit ose kafshët.

- **B. Standardet e përpunimit**

1. Qumështi duhet t'i nënshtrohet një prej trajtimeve si vijon:

1.1. Sterilizimi me një vlerë F_0 prej tre ose më shumë;

1.2. UHT e kombinuar me një nga sa vijon:

1.2.1. një trajtim fizik të mëpasshëm, nga:

1.2.2. një proces tharjeje, i kombinuar në rastin e qumështit të destinuar për ushqim me ngrohje shtesë deri në 72 °C ose më shumë; ose

1.2.3. duke ulur pH nën 6 për të paktën 1 orë;

1.2.4. qumështi, produkti me bazë qumështi ose produkti me prejardhje nga qumështi të jetë prodhuar të paktën 21 ditë para transportit dhe që gjatë kësaj periudhe të mos jetë shfaqur asnjë rast i sëmundjes Afta Epizootike;

1.2.5. HTST aplikuar dy herë;

1.2.6. HTST3 në kombinim me një nga sa vijon:

1.2.7. një trajtim fizik pasues, nga:

1.2.8. një proces tharjeje, i kombinuar në rastin e qumështit të destinuar për ushqim me ngrohje shtesë deri në 72 °C ose më shumë; ose

1.2.9. uljen e pH nën 6.0 për të paktën 1 orë;

1.2.10. Produktet me bazë qumështi dhe produktet me prejardhje nga qumështi duhet t'i nënshtrohen të paktën një prej trajtimeve të përcaktuara në paragrafin 1 të kësaj pike B ose të prodhohen nga qumështi i trajtuar në përputhje me paragrafin 1 të kësaj pike B.

2. Hirra për t'u ushqyer kafshët të specieve të ndjeshme ndaj sëmundjes Afta Epizootike dhe e prodhuar nga qumështi i trajtuar në përputhje me paragrafin 1 të pikës B duhet:

2.1. ose të mbliidhet të paktën 16 orë pas mpiksjes së qumështit dhe pH i tij duhet të regjistrohet nën 6.0 përpara transportimit në fermat e kafshëve; ose

2.2. të jetë prodhuar të paktën 21 ditë përpara transportit dhe gjatë kësaj periudhe nuk është shfaqur asnjë rast i sëmundjes Afta Epizootike.

3. Përveç kërkesave të përcaktuara në paragrafin 1, 2 dhe 3 të pikës B, qumështi, produktet me bazë qumështi dhe produktet me prejardhje nga qumështi duhet të plotësojnë kërkesat si ne vijim:

3.1. pas përfundimit të përpunimit, duhet të merren të gjitha masat paraprake për të parandaluar kontaminimin e produkteve;

3.2. produkti përfundimtar duhet të etiketohet në mënyrë që të tregojë se ai përmban materiale të Kategorisë 3 dhe nuk është i destinuar për konsum njerëzor, dhe duhet të jenë:

3.3.1. të paketuara në kontejnerë të rinj; ose

3.3.2. të transportohen me shumicë në kontejnerë ose mjete të tjera transporti që para përdorimit janë pastruar dhe dezinfektuar tërësisht.

4. Qumështi i papërpunuar duhet të prodhohet në kushte që ofrojnë garanci adekuate për shëndetin e kafshëve.

5. Kulloshtar dhe produktet e kulloshtres duhet:

5.1. të merret nga kafshët gjedhe që mbahen në një fermë në të cilën të gjitha tufat e gjedhit njihen zyrtarisht të lira nga tuberkulozi, bruceloza dhe leukoza enzootike;

5.2. të jenë prodhuar të paktën 21 ditë përpara transportit dhe gjatë kësaj periudhe nuk është shfaqur asnjë rast i sëmundjes Afta Epizootike;

5.3. t'i jenë nënshtruar një trajtimi të vetëm HTST 3;

5.4. të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në paragrafin 4 te pikës B.

Pjesa II

Shmangia për vendosjen në treg të qumështit të përpunuar në përputhje me standardet kombëtare

1. Kërkesat e përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të kësaj pjese do të zbatohen për përpunimin, përdorimin dhe ruajtjen e qumështit, produkteve me bazë qumështi dhe produkteve me prejardhje nga qumështi, të cilat janë materiale të kategorisë 3, siç përcaktohet në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, përveç llumit të centrifugës ose ndarës, dhe qumështit, produkteve me bazë qumështi dhe qumështit, produkteve të përfituara të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 dhe 1.8 i atij Udhëzimi Administrativ, të cilat nuk janë përpunuar në përputhje me Pjesën I të këtij neni.

2. Autoriteti kompetent autorizon ndërmarrjet e përpunimit të qumështit të aprovuara ose të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për rregullat specifike për higjienën e ushqimit me origjinë shtazore për furnizimin me qumësht, produkte me bazë qumështi dhe produkte me prejardhje nga qumështi për qëllime sipas paragrafit 3 të kësaj pjese, me kusht që objekti në fjalë të sigurojë gjurmueshmërinë e produkteve.

3. Qumështi, produktet me bazë qumështi dhe produktet me prejardhje nga qumështi mund të furnizohen dhe përdoren si material ushqimor:

3.1. në Republikën e Kosovës dhe në zonat ndërkufitare ku Republika e Kosovës ka një marrëveshje të ndërsjellë për këtë qëllim, në rastin e produkteve të përfituara, përfshirë ujin e bardhë, të cilat kanë qenë në kontakt me qumështin e papërpunuar dhe/ose qumështin e pasterizuar në përputhje me kërkesat për trajtimin termik të përcaktuar në legjislacionin në fuqi që përcakton rregulla specifike për higjienën e ushqimit me origjinë shtazore, nëse ato produkte të përfituara i janë nënshtruar një prej trajtimeve të si ne vijim:

3.1.1. UHT;

3.1.2. sterilizimi ku arrihet ose një vlerë F_0 e barabartë ose më e madhe se 3, ose që është kryer në një temperaturë prej të paktën 115 °C për 15 minuta ose një kombinim ekuivalent të temperaturës dhe kohës;

3.1.3. pasterizimi ose sterilizimi, përveç atij të përcaktuar në nënparagrafin 3.1.2 të këtij nënparagrafi, i ndjekur nga:

- 3.1.3.1 në rastin e qumështit të thatë ose produkteve të thata me bazë qumështi ose produkteve me prejardhje nga qumështi, një proces tharjeje;
- 3.1.3.2 në rastin e një produkti qumështi të acidifikuar, një proces me të cilin pH zvogëlohet dhe mbahet për të paktën një orë në një nivel nën 6;

3.2 Në Republikën e Kosovës

3.2.1 në rastin e produkteve të përfituara, duke përfshirë ujin e bardhë, të cilët kanë qenë në kontakt me qumështin që është pasterizuar vetëm në përputhje me kërkesat për trajtimin termik të përcaktuara në legjislacionin në fuqi që përcakton rregullat specifike për higjienën e ushqimit me origjinë shtazore dhe hirrës së prodhuar nga produkte të papërpunuara me bazë qumështi, e cila është mbledhur të paktën 16 orë pas mpiksjës së qumështit dhe ku pH duhet të regjistrohet si $< 6,0$ përpara se të furnizohet me hirrë për ushqim, me kusht që ato të dërgohen në një numër të kufizuar të fermave të autorizuara të kafshëve, të identifikuara në bazë të vlerësimit të rrezikut në përgatitjen e planit kontigjent për sëmundjet epizootike, në veçanti Afta Epizootike;

3.2.2 në rastin e produkteve të papërpunuara, duke përfshirë ujin e bardhë që ka qenë në kontakt me qumështin e papërpunuar dhe produkte të tjera për të cilat sigurohen trajtimet e përcaktuara në nënparagrafin 3.1 të këtij paragrafi dhe nën paragrafin 3.2, nënparagrafin 3.2.1 të këtij paragrafi, të parashikuara se ato dërgohen në një numër të kufizuar të pronave të autorizuara të kafshëve, të identifikuara në bazë të vlerësimit të rrezikut në përgatitjen e planit kontigjent për sëmundjet epizootike, në veçanti Afta Epizootike;

3.2.2.1 ose drejtpërdrejt në një thertore të vendosur në Republikën e Kosovës, ose

3.2.2.2 në një fermë tjetër në Republikën e Kosovës, për të cilën autoriteti kompetent garanton se kafshët e ndjeshme ndaj sëmundjes Afta Epizootike mund të largohen nga ferma vetëm drejtpërdrejt në një thertore të vendosur në Republikën e Kosovës, ose nëse kafshët janë dërguar në një fermë që nuk ushqen me produktet e përcaktuara në këtë nënparagraf 3.2.2, pasi të ketë kaluar një periudhë 21 ditore ndalimi nga ripopullimi fermës.

4. Autoriteti kompetent mund të autorizojë furnizimin me kulloshtër që nuk përputhet me kushtet e përcaktuara në pikën B, paragrafi 6 i pjesës I të këtij Nënkapitulli 4, nga një fermer te një fermer tjetër për qëllime ushqimi, për arsye që të parandalojnë transmetimin e rreziqeve për shëndetin publik dhe të kafshëve.

Pjesa III

Kërkesa të veçanta për llumrat e centrifugës ose ndarësit

1. Materiali i kategorisë 3 që përbëhet nga llumi i centrifugës ose ndarës duhet t'i jetë nënshtruar një trajtimi termik prej të paktën 70 °C për 60 minuta ose të paktën 80 °C për 30 minuta, përpara se të vendoset në treg për të ushqyer kafshë të kultivuara.

2. Përfundimisht paragrafi 1 të pjesës 3 autoriteti kompetent mund të autorizojë parametra alternativë për trajtimin termik të llumit të centrifugës ose ndarës të destinuar për përdorime brenda territorit të Republikës së Kosovës me kusht që operatorët të mund të demonstrojnë se trajtimi termik sipas parametrave alternativë garanton të paktën të njëjtin reduktim të rrezikut si trajtimi i kryer sipas parametrave të përcaktuar në pikën 1 të kësaj Pjese.

Nënkapitulli 5

Kërkesa specifike për xhelatinë dhe proteina të hidrolizuara

• A. Lëndët e para

Vetëm nënproduktet shtazore të cilat janë materiale të Kategorisë 3 ose produkte të cilat rrjedhin nga nënproduktet e tilla shtazore, përveç materialeve të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13, 1.14, 1.15 dhe 1.16 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, mund të përdoren për prodhimin e xhelatinës dhe proteinave të hidrolizuara.

• B. Standardet e përpunimit të xhelatinës

1. Përveç rasteve kur xhelatina është prodhuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për rregulla specifike për higjienën e ushqimit me origjinë shtazore, ajo duhet të prodhohet me një proces që siguron që materiali i kategorisë 3 i nënshtrohet në një trajtim me acid ose alkaline, i ndjekur nga një ose më shumë shpërlarje.

2. PH duhet të rregullohet më pas. Xhelatina duhet të nxirret me ngrohje një herë ose disa herë radhazi, e ndjekur nga pastrimi me anë të filtrimit dhe sterilizimit.

3. Pasi t'i nënshtrohet proceseve të përcaktuara në paragrafin 1 të kësaj pike B, xhelatina mund t'i nënshtrohet një procesi tharjeje dhe, sipas rastit, një procesi pluhurimi ose petëzimi.

4. Ndalohet përdorimi i konservuesve, përveç dioksidit të sulfurit dhe peroksidit të hidrogjenit.

• C. Kërkesa të tjera për xhelatinë

1. Xhelatina duhet të mbështillet, paktohet, ruhet dhe transportohet në kushte të kënaqshme higjienike, veçanërisht:

1.1. duhet të sigurohet një dhomë ose një vend i dedikuar për ruajtjen e materialeve për ambalazhim dhe paketim;

1.2. mbështjellja dhe paketimi duhet të bëhet në një dhomë ose në një vend të destinuar për këtë qëllim.

D. Standardet e përpunimit për proteinat e hidrolizuara

1. Proteina e hidrolizuar duhet të prodhohet duke përdorur një proces prodhimi që përfshin masat e duhura për të minimizuar kontaminimin. Proteina e hidrolizuar e përfutur nga ripërtypësit duhet të ketë një peshë molekulare nën 10 000 Dalton.

2. Përveç kërkesave të paragrafit 1 të pikës D, proteinat e hidrolizuara të përfutura tërësisht ose pjesërisht nga lëkurat dhe lëkurat e ripërtypësve do të prodhohen në një fabrikë përpunimi të dedikuar vetëm për prodhimin e proteinave të hidrolizuara, duke përdorur një proces që përfshin përgatitjen e lëndës së parë. Materiali i kategorisë 3 me kripë, gëlqere dhe larje intensive të ndjekur nga ekspozimi i materialit ndaj:

2.1. një pH më shumë se 11 për më shumë se tre orë në një temperaturë prej më shumë se 80 °C dhe më pas me trajtim termik në më shumë se 140 °C për 30 minuta në më shumë se 3,6 bar; ose

2.2. një pH prej 1 deri në 2, e ndjekur nga një pH prej më shumë se 11, e ndjekur nga trajtimi termik në 140 °C për 30 minuta në 3 bar.

Nënkapitulli 6

Kërkesa specifike për dikalcium fosfat

A. Lëndët e para

Vetëm nënproduktet shtazore të cilat janë materiale të Kategorisë 3 ose produktet të cilat rrjedhin nga nënproduktet e tilla shtazore, përveç materialeve të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13, 1.14, 1.15 dhe 1.16 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, mund të përdoren për prodhimin e fosfatit të dikalciumit.

B. Standardet e përpunimit

1. Fosfati i dikalciumit duhet të prodhohet nga një proces që përfshin tre fazat si ne vijim:

1.1. së pari, siguron që e gjithë kocka që është material i Kategorisë 3 të grimcohet imët dhe të lyhet me ujë të nxehtë dhe të trajtohet me acid klorhidrik të holluar - në një përqendrim minimal prej 4% dhe një pH më pak se 1,5 gjatë një periudhe prej të paktën dy ditë;

1.2. së dyti, në vijim të pjesës së procesit të përcaktuar në nënparagrafin 1.1 të këtij paragrafi, zbatohet trajtimi i lëngut fosforik të përfutur me gëlqere, duke rezultuar në një precipitat të fosfatit dikalcium në pH 4 deri në 7;

1.3. në fund, thahet me ajër precipitati i fosfatit të dikalciumit me temperaturë hyrëse prej 65 °C deri në 325 °C dhe temperaturë fundore ndërmjet 30 °C dhe 65 °C.

2. Kur fosfati i dikalciumit përfitohet nga kockat e dhjamosura, ai do të përfitohet nga kockat e përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022.

Nënkapitulli 7

Kërkesa specifike për fosfatin e trikalciut

A. Lëndët e para

Vetëm nënproduktet shtazore të cilat janë materiale të Kategorisë 3 ose produkte të cilat përfitohen nga nënproduktet e tilla shtazore, përveç materialeve të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13, 1.14, 1.15 dhe 1.16 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, mund të përdoren për prodhimin e fosfatit të trikalciut.

B. Standardet e përpunimit

1. Fosfati i trikalciut duhet të prodhohet me një proces që siguron:

- 1.1. që e gjithë kocka që është material i Kategorisë 3 është grimtuar imët dhe i hiqet yndyra në kundërvënje me ujë të nxehtë - kockat e copëtuara duhet të jenë më pak se 14 mm;
- 1.2. gatim i vazhdueshëm me avull në 145 °C për 30 minuta në 4 bar;
- 1.3. ndarja e lëngut të proteinës nga hidroksiapatiti - fosfati i trikalciut me centrifugim;
- 1.4. granulimi i fosfatit të trikalciut pas tharjes në një shtrat të lëngshëm me ajër në 200 °C.

Nënkapitulli 8

Kërkesa specifike për kolagjen

A. Lëndët e para

Vetëm nënproduktet shtazore të cilat janë materiale të Kategorisë 3 ose produktet të cilat rrjedhin nga nënproduktet e tilla shtazore, përveç materialeve të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.13, 1.14, 1.15 dhe 1.16 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, mund të përdoren për prodhimin e kolagjenit.

B. Standardet e përpunimit

1. Përveç rasteve kur kolagjeni është prodhuar në përputhje me kërkesat për kolagjenin të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi që përcakton rregulla specifike për higjienën e ushqimit me origjinë shtazore, ai duhet të prodhohet nga një proces që siguron që materiali i papërpunuar i

Kategorisë 3 i nënshtrohet një trajtimi që përfshin larje, rregullim të pH-së duke përdorur acid ose alkaline, i ndjekur nga një ose më shumë shpëlarje, filtrim dhe shtrydhje. Pas këtij trajtimi, kolagjeni mund t'i nënshtrohet një procesi tharjeje.

2. Ndalohet përdorimi i konservuesve, përveç atyre të lejuar sipas legjislacionit në fuqi.

C. Kërkesa të tjera

1. Kolagjeni duhet të mbështillet, paketohet, ruhet dhe transportohet në kushte të kënaqshme higjienike, veçanërisht:

1.1. duhet të sigurohet një dhomë ose një vend i dedikuar për ruajtjen e materialeve për ambalazhim dhe paketim;

1.2. ambalazhimi dhe paketimi duhet të bëhet në një dhomë ose në një vend të destinuar për këtë qëllim.

Nënkapitulli 9

Kërkesa specifike për produktet e vezëve

A. Lëndët e para

Vetëm nënproduktet shtazore të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5 dhe 1.6 dhe nënparagrafi 1.11.2 i nënparagrafit 1.11 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, mund të përdoren për prodhimin e produkteve të vezëve.

B. Standardet e përpunimit

1. Produktet e vezëve duhet:

1.1. t'i nënshtrohen cilësdo nga metodat e përpunimit 1 deri në 5 ose metodës 7 së përpunimit të përcaktuara në kapitullin III të shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.2. t'i nënshtrohen një metode dhe parametrave tjerë që sigurojnë që produktet janë në përputhje me standardet mikrobiologjike për produktet e prejardhura të përcaktuara në Kapitullin I të kësaj Shtojce; ose

1.3. të trajtohen në përputhje me kërkesat për vezët dhe produktet e vezëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për rregullat specifike për higjienën e ushqimit me origjinë shtazore.

Nënkapitulli 10

Kërkesat specifike për ushqimin e kafshëve të kultivuara, përveç kafshëve me gëzof, me materiale të caktuara të Kategorisë 3,

1. Materiali i kategorisë 3 që përbëhet nga produkte ushqimore që përmbajnë produkte me origjinë shtazore të cilat nuk janë më të destinuara për konsum njerëzor për arsye komerciale ose për shkak të të metave të prodhimit, paketimit ose defekteve të tjera nga të cilat nuk shfaqin asnjë rrezik për

shëndetin publik dhe të kafshëve, të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1.6 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, mund të vendosen në treg për ushqim të kafshëve të kultivuara, përveç kafshëve me gëzof, pa trajtim të mëtejshëm, me kusht që materiali:

1.1. i është nënshtruar përpunimit të përcaktuar në legjislacioni në fuqi për higjienën e produkteve ushqimore ose në përputhje me këtë Udhëzim Administrativ;

1.2. është i përbërë ose përmban një ose më shumë nga materialet e kategorisë 3 në vijim të përcaktuara në nenin 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 si:

1.2.1. qumësht;

1.2.2. produkt me bazë qumështi;

1.2.3. produkte me prejardhje nga qumështi;

1.2.4. vezët;

1.2.5. produktet e vezëve;

1.2.6. mjaltë;

1.2.7. yndyrna të përpunuara;

1.2.8. kolagjen;

1.2.9. xhelatinë;

1.2.10. nuk ka qenë në kontakt me asnjë material tjetër të Kategorisë 3; dhe

1.2.11. janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar ndotjen e materialit.

KAPITULLI III

KËRKESAT PËR USHQIMIN E CAKTUAR TË PESHQVE DHE KARREMAT E PESHKIMIT

1. Nënproduktet e kafshëve nga peshqit ose jovertebrorët ujorë dhe produktet e prejardhura prej tyre që janë të destinuara si ushqim për peshqit e kultivuar ose për lloje të tjera të akuakulturës duhet:

1.1. të trajtohen dhe përpunohen veçmas nga materiali i paautorizuar për këtë qëllim;

1.2. kanë origjinë;

1.3. nga peshqit e egër ose kafshë të tjera akuatike, përveç gjitarëve të detit, të zbarkuar për qëllime komerciale, ose nga nënproduktet shtazore nga peshqit e egër me origjinë nga bimët që prodhojnë produkte peshku për konsum njerëzor; ose

1.4. nga peshqit e kultivuar, me kusht që të ushqehet me peshq të kultivuar të një lloji tjetër;

1.5. të përpunohet në një fabrikë përpunimi në përputhje me një metodë që siguron një produkt mikrobiologjikisht të sigurt, duke përfshirë në lidhje me patogjenët e peshkut.

2. Autoriteti kompetent mund të përcaktojë kushte, që synojnë parandalimin e rreziqeve të papranueshme për transmetimin e sëmundjeve të transmetueshme te njerëzit ose kafshët, për përdorimin e kafshëve akuatike dhe të jovertebrorëve ujorë dhe tokësorë:

2.1. si ushqim për peshqit e kultivuar ose për jovertebrorët ujorë, kur nënproduktet shtazore nuk janë përpunuar në përputhje me paragrafin 1, nënparagrafi 1.3 të këtij Kapitulli;

2.2. si karrem për peshkim, duke përfshirë karremin për jovertebrorët ujorë.

SHTOJCA IX

PLEHRAT ORGANIKE DHE PËRMIRËSUESIT E TOKËS

KAPITULLI I

KËRKESAT PËR PLEH ORGANIK TË PAPËRPUNUAR, PLEH ORGANIK TË PËRPUNUAR DHE PRODUKTE TË PËRFTUARA NGA PLEHU ORGANIK I PËRPUNUAR

Nënkapitulli 1

Plehu organik i papërpunuar

1. Tregtia e plehut organik të papërpunuar të specieve të tjera përveç shpendëve ose ekuidave do t'i nënshtrohet kushteve si ne vijim:

1.1. Tregtia e plehut organik të papërpunuar të specieve të tjera përveç shpendëve ose ekuidave do të ndalohet, përveç plehut organik;

1.2. nga një zonë që nuk i nënshtrohet kufizimeve për shkak të një sëmundjeje të rëndë të transmetueshme; dhe

1.3. të destinuara për aplikim, nën mbikëqyrjen e autoriteteve kompetente, në tokat që janë pjesë e një ferme të vetme.

2. Megjithatë, autoriteti kompetent, duke pasur parasysh origjinën e plehut organik, destinacionin e tij dhe konsideratat shëndetësore, mund të japë autorizim specifik për futjen në territorin e tij të:

2.1. plehut organik të destinuar për:

- 2.1.1. përpunim në një fabrikë për prodhimin e produkteve të përfituara të cilat janë të destinuara për përdorime jashtë zinxhirit ushqimor, ose
- 2.1.2. transformim në biogaz ose kompostim në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 dhe me Shtojcën III të këtij Udhëzimi Administrativ me qëllim të prodhimit të produkteve të përcaktuara në nënkapitullin 2 të këtij Kapitulli.
- 2.2. Në këto raste, autoriteti kompetent merr parasysh origjinën e plehut organik kur autorizon aplikimin në bimë të tilla; ose
- 2.3. pleh organik i destinuar për aplikim në tokë në një pronë, me kusht që autoriteti kompetent të ketë komunikuar marrëveshjen e tij për një tregti të tillë.
3. Në rastet e përcaktuara në nënparagrafin 1.2 të këtij paragrafi, dokumentit tregtar që shoqëron ngarkesën e plehut organik i shtohet një vërtetim shëndetësor në përputhje me modelin e përcaktuar në paragrafin 3 të këtij Nënkapitulli.
4. Tregtimi i plehut organik të papërpunuar të shpendëve do t'i nënshtrohet kushteve si ne vijim:
- 4.1. plehu duhet të jetë me origjinë nga një zonë që nuk i nënshtrohet kufizimeve për shkak të sëmundjes së Neëcastle ose gripit të shpendëve;
- 4.2. Përveç kësaj, plehu i papërpunuar nga tufat e shpendëve të vaksinuara kundër sëmundjes së Neëcastle nuk duhet të dërgohet në një rajon që ka marrë statusin jo-vaksinues për sëmundjen e Neëcastle; dhe
- 4.3. një vërtetim shëndetësor në përputhje me modelin e përcaktuar në paragrafin 3 i shtohet dokumentit tregtar që shoqëron ngarkesën e plehut organik.
5. Modeli i certifikates shëndetësore që do t'i shtohet dokumentit tregtar.

REPUBLIKA E KOSOVËS

Dokument tregtar

Pjesa I: Detajet e dërgesës së dërguar	I.1. Dërguesi	II.2. Referenca e dokumentit Nr	II.2. Referenca lokale Nr
	Emri	I.3. Autoriteti Kompetent Qendror	
	Adresa	I.4. Autoriteti Kompetent Vendor	
	Kodi Postar		
	I.5. Marrësi	I.6.	

Emri				I.7.			
Adres							
Kodi Postar							
Tel.							
I.8. Vendi i origjinës	Kodi ISO	I.8. Rajoni i origjinës	Kodi	I.10. Vendi i destinacionit	Kodi ISO	I.11. Rajoni i destinacionit	Kodi
I.11. Vendi i origjinës				I.13. Vendi i destinacionit			
Objekti ☐				Objekti ☐ Të tjera ☐			
Emri Numri i miratimit				Emri Numri i miratimit			
Adresa				Adresa			
Kodi Postar				Kodi Postar			
I.13. Vendi i ngarkimit				I.15. Data e nisjes			
I.16. Mjetet e transportit				I.17. Transportuesi			
Aeroplan ☐ Anije ☐				Emri			
Vagon hekurudhor ☐				Numri i miratimit			
Automjet rrugor ☐ Tjetër ☐				Adresa			
Identifikimi:				Vendi i kodit postar			
I.18. Përshkrimi i mallit						I.19. Kodi i mallit (kodi CN)	
						I.20. Sasia totale	
I.21. Temperatura e produktit						I.22. Numri i pakove	
Ambient ☐ I ftohur ☐ I ngrirë ☐							
I.23. Vula/ Numri i kontejnerit						I.24. Lloji i paketimit	
I.25. Mallrat e certifikuara për:							
Përdorimi teknik ☐							
I.26. Tranziti përmes një vendi tjetër ☐				I.27. Për tranzit nëpër Republikën e Kosovës ☐			
Shtet tjetër				Kodi ISO			
Pika e daljes				Kodi			
Pika e hyrjes				Njësia BIP Nr.			
I.28. Eksporti ☐				I.29.			
Shtet tjetër				Kodi ISO			
Pika e daljes.				Kodi			
I.30.							
I.31. Identifikimi i mallrave							

Pjesa II: Certifikimi	II. Informacion shëndetësor	II.a. Numri i referencës së certifikatës	II.b.
	II. Vërtetim shëndetësor Unë, veterineri zyrtar i poshtëshënuar, deklaroj se e kuptoj se autoriteti kompetent i vendit të destinacionit ka dhënë pëlqimin e tij për futjen e plehut organik të papërpunuar në territorin e tij dhe se plehu i papërpunuar i referuar në kutinë e referencës 1.18 përputhet me kushtet e mëposhtme: (a) në rastin e plehut organik të shpendëve të papërpunuar (1): [Plehu organik e ka origjinën nga një zonë e cila nuk është subjekt i kufizimeve për shkak të sëmundjes Newcastle ose gripit të shpendëve.] dhe [Në rastin e plehut organik të papërpunuar nga tufat e shpendëve të vaksinuara kundër sëmundjes së Newcastle, plehu nuk dërgohet në një rajon i cili ka marrë statusin jo-vaksinues për sëmundjen e Newcastle në përputhje me nenin 15(2) të Direktivës 2009/158/EC.] (b) në rastin e plehut organik të papërpunuar të specieve të ndryshme nga shpendët ose kuajt (""): [Plehu organik e ka origjinën nga një zonë e cila nuk është subjekt i kufizimeve për shkak të një sëmundjeje të rëndë të transmetueshme.] dhe ose [Plehu është i destinuar për përpunim në një fabrikë për prodhimin e produkteve të derivuara të cilat janë të destinuara për përdorime jashtë zinxhirit të ushqimit ose pleh organik i destinuar për transformim në biogaz ose kompostim në përputhje me Rregulloren (KE) Nr 1069/2009 me qëllim prodhimin e plehut organik të përpunuar ose produkteve të plehut të përpunuar.] ose [Plehu organik është menduar për aplikim në tokë në një fermë.] Shënime Pjesa I: - Referenca e kutisë I.9 dhe I.11: nëse është e përshtatshme. - Referenca e kutisë I.12, I.13 dhe I.17: numri i miratimit ose numri i regjistrimit. - Referenca e kutisë I.14: plotësoni nëse është ndryshe nga 'I.1. Dërguesi'. - Referenca e kutisë I.25: përdorim teknik: çdo përdorim tjetër përveç konsumit të kafshëve. - Referenca e kutisë I.31: Natyra e mallit: 'plehu'. Pjesa I: (1) Fshijeni sipas rastit.		
Veterinari zyrtar/Inspektori zyrtar Emri (me shkronja të mëdha): Data: Vula: Kualifikimi dhe titulli: Nënshkrimi:			

6. Plehrat e papërpunuara të kuajve mund të tregtohen dhe me kusht që të mos vijnë nga një fermë që i nënshtrohet kufizimeve për shëndetin e kafshëve në lidhje me gjëndrat, stomatitin vezikular, antraksin ose tërbimin.

7. Autoriteti kompetent i vendit të destinacionit mund t'u kërkojë operatorëve që dërgojnë pleh organik të papërpunuar që të ofrojnë informacione të mtejshme në lidhje me dërgimin e synuar,

si tregues të saktë gjeografik në lidhje me vendin ku do të shkarkohet plehu dhe para aplikimit në tokë të njoftohet autoriteti kompetent.

8. Autoriteti kompetent mund të autorizojë dërgimin e plehut organik të transportuar ndërmjet dy pikave të vendosura në të njëjtën fermë, në varësi të kushteve për kontrollin e rreziqeve të mundshme shëndetësore, siç janë detyrimet për operatorët në fjalë për të mbajtur të dhënat e duhura.

Nënkapitulli 2

Guano nga lakuriqët e natës, pleh organik i përpunuar dhe produkte të përfituara nga plehu i përpunuar

1. Vendosja në treg e plehut organik të përpunuar, produkteve të përfituara nga plehu i përpunuar dhe guanos nga lakuriqët e natës do t'i nënshtrohet kushteve si ne vijim:

1.1. ato duhet të vijnë nga një fabrikë për produkte të përfituara për përdorime jashtë zinxhirit ushqimor ose nga një fabrikë biogazi, kompostimi ose nga një fabrikë për prodhimin e plehrave organike apo përmirësuesve të tokës;

1.2. ato do t'i jenë nënshtroar një procesi trajtimi termik prej të paktën 70 °C për të paktën 60 minuta dhe do t'i nënshtrohen reduktimit të baktereve që formojnë spore dhe formimit të toksinave, ku ato identifikohen si një rrezik relevant;

1.3. Megjithatë, autoriteti kompetent mund të autorizojë përdorimin e parametrave të tjerë të standardizuar të procesit përveç atyre të përcaktuara në nënparagrafin 1.2 të këtij paragrafi, me kusht që aplikanti të demonstrojë se parametra të tillë sigurojnë minimizimin e rreziqeve biologjike. Ky demonstrim do të përfshijë një validim, i cili do të kryhet si vijon:

1.3.1. identifikimi dhe analiza e rreziqeve të mundshme duke përfshirë ndikimin e materialit hyrës, bazuar në një përcaktim të plotë të kushteve të përpunimit dhe një vlerësim të rrezikut, i cili vlerëson se si arrihen kushtet specifike të përpunimit në praktikë në situata normale dhe jotipike.

2. Validimi i procesit të synuar duke matur reduktimin e qëndrueshmërisë / infektivitetit të organizmave tregues endogjenë gjatë procesit, ku treguesi është:

2.1. i pranishëm vazhdimisht në lëndën e parë në numër të lartë;

2.2. jo më pak rezistent ndaj nxehtësisë ndaj aspekteve vdekjeprurëse të procesit të trajtimit, por gjithashtu jo dukshëm më rezistent se patogjenët për të cilët përdoret për të monitoruar;

2.3. relativisht i lehtë për t'u llogaritur dhe për t'u identifikuar dhe konfirmuar; ose

2.4. duke matur reduktimin e qëndrueshmërisë/infektivitetit, gjatë ekspozimit, të një organizmi testues ose virusi të karakterizuar mirë të futur në një trup të përshtatshëm testues në materialin fillestar.

3. Validimi i përmendur në nënparagrafin 1.3.2 të këtij nënparagrafi duhet të tregojë se procesi arrin reduktimin e përgjithshëm të rrezikut si në vijim:

3.1. për proceset termike dhe kimike nga reduktimi i *Enterococcus faecalis* me të paktën 5 log10 dhe nga reduktimi i titrit të infektivitetit të viruseve termorezistente si parvovirusi, ku identifikohen si një rrezik përkatës, me të paktën 3 log10;

3.2. për proceset kimike edhe nga reduktimi i parazitëve rezistent si vezët e specieve *Ascaris* me të paktën 99,9 % (3 log10) të fazave të zbatueshme.

4. Hartimi i një programi të plotë kontrolli duke përfshirë procedurat për monitorimin e procesit.

5. Masat që sigurojnë monitorim dhe mbikëqyrje të vazhdueshme të parametrave përkatës të procesit të vendosura në programin e kontrollit gjatë funksionimit të fabrikës.

6. Detajet mbi parametrat përkatës të procesit të përdorur në një fabrikë, si dhe pikat e tjera kritike të kontrollit duhet të regjistrohen dhe mirëmbahen në mënyrë që pronari, operatori ose përfaqësuesi i tyre dhe autoriteti kompetent mund të monitorojë funksionimin e fabrikës.

7. Informacioni në lidhje me një proces të autorizuar sipas kësaj pike duhet t'i vihet në dispozicion Komisionit sipas kërkesës.

8. Mostrat përfaqësuese të plehut organik të marra gjatë ose menjëherë pas përpunimit në fabrikë për të monitoruar procesin duhet të jenë në përputhje me standardet si në vijim:

8.1. *Escherichia coli*: $n = 5$, $c = 5$, $m = 0$, $M = 1\ 000$ in 1 g; ose

8.2. *Enterococcaceae*: $n = 5$, $c = 5$, $m = 0$, $M = 1\ 000$ in 1 g;
dhe

9. Mostrat përfaqësuese të plehut organik të marra gjatë ose pas tërheqjes nga magazinimi në fabrikën e prodhimit ose në fabrikën e biogazit ose kompostimit duhet të jenë në përputhje me standardet si në vijim:

- *Salmonela*: mungesë në 25 g: $n = 5$; $c = 0$; $m = 0$; $M = 0$
ku:

- n = numri i mostrave që do të testohen;

- m = vlera e pragut për numrin e baktereve;

- rezultati konsiderohet i kënaqshëm nëse numri i baktereve në të gjitha mostrat nuk e kalon m :

- M = vlera maksimale për numrin e baktereve;
- rezultati konsiderohet i pakënaqshëm nëse numri i baktereve në një ose më shumë mostra është M ose më shumë; dhe
- c = numri i mostrave, numri bakterial i të cilave mund të jetë midis m dhe M , mostra ende konsiderohet e pranueshme nëse numri bakterial i mostrave të tjera është m ose më pak.

10. Plehrat e përpunuara ose produktet e plehut të përpunuar që nuk përputhen me standardet në këtë pikë do të konsiderohen si të papërpunuara;

11. Ato duhet të ruhen në mënyrë të tillë që pasi të përpunohen ndotja ose infeksioni dhe lagështia dytësore të minimizohen. Prandaj ato duhet të ruhen në:

11.1. objekte të mbyllura dhe të izoluara mirë ose depo magazinimi të ndërtuara siç duhet; ose

11.2. pako të mbyllura siç duhet, të tilla si qese plastike ose "*qese të mëdha*".

KAPITULLI II

KËRKESAT PËR PLEHRA TË KAKTUAR ORGANIKË DHE PËRMIRËSUES TË KAKTUAR TË TOKËS

Nënkapitulli 1

Kushtet e prodhimit

1. Plehrat organike dhe përmirësuesit e tokës, përveç plehut të kafshëve, përmbajtjes së traktit tretës, kompostos, qumështit, produkteve me bazë qumështi, produkteve me prejardhje nga qumështi, kulloshtres, produkteve të kulloshtres dhe mbetjeve të tretjes nga shndërrimi i nënprodukteve shtazore ose produkteve të prejardhura në biogaz, të prodhohet duke:

1.1. aplikuar metodën e përpunimit 1 - sterilizimi me presion, kur materiali i kategorisë 2 përdoret si material fillestar;

1.2. përdorur proteinat shtazore të përpunuara, përfshirë proteinat shtazore të përpunuara të prodhuara në përputhje me pikën B, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, nën-paragrafi 1.2.2 i Nënkapitullit 1 të Kapitullit II të Shtojcës VIII të këtij Udhëzimi Administrativ, i cili është prodhuar nga materiali i kategorisë 3 në përputhje me nënkapitullin 1 të Kapitullit II të Shtojcës VIII të këtij Udhëzimi Administrativ, ose materialet të cilat i janë nënshtruar një trajtimi tjetër, ku materialet e tilla mund të përdoren për plehra organike dhe përmirësues të tokës në përputhje me këtë Udhëzim Administrativ; ose

1.3. duke zbatuar ndonjë nga metodat e përpunimit 1 deri në 7, siç përcaktohet në Kapitullin III të Shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ, kur materiali i kategorisë 3 përdoret si lëndë fillestare që nuk përdoret për prodhimin e proteinave shtazore të përpunuara.

2. Plehrat organike dhe përmirësuesit e tokës që përbëhen ose që janë prodhuar nga ushqimi me mish dhe kocka të përfutuara nga materiali i kategorisë 2 ose nga proteina shtazore të përpunuara, do të përzihen, në një ndërmarrje ose fabrikë të regjistruar, me një përqindje minimale të mjaftueshme të një përbërësi i cili është i autorizuar nga autoriteti kompetent, me qëllim që të përjashtohet përdorimi i mëpasshëm i përzierjes për qëllime të ushqyerjes.

3. Autoriteti kompetent do të autorizojë komponentin e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij Nënkapitulli në përputhje me si vijon:

3.1. komponenti duhet të përbëhet nga gëlqere, pleh organik, urinë, kompost ose mbetje të tretjes nga shndërrimi i nënprodukteve shtazore në biogaz ose substanca të tjera, të tilla si plehrat minerale, të cilat nuk përdoren në ushqimin e kafshëve dhe që përjashtojnë përdorimin e mëvonshëm të përzierjes për qëllime të ushqyerjes sipas praktikës së mirë bujqësore;

3.2. komponenti do të përcaktohet bazuar në një vlerësim të kushteve klimatike dhe tokësore për përdorimin e përzierjes si pleh, mbi indikacionet që përbërësi e bën përzierjen të papëlqyeshme për kafshët ose është ndryshe efektiv në parandalimin e keqpërdorimit të përzierjes për qëllime ushqimi dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe legjislacionin për ujrat.

4. Autoriteti kompetent do t'i vërë në dispozicion Komisionit dhe Shteteve të tjera Anëtare listën e komponentëve të autorizuar sipas kërkesës.

5. Megjithatë, kërkesat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij Nënkapitulli nuk do të zbatohen:

5.1. për plehrat organike dhe përmirësuesit e tokës, të cilat janë në ambalazhe të gatshme për shitje me peshë jo më shumë se 50 kg për përdorim nga konsumatori përfundimtar; ose

5.2. për plehrat organike dhe përmirësuesit e tokës në thasë të mëdhenj me peshë jo më shumë se 1 000 kg, në ambalazhet e të cilave tregohet se plehrat organike nuk janë të destinuara për tokën në të cilën kanë qasje kafshët e kultivuara, me kusht që autoriteti kompetent të ketë autorizuar përdorimin e qeseve të tilla të mëdha në bazë të një vlerësimi të mundësisë së një devijimi të mundshëm të materialeve në fermat që mbajnë kafshë ose në tokën në të cilën kafshët e kultivuara kanë qasje.

6. Prodhuesit e plehrave organike dhe përmirësuesve të tokës duhet të sigurojnë që dekontaminimi i patogjenëve të kryhet përpara vendosjes së tyre në treg, në përputhje me:

6.1. Kapitullin I të Shtojcës VIII të këtij Udhëzimi Administrativ, në rastin e proteinave shtazore të përpunuara ose produkteve të prejardhura nga materialet e kategorisë 2 ose të kategorisë 3.

7. Nënkapitulli 3 të Kapitullit III të Shtojcës III të këtij Udhëzimi Administrativ në rastin e kompostimit dhe mbetjeve të tretjes nga shndërrimi i nënprodukteve shtazore ose produkteve të prejardhura në biogaz.

Nënkapitulli 2

Magazinimi dhe transporti

1. Pas përpunimit ose transformimit, plehrat organike dhe përmirësuesit e tokës duhet të ruhen dhe transportohen siç duhet:

- 1.1. me shumicë, në kushte të përshtatshme që parandalojnë kontaminimin;
- 1.2. të paketuara ose në thasë të mëdhenj, në rastin e plehrave organike ose përmirësuesve të tokës, të destinuara për shitje tek përdoruesit përfundimtar; ose
- 1.3. në rastin e ruajtjes në fermë, në një hapësirë adekuate magazinimi në të cilën asnjë kafshë e kultivuar nuk ka qasje.

Nënkapitulli 3

Kërkesat për aprovimin e ndërmarrjeve ose fabrikave

1. Në mënyrë që të miratohet në përputhje me nenin 24, paragrafin 1, nënparagrafin 1.6 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, operatorët do të sigurojnë që objektet ose fabrikat që kryejnë aktivitetet e përcaktuara në paragrafin 1 të Nënkapitullit 1 të këtij kapitulli i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në nenin 9 të këtij Udhëzimi Administrativ si:

- 1.1. të kenë ambiente adekuate për ruajtjen e përbërësve hyrës për të parandaluar kontaminimin e kryqëzuar dhe për të shmangur kontaminimin gjatë ruajtjes;
- 1.2. asgjësojnë nënproduktet e papërdorura shtazore ose produktet e prejardhura në përputhje me nenet 13 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr.05/2022.

SHTOJCA X

PRODUKTET E NDËRMJETME

Në përputhje me nenin 34, paragrafin 4 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, për importimin dhe transitin përmes Republikës së Kosovës të produkteve të ndërmjetme do të zbatohen kushtet si vijon:

1. Importi dhe tranziti i produkteve të ndërmjetme do të autorizohet, me kusht që:

1.1 ato janë përftuar nga materialet si vijon:

- 1.1.1 Materiali i kategorisë 3, përveç materialeve të përcaktuara në nenin 10, paragrafin 1, nënparagrafin 1.3, 1.14, 1.15 dhe 1.16 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022;
- 1.1.2 produktet e prodhuara nga kafshët, të përcaktuara në nenin 10, paragrafin 1, nënparagrafin 1.9, 1.12, 1.13 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) – Nr .05/2022 ; ose
- 1.1.3 përzierjet e materialeve të përcaktuara në nënparagrafin 1.1.1 dhe 1.1.2 të këtij paragrafi;

1.2 në rastin e produkteve të ndërmjetme të destinuara për prodhimin e pajisjeve mjekësore, pajisjeve mjekësore diagnostikuese in vitro dhe reagentëve laboratorikë, ato rrjedhin nga:

1.2.1 materialet të cilat plotësojnë kriteret e përcaktuara në nënparagrafin 1.1. të këtij paragrafi, përveç se ato mund të kenë origjinën nga kafshë të cilat i janë nënshtruar trajtimit të paligjshëm siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi lidhur me ndalimin e përdorimit në blegtori të substancave të caktuara me veprim hormonal ose tireostatik dhe të β -agonistëve ose në legjislacionin specifik për masat për monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve të tyre në kafshët e gjalla dhe produktet shtazore;

1.2.2 Materiali i kategorisë 2 nga neni 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 dhe 1.8 i Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022; ose

1.2.3 përzierjet e materialeve të përcaktuara në nënparagrafin 1.2.1 dhe 1.2.2 të këtij paragrafi;

1.3 në rastin e produkteve të ndërmjetme të destinuara për prodhimin e pajisjeve mjekësore aktive të implantueshme, produkteve medicinale dhe produkteve medicinale veterinarë, ato përfitohen nga materialet e përcaktuara në nënparagrafin 1.2 të këtij paragrafi, kur autoriteti kompetent e konsideron përdorimin e këtyre materialeve të justifikuar për mbrojtjen e shëndetit publik ose të kafshëve;

1.4 ata vijnë nga një vend i regjistruar si anëtar i Organizatës Botërore për Shëndet të Kafshëve (WOAH);

1.5 ata vijnë nga një ndërmarrje ose fabrikë e regjistruar ose e aprovuar nga autoriteti kompetent i një vendi të përcaktuar në nënparagrafin 1.4 të këtij paragrafi, në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 2 të kësaj shtojce;

1.6 çdo dërgesë shoqërohet me deklaratën e importuesit në përputhje me deklaratën model të përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafin 1.36 të Shtojcës XIII të këtij Udhëzimi Administrativ, e cila duhet të jetë së paku në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës në të cilat duhet të kryhet inspektimi në pikën e kufitare dhe në vendin të destinacionit;

1.7 në rastin e materialeve të përcaktuar në nënparagrafin 1.2 të këtij paragrafi, importuesi i vërteton autoritetit kompetent se materialet;

1.7.1 nuk mbartin asnjë rrezik të transmetimit të një sëmundjeje të transmetueshme të njerëzit ose kafshët; ose

1.7.2 transportohen në kushte që parandalojnë transmetimin e çdo sëmundjeje të transmetueshme të njerëzit ose kafshët.

2. Një ndërmarrje ose fabrikë mund të regjistrohet ose miratohet nga autoriteti kompetent i një vendi tjetër, siç përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafi 1.5 të kësaj shtojce, me kusht që:

2.1. operatori ose pronari i fabrikës ose përfaqësuesi i tij:

2.1.1 dëshmon se fabrika ka pajisje të përshtatshme për shëndrrimin e materialeve të përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafin 1.1, 1.2 ose 1.3 të kësaj Shtojce, sipas zbatimit, për të siguruar përfundimin e fazave të nevojshme të projektimit, transformimit dhe prodhimit;

2.1.2 vendos dhe zbaton metoda të monitorimit dhe kontrollit të pikave kritike të kontrollit në bazë të procesit të përdorur;

2.1.3 mban një regjistër të informacionit të marrë në përputhje me nënparagrafin 2.1.2 të këtij paragrafi për një periudhë prej të paktën 2 vjetësh për t'ia dorëzuar autoritetit kompetent;

2.1.4 informon autoritetin kompetent nëse ndonjë informacion i disponueshëm zbulon ekzistencën e një rreziku serioz për shëndetin e kafshëve ose shëndetin publik;

2.2 autoriteti kompetent i vendit tjetër kryen, në intervale të rregullta, inspektime të ndërmarrjes ose fabrikës dhe mbikëqyr fabrikën në përputhje me kushtet si ne vijim:

2.2.1 frekuenca e inspektimeve dhe mbikëqyrjes do të varet nga madhësia e fabrikës, lloji i produkteve të prodhuara, vlerësimi i rrezikut dhe garancitë e ofruara, bazuar në një sistem kontrollesh i cili është themeluar në përputhje me parimet e analizës së rrezikut dhe pikave kritike të kontrollit (HACCP).

2.2.2 Nëse nga inspektimi i kryer nga organi kompetent i atij vendi konstaton se dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ nuk janë duke u respektuar, autoriteti kompetent do të ndërmarrë veprimet e duhura.

2.2.3 Autoriteti kompetent harton një listë të ndërmarrjeve ose fabrikave të aprovuara ose të regjistruara në përputhje me këtë Shtojcë dhe do t'i caktojë një numër zyrtar çdo fabrike, i cili identifikon ndërmarrjen ose fabrikën në lidhje me natyrën e aktiviteteve të saj, ajo listë do të publikohet në ueb faqen e autoritetit kompetent.

2.4. konfirmimin se produkti nuk synohet në asnjë fazë të devijohet për ndonjë përdorim në prodhimin e ushqimit, materialit për ushqim, plehrave organike ose përmirësuesve të tokës, dhe

2.5. rrjedh nga kafshë të shëndetshme të therura në thertore; dhe

2.6. ose është tharë për një periudhë prej 42 ditësh në një temperaturë mesatare prej të paktën 20 °C; dhe/ose

2.7. është ngrohur për një orë në një temperaturë prej të paktën 80 °C deri në bërthamë; dhe/ose

2.8. është djegur në hi për një orë në një temperaturë prej të paktën 800 °C deri në thelb; dhe/ose

2.9. i është nënshtruar një procesi të acidifikimit të tillë që pH u mbajt për të paktën një orë në më pak se 6 deri në thelb.

3. Për dërgim në Republikën e Kosovës, materiali duhet të mbyllet në kontejnerë ose automjete të mbyllura.

4. Nëse transportohen në kontejnerë, kontejnerët, dhe në të gjitha rastet të gjitha dokumentet shoqëruese, duhet të mbajnë emrin dhe adresën e ndërmarrjes së regjistruar ose fabrikës së destinacionit.

5. Pas kontrolleve veterinarë të parashikuara në pikën e kontrollit kufitar, materiali duhet të transportohet drejtpërdrejt në ndërmarrjen e regjistruar ose fabrikën e destinacionit.

Nënkapitulli 8

Importet e nënprodukteve të kafshëve për prodhimin e ushqimit për kafshët me gëzof, ushqimin për kafshët shtëpiake, përveç ushqimit të papërpunuar për kafshët shtëpiake, dhe produkteve të prejardhura për përdorime jashtë zinxhirit të ushqimit për kafshët e kultivuara

1. Nënproduktet e kafshëve të destinuara për prodhimin e ushqimit për kafshët me gëzof, ushqimin për kafshët shtëpiake, përveç ushqimit të papërpunuar për kafshët shtëpiake, dhe për produktet e prejardhura për përdorime jashtë zinxhirit të ushqimit për kafshët e kultivuara mund të importohen me kusht që:

1.1. nënproduktet shtazore janë ngrirë thellë në fabrikën e origjinës ose janë ruajtur në përputhje me legjislacionin në fuqi në mënyrë që të parandalojë prishjen ndërmjet dërgimit dhe dorëzimit në ndërmarrjen ose fabrikën e destinacionit;

1.2. nënproduktet shtazore i janë nënshtruar të gjitha masave paraprake për të shmangur kontaminimin me agjentë patogjenë;

1.3. nënproduktet e kafshëve janë paketuar në paketim të ri duke parandaluar çdo rrjedhje ose në ambalazh që është pastruar dhe dezinfektuar përpara përdorimit;

1.4. pas kontrolleve veterinarë të parashikuara në pikën kufitare veterinarë, nënproduktet shtazore transportohen drejtpërdrejt ose në:

1.4.1. një fabrikë për ushqimin e kafshëve shtëpiake ose në një ndërmarrje të regjistruar ose fabrikë të destinacionit, e cila ka dhënë garanci se nënproduktet e kafshëve do të përdoren vetëm për qëllimin e prodhimit të produkteve për të cilat është regjistruar ose miratuar, sipas rastit, siç përcaktohet nga autoriteti kompetent nëse është e nevojshme, dhe nuk do të lërë ndërmarrjen ose fabrikën e patrajtuar përveçse për asgjësim të drejtpërdrejtë;

1.4.2. një ndërmarrje ose fabrikë e cila është miratuar në përputhje me nenin 24, paragrafin 1, nënparagrafin 1.8 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022;

1.4.3. një përdorues të regjistruar ose qendër grumbullimi, që ka dhënë një garanci se nënproduktet e kafshëve do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara, siç specifikohet nga autoriteti kompetent nëse është e nevojshme; ose

1.4.4. një ndërmarrje ose fabrikë e cila është miratuar në përputhje me nenin 24, paragrafin 1, nënparagrafin 1.1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 dhe

1.5 në rastin e lëndës së parë për prodhimin e ushqimit për kafshët e përcaktuara në nenin 35, paragrafin 1, nënparagrafin 1.1.2 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, lënda e parë duhet:

1.5.1 të shënohet në vendin e origjinës para hyrjes në Republikën e Kosovës me një kryq nga thëngjilli i lëngshëm ose karboni aktiv, në secilën anë të jashtme të çdo blloku të ngrirë, ose, kur lënda e parë transportohet në paleta të cilat nuk ndahen në ngarkesa të veçanta gjatë transportit në fabrikën e ushqimit për kafshët e destinacionit, në secilën anë të jashtme të çdo palete, në mënyrë të tillë që shenja të mbulojë të paktën 70 % të gjatësisë diagonale të anës së bllokut të ngrirë dhe të jetë së paku 10 cm në gjerësi;

1.5.2 në rastin e materialit që nuk është i ngrirë, shënohet në vendin e origjinës para hyrjes në Republikën e Kosovës duke e spërkatur me thëngjill të lëngshëm ose duke aplikuar pluhur thëngjilli në mënyrë të tillë që thëngjilli të duket qartë në material;

1.5.3 të transportohet direkt në:

1.5.3.1 fabrikën e destinacionit të ushqimit për kafshët në përputhje me nënparagrafin 1.4.1 të paragrafit 1.4 të këtij neni; ose

1.5.3.2 një ndërmarrje ose fabrikë e destinacionit që është miratuar në përputhje me nenin 24, paragrafin 1, nënparagrafin 1.8 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, në përputhje me nënparagrafin 1.4.2 të paragrafit 1.4 të këtij neni dhe prej andej drejtpërsëdrejti në fabrikën e ushqimit për kafshët e përcaktuara nën nënparagrafin 1.5.3.1. të këtij paragrafi, me kusht që fabrika e destinacionit.

1.5.3.2.1. trajton vetëm materialin e mbuluar nga paragrafi 1.5, ose

1.5.3.2.2. trajton vetëm materialet e destinuar për një fabrikë të ushqimit për kafshët shtëpiake siç përcaktohet nën pikën 1.5.3.1 të këtij paragrafi; dhe

1.5.4 të manipulohet për të hequr shenjën e parashikuar në nënparagrafin 5.1 dhe 5.2 të këtij paragrafi vetëm në fabrikën e destinacionit të ushqimit për kafshët shtëpiake dhe vetëm menjëherë përpara përdorimit të materialit për prodhimin e ushqimit për kafshët shtëpiake, në përputhje me kushtet e zbatueshme për ushqimin për kafshët shtëpiake të prodhuara nga materiali i kategorisë 3 të përcaktuara në Kapitullin II të Shtojcës XI;

1.6 Në rastin e dërgesave të përbëra nga lënda e parë, e cila është trajtuar siç përcaktohet në paragrafin 5 më sipër dhe lëndë të tjera të para të patrajtuara, të gjitha lëndët e para në ngarkesë janë shënuar siç përcaktohet në nënparagrafin 1.5.1 dhe 1.5.2 të paragrafit 1.5 më lart;

1.7 shënimi i përcaktuar në nënparagrafin 1.5.1 dhe 1.5.2 dhe paragrafin 1.6 mbetet i dukshëm që nga dërgimi dhe deri në dorëzimin në fabrikën e destinacionit të ushqimit për kafshët;

1.8 Në fabrikën e destinacionit të ushqimit për kafshët, lënda e parë për prodhimin e ushqimit për kafshët e përcaktuar në nenin 35, paragrafin 1, nënparagrafin 1.1.2 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 do të ruhen përpara prodhimit, do të përdoren dhe do të asgjësohen në kushte të autorizuara nga autoriteti kompetent, të cilat lejojnë kontrolle zyrtare

mbi sasinë e materialit të marrë, të përdorur për prodhim dhe asgjësimin, nëse është e aplikueshme.

2. Autoriteti kompetent mund të autorizojë operatorin e fabrikës për ushqimin e kafshëve për të ruajtur materiale të tilla së bashku me materialet e kategorisë 3.

Nënkapitulli 9

Importet e yndyrave të përpunuara për qëllime të caktuara jashtë zinxhirit të ushqimit për kafshët e kultivuara

1. Yndyrnat e përpunuara të cilat nuk janë të destinuara për prodhimin e ushqimit për kafshët e kultivuara, prodhimin e kozmetikës, produkteve medicinale ose pajisjeve mjekësore, mund të importohen, me kusht që:

1.1. ato rrjedhin nga:

1.2. në rastin e materialeve të destinuara për prodhimin e bionaftës, produkteve kimike oleo ose për prodhimin e lëndëve djegëse të rinovueshme që i janë nënshtruar trajtimit të përcaktuar në pikën L të Nënkapitullit 2 të kreut IV të shtojcës II të këtij udhëzimi administrativ, nënproduktet shtazore të përcaktuar në nenet 8, 9 dhe 10 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022;

1.3. në rastin e materialeve të destinuara për prodhimin e plehrave organike dhe përmirësuesve të tokës, materialet e kategorisë 2 të përcaktuara në nënparagrafët 1.3, 1.4 dhe 1.6.1 të nenit 9 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, ose materialet e kategorisë 3, përveç materialeve të përcaktuara në nënparagrafët 1.3 dhe 1.16 të nenit 10 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022;

1.4. në rastin e materialeve të destinuara për prodhimin e lëndëve djegëse të rinovueshme të përcaktuara në pikën J e nenit 2 të kapitullit IV të shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ, Materialet e kategorisë 2 të përcaktuara në nenin 9 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, dhe materialet e kategorisë 3 të përcaktuara në nenin 10 të atij Udhëzimi Administrativ;

1.5. në rastin e materialeve të tjera, materialet e kategorisë 1 të përcaktuara në nënparagrafin 1.2, 1.3 dhe 1.4 të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, Materialet e kategorisë 2 të përcaktuara në nënparagrafin 1.3 dhe 1.4 të nenit dhe nënparagrafin 1.6.1 të nenit 9 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 ose materialet e kategorisë 3, përveç materialeve të përcaktuara në nënparagrafët 1.3 dhe 1.16 të nenit 10 të atij Udhëzimi Administrativ;

1.5.1. ato janë përpunuar me metodën e përpunimit 1 - sterilizimi me presion ose në përputhje me një nga metodat e tjera të përpunimit të përcaktuara në Kapitullin III të Shtojcës II të këtij Udhëzimi Administrativ;

1.5.2. në rastin e yndyrës me origjinë ripërtypëse, janë hequr papastërtitë e patretshme mbi 0,15 % ndaj peshës;

1.5.3. ato janë shënuar përpara dërgesës në Republikën e Kosovës në mënyrë që përqendrimi minimal i GTH i përcaktuar në nënparagrafin 1.2 të Kapitullit V të Shtojcës VI të këtij Udhëzimi Administrativ është arritur;

1.5.4. pas kontrolleve veterinarë të parashikuara në pikën e kontrollit kufitar, yndyrmat e përpunuara transportohen drejtpërdrejt në ndërmarrjen e regjistruar ose fabrikën e destinacionit, në kushte që parandalojnë kontaminimin; dhe

1.5.5. ato mbajnë etiketa, në paketim ose kontejner ku shkruhet **"NUK PËRDOREN PËR KONSUM NGA NJERIU OSE NGA KAFSHËT"**.

Nënkapitulli 10 **Importet e derivateve të yndyrës**

1. Derivatet e yndyrës mund të importohen nëse certifikata shëndetësore që shoqëron ngarkesën vërteton:

1.1. nëse derivatet e yndyrës rrjedhin nga materialet e kategorisë 1, 2 ose 3;

1.2. në rastin e derivateve të yndyrës të prodhuara nga materiali i Kategorisë 2, që produktet:

1.2.1. janë prodhuar duke përdorur një metodë që të paktën plotëson standardet e një prej proceseve të përcaktuar në paragrafin 1 të Kapitullit XI të Shtojcës XI; dhe

1.2.2. do të përdoren vetëm në pleh organik ose përmirësues të tokës ose përdorime të tjera jashtë zinxhirit të ushqimit për kafshët e kultivuara, përveç në kozmetikë, farmaceutikë dhe pajisje mjekësore;

1.2.3. në rastin e derivateve të yndyrës të prodhuara nga materiali i Kategorisë 1, që produktet nuk duhet të përdoren në plehra organike dhe përmirësues të tokës, kozmetikë, farmaceutikë dhe pajisje mjekësore; megjithatë, ato mund të përdoren për qëllime të tjera jashtë zinxhirit të ushqimit për kafshët e kultivuara.

2. Certifikata shëndetësore e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni duhet t'i paraqitet autoritetit kompetent në pikën e kontrollit kufitar në hyrjen e mallrave në Republikën e Kosovës, dhe më pas një kopje duhet të shoqërojë ngarkesën deri në mbërritjen e saj në fabrikën e destinacionit.

3. Pas kontrolleve veterinarë të parashikuara në pikën e kontrollit kufitar, derivatet e yndyrës do të transportohen drejtpërdrejt në ndërmarrjen e regjistruar ose fabrikën e destinacionit.

Nënkapitulli 11

Importet e brirëve dhe produkteve të bririt, me përjashtim të miellit të bririt, dhe thundrat dhe produktet e thundrës, përjashtim të miellit të thundrës, të destinuara për prodhimin e plehrave organike ose përmirësuesve të tokës

1. Brirët dhe produktet e bririt, me përjashtim të miellit të bririt, dhe thundrat dhe produktet e thundrës, me përjashtim të miellit të thundrës, të destinuara për prodhimin e plehrave organike ose përmirësuesve të tokës, mund të importohen, me kusht që:

1.1. ato janë prodhuar në përputhje me Kapitullin XII të Shtojcës XI; dhe

1.2. ato përcillen pas kontrolleve veterinare të parashikuara në pikën e kontrollit kufitar, drejtpërdrejt në një ndërmarrje ose fabrikë të miratuar ose të regjistruar.

**KAPITULLI III
RREGULLAT E VEÇANTA PËR MOSTRA TË CAKTUARA**

**Nënkapitulli 1
Mostrat kërkimore dhe diagnostikuese**

1. Përveç rasteve kur ato mbahen për qëllime referimi ose ridërgohen në vendin e origjinës, mostrat kërkimore dhe diagnostikuese dhe çdo produkt që rrjedh nga përdorimi i këtyre mostrave do të asgjësohen:

1.1. si mbetje nga djegia;

1.2. me anë të sterilizimit nën presion dhe asgjësimit ose përdorimit të mëvonshëm në përputhje me nenet 12 deri në 14 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022; ose

1.3. në përputhje me nënparagrafin 4.2 të paragrafit 4 të Nënkapitullit 1 të Kapitullit I të Shtojcës IV në rast se:

1.3.1. sasi të nuk i kalojnë 2 000 ml; dhe

1.3.2. me kusht që mostrat ose produktet e prejardhura të jenë prodhuar dhe dërguar nga Vendet e BE-së ose nga vende ose pjesë të vendeve, nga të cilat autorizohet.

**Nënkapitulli 2
Mostrat e tregtimit**

1. Autoriteti kompetent mund të autorizojë importin dhe transitin e mostrave tregtare, me kusht që:

1.1. kanë origjinën nga:

1.1.1. vendet e BE-së ose vendet e treta të përcaktuara në kolonën 'lista e vendeve të treta' të rreshtit 14 të tabelës 2 të Nënkapitullit 1 të Kapitullit II të kësaj Shtojce;

- 1.1.2. në rastin e mostrave tregtare që përbëhen nga qumështi, produkte me bazë qumështi ose produkte me prejardhje nga qumështi, vendet e BE-së ose nga vendet e treta të përcaktuara dhe të autorizuar për futjen në BE të ngarkesave të qumështit të papërpunuar dhe produkteve të qumështit të destinuara për përdorim nga njeriu;
- 1.2. shoqërohen me një certifikatë shëndetësore siç përcaktohet në Shtojcën XIII, paragrafin 1, nënparagrafin 1.23. dhe
- 1.3. pas kontrolleve veterinarë të parashikuara në pikën e kontrollit kufitar, ato transportohen drejtpërdrejt në ndërmarrjen ose fabrikën e miratuar ose të regjistruar të treguar në autorizimin e autoritetit kompetent.
2. Përveç rasteve kur mostrat tregtare mbahen për qëllime referimi, ato do të:
- 2.1. asgjësohen ose përdoren në përputhje me nenet 12, 13 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022; ose
- 2.2. ridërgohen në vendin e origjinës.
3. Nëse mostrat tregtare përdoren për testimin e makinerive, testimi do të kryhet:
- 3.1. me pajisje të dedikuara; ose
- 3.2. me pajisje të cilat pastrohen dhe dezinfektohen përpara se të përdoren për qëllime të ndryshme nga testimi.
4. Gjatë transportit në ndërmarrjen ose fabrikën e miratuar ose të regjistruar, mostrat e tregtimit duhet të paketohen në kontejnerë rezistentë nga rrjedhjet.

Nënkapitulli 3

Artikujt e ekspozuar

1. Importi dhe tranziti i artikujve të ekspozuar do të bëhet në përputhje me kushtet si ne vijim:
- 1.1. ato e kanë origjinën nga vendet e BE-së ose vendet e treta të përcaktuara në kolonën 'lista e vendeve të treta' të rreshtit 14 të tabelës 2 të Nënkapitullit 1 të Kapitullit II;
- 1.2. futja e tyre është autorizuar paraprakisht nga autoriteti kompetent ku synohet të përdoret artikulli i ekspozuar;
- 1.3. pas kontrolleve veterinarë të parashikuara në pikën e kontrollit kufitar, artikujt e ekspozuar duhet t'i dërgohen drejtpërdrejt përdoruesit të autorizuar.
2. Çdo ngarkesë duhet të paketohet në paketim që parandalon çdo rrjedhje dhe duhet të shoqërohet me një dokument tregtar i cili specifikon:

- 2.1. përshkrimin e materialit dhe specieve shtazore të origjinës;
 - 2.2. kategorinë e materialit;
 - 2.3. sasinë e materialit;
 - 2.4. vendin e dërgimit të materialit;
 - 2.5. emrin dhe adresën e dërguesit;
 - 2.6. emrin dhe adresën e pranuesit; dhe
 - 2.7. detajet që lejojnë identifikimin e autorizimit të autoritetit kompetent të destinacionit.
3. Pas ekspozimit ose pas përfundimit të veprimtarisë artistike, artikujt e ekspozuar do të:
- 3.1. ridërgohen në vendin e origjinës;
 - 3.2. dërgohen në një vend tjetër, nëse një dërgesë e tillë është autorizuar paraprakisht nga autoriteti kompetent i vendit të destinacionit; ose
 - 3.3. asgjësohen në përputhje me nenet 12, 13 dhe 14 të Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022.

KAPITULLI IV

KËRKESAT SPECIFIKE PËR LËVIZJE TË CAKTUARA TË NËN PRODUKTEVE TË KAFSHËVE

Nënkapitulli 1

Importet e materialeve të caktuara të kategorisë 1

1. Materialet e përcaktuara në nenin 28 i këtij Udhëzimi Administrativ do të importohet në kushtet si ne vijim:
 - 1.1. materialet do të importohen me një etiketë të bashkangjitur në paketim, kontejner ose mjet ku shkruan **"Ndalohet në ushqim, ushqim për kafshë, plehërues, kozmetikë, produkte medicinale dhe pajisje mjekësore"**.
2. Materialet do t'i dorëzohen drejtpërdrejt një ndërmarrje ose fabrike të miratuar ose të regjistruar për prodhimin e produkteve të derivuara, të ndryshme nga produktet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.
3. Materialet e papërdorura ose të tepërta do të përdoren ose asgjësohen në përputhje me nenin 12 të Udhëzimi Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022.

Nënkapitulli 2

Importet e materialeve të caktuara për qëllime të ndryshme nga ushqimi i kafshëve të tokës së kultivuar

1. Autoriteti kompetent mund të autorizojë importin e materialeve si ne vijim për qëllime të ndryshme nga ushqimi i kafshëve të tokës së kultivuar, përveç ushqimit të kafshëve prej gëzofi, me kusht që të mos ketë rrezik të papranueshëm për transmetimin e sëmundjeve të transmetueshme te njerëzit ose kafshët:

1.1. nënproduktet shtazore nga kafshët akuatike dhe produktet e prejardhura nga kafshët akuatike;

1.2. jovertebrorët ujorë dhe produktet e prejardhura nga jovertebrorët ujorë;

1.3. jovertebrorët tokësorë, duke përfshirë çdo formë të transformimit të tyre, të tilla si larvat, dhe produktet që rrjedhin prej tyre;

1.4. produktet e prodhuara nga kafshët e përcaktuara në nënparagrafin 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij neni, të tilla si vezët e peshkut;

1.5. Materiali i kategorisë 3 që përbëhet nga kafshë dhe pjesë të tyre të rendit zoologjik të Rodentia dhe Lagomorpha.

2. Importi e ngarkesave të materialeve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni do të bëhet në përputhje me kërkesat e certifikimit sanitar në përputhje me rregullat kombëtare.

KAPITULLI V

RREGULLAT PËR EKSPORTIN E PRODUKTEVE TË CAKTUARA TË DERIVUARA

1. Rregullat e zbatueshme për eksportin e produkteve të derivuara të renditura në nenin 27 paragrafin 4 të këtij Udhëzimi Administrativ, si vion:

	Produktet e derivuara	Rregullat për eksport
1	• Pleh organik i përpunuar • Plehërues organik, mbetjet e tretjes së kompostorit nga transformimi i biogazit që nuk përmbajnë nënprodukte të tjera shtazore ose produkte të prejardhura përveç plehut organik të përpunuar • Proteina shtazore e përpunuar që përmban plehun organik të përpunuar si përbërës përzierës	Produktet e derivuara të si vijon duhet të jenë në përputhje të paktën me kushtet e përcaktuara në nënparagrafin 1.1, 1.2 dhe 1.4 dhe 1.5 të paragrafit 1 të Nënkapitullit 2 të Kapitullit I të Shtojcës IX: • Plehu organik i përpunuar • Plehëruesi organik, mbetjet e tretjes së kompostorit nga transformimi i biogazit që nuk përmbajnë nënprodukte të tjera shtazore ose produkte të prejardhura përveç plehut organik të përpunuar • Plehu i përpunuar si një përbërës përzierës në proteinat shtazore të përpunuara

2	Produktet e gjakut dhe produktet e ndërmjetme	Gjaku, produktet e gjakut dhe produktet e ndërmjetme të prodhuara në Republikën e Kosovës ose të importuara në Republikën e Kosovës në përputhje me kërkesat shëndetësore të përcaktuara në Shtojcën X ose Seksionet 2 dhe 3 të Kapitullit II të kësaj Shtojce <i>për përdorim jashtë zinxhirit të ushqimit të kafshëve të kultivuara</i> , me kusht që ato të jenë në përputhje me kërkesat e importit të vendit të destinacionit.
---	---	---

KAPITULLI VI KËRKESAT PËR HYRJEN E NGARKESAVE TË NËNPRODUKTEVE SHTAZORE DHE PRODUKTEVE TË DERIVUARA ME ORIGJINË, DHE QË KTHEHEN, NË REPUBLIKËN E KOSOVËS PAS REFUZIMIT TË HYRJES NGA SHTETI TJETËR

Nënkapitulli 1

Nënproduktet shtazore të papaketuara ose me shumicë dhe produktet e derivuara, me origjinë, dhe që kthehen, në Republikën e Kosovës pas refuzimit të hyrjes nga një shtet tjetër që nuk renditet si i tërë ose pjesë e territorit të tij në Shtojcën XII

1. Autoriteti kompetent në pikën e kontrollit kufitar do të autorizojë hyrjen në Republikën e Kosovës të ngarkesave të nënprodukteve shtazore, të papaketuara ose me shumicë, ose produkteve të derivuara që kanë origjinën, dhe kthehen, në Republikën e Kosovës pas refuzimit të hyrjes nga një shtet tjetër që nuk është renditur si i tërë ose pjesë e territorit të tij në Shtojcën XII për hyrjen në Republikën e Kosovës të llojit të produktit, ku plotësohen kushtet si ne vijim:

1.1. ngarkesa shoqërohet me certifikatën ose dokumentin zyrtar, në origjinal ose si kopje e vërtetuar, ose nga ekuivalenti elektronik i kësaj certifikate, lëshuar nga autoriteti kompetent i vendit të eksportit;

1.2. dërgesa shoqërohet me një deklaratë nga autoriteti kompetent në vendin e destinacionit në të cilin ai autoritet pranon të marrë ngarkesën dhe tregon vendin e destinacionit;

1.3. ngarkesa është në përputhje me të dyja kushtet vijuese:

1.3.1. ka mbetur e vulosur me vulë origjinale të paprekur, nëse aplikimi i vulës para largimit nga vendi është përcaktuar në certifikatën origjinale të përcaktuar në nënparagrafin 1.1 të paragrafit 1 ose në një dokument tjetër zyrtar të lëshuar nga autoriteti në vend;

1.3.2. shoqërohet me një deklaratë zyrtare të autoritetit kompetent ose autoritetit tjetër publik të vendit, i cili refuzoi hyrjen e ngarkesës, duke treguar arsyen e refuzimit.

2. Me përjashtim të nënparagrafit 1.1 të paragrafit 1 të këtij neni, në rastin kur ngarkesa është eksportuar pa certifikatë ose dokument zyrtar shoqërues, origjina e dërgesës do të vërtetohet në një mënyrë tjetër bazuar në dëshmitë e dokumentuara të paraqitura nga operatori përgjegjës për ngarkesa.

3. Transporti i ngarkesave të produkteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni nga pika e kontrollit kufitar në vendin e destinacionit do të monitorohet në përputhje me legjislacionin specifik në lidhje me kushtet për monitorimin e transportit dhe mbërritjes së ngarkesave të mallrave të caktuara nga pika e kontrollit kufitar të mbërritjes deri në ndërmarrjen në vendin e destinacionit.

Nënkapitulli 2

Nënprodukte shtazore të papaketuara ose me shumicë dhe produktet e derivuara me origjinë, dhe që kthehen, në Republikën e Kosovës pas refuzimit të hyrjes nga një shtet tjetër

1. Autoriteti kompetent në pikën e kontrollit kufitar do të autorizojë hyrjen në Republikën e Kosovës të ngarkesave të nënprodukteve shtazore, të papaketuara ose me shumicë, ose produkteve të derivuara që kanë origjinën, dhe kthehen, në Republikën e Kosovës pas refuzimit të hyrjes nga një shtet tjetër që nuk është renditur si i tërë ose pjesë e territorit të tij në Shtojcën XII për hyrjen në Republikën e Kosovës të llojit të produktit, ku plotësohen kërkesat e përcaktuara në paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3.2., 2 dhe 3 të Nënkapitullit 1.

2. Kur produktet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Nënkapitulli janë shkarkuar, ruajtur, ringarkuar ose vula origjinale është zëvendësuar në ose me hyrjen në një shtet tjetër ose një pjesë të territorit të tij të listuar në Shtojcën XII, dërgesa shoqërohet nga një deklaratë zyrtare e autoritetit kompetent ose autoritetit tjetër publik të atij shteti ose territori:

2.1. duke treguar vendin dhe datën e shkarkimit, ruajtjes dhe ringarkimit dhe numrin e vulës së vendosur në kontejner pas ringarkimit;

2.2. duke konfirmuar se:

2.2.1. vula në automjet ose në kontejnerin e ngarkesës është thyer vetëm për qëllime të kontrolleve zyrtare;

2.2.2. produktet janë trajtuar vetëm në masën e nevojshme, dhe në veçanti;

2.2.3. në temperaturën e duhur të kërkuar për llojet përkatëse të nënprodukteve shtazore ose produkteve të prejardhura; dhe

2.2.4. në një mënyrë që parandalon kontaminimin e tërthortë të produkteve gjatë kontrolleve;

2.2.5. automjeti ose kontejneri është rivulosur menjëherë pas kontrolleve zyrtare;

2.2.6. duke treguar arsyet e shkarkimit dhe ruajtjes.

Nënkapitulli 3

Nënproduktet e paketuara të kafshëve dhe produktet e derivuara me origjinë, dhe që kthehen, në Republikën e Kosovës pas refuzimit të hyrjes nga një shtet tjetër

1. Autoriteti kompetent në postën e kontrollit kufitar do të autorizojë hyrjen në Republikën e Kosovës të ngarkesave të nënprodukteve të paketuara shtazore ose produkteve të derivuara, me origjinë, dhe që kthehen në Republikën e Kosovës pas refuzimit të hyrjes nga një shtet tjetër ku kërkesat e përcaktuara në nënkapitullin 1 janë përmbushur dhe paketimi individual i produkteve ka mbetur i paprekur në krahasim me gjendjen e tij përpara eksportimit.

2. Kur produktet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij Nënkapitulli janë shkarkuar në një vend tjetër, ngarkesa shoqërohet me një deklaratë zyrtare të autoritetit kompetent ose autoritetit tjetër publik të një vendi tjetër që vërteton se produktet:

2.1. nuk i janë nënshtruar asnjë trajtimi përveç shkarkimit, ruajtjes dhe ringarkimit;

2.2. janë trajtuar në temperaturën e kërkuar për llojet përkatëse të nënprodukteve shtazore ose produkteve të prejardhura.

SHTOJCA XIII

LISTA E CERTIFIKATAVE SHËNDETËSORE

1. Lista e certifikatave shëndetësore dhe deklaratave që do të shoqërojnë ngarkesat e nënprodukteve shtazore dhe produkteve të derivuara siç përcaktohet në nenin 32, paragrafin 2.

2. Certifikata shëndetësore për proteinat shtazore të përpunuara, përveç atyre që rrjedhin nga insektet e kultivuara, të cilat nuk janë të destinuara për konsum njerëzor, duke përfshirë përzierjet dhe produktet e tjera përveç ushqimit për kafshë që përmbajnë proteina të tilla, për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.

3. Certifikata shëndetësore për proteinat shtazore të përpunuara që rrjedhin nga insektet e kultivuara që nuk janë të destinuara për konsum nga njeriu, duke përfshirë përzierjet dhe produktet e tjera përveç ushqimit për kafshë që përmbajnë proteina të tilla, për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.

4. Certifikata shëndetësore për qumështin, produktet me bazë qumështi dhe produktet me prejardhje nga qumështi që nuk janë të destinuara për konsum nga njeriu për dërgim në, apo transit nëpër Republikën e Kosovës.

5. Certifikata shëndetësore për kolostrumin dhe produktet e kolostrumit nga gjedhi që nuk janë të destinuara për konsum nga njeriu për dërgim në, apo transit nëpër Republikën e Kosovës.

6. Certifikata shëndetësore për ushqimin e konservuar për kafshë shtëpiake të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.

7. Certifikata shëndetësore për ushqimin e përpunuar për kafshë, përveç ushqimit të konservuar për kafshë, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.

8. Certifikata shëndetësore për ushqimet përtypëse të qenve të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
9. Certifikata shëndetësore për ushqimin e papërpunuar për kafshë për shitje direkte ose nënproduktet shtazore për t'iu dhënë për ushqyerje kafshëve prej gëzofi, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
10. Certifikata shëndetësore për aromatizimin e brendësive për përdorim në prodhimin e ushqimit për kafshë shtëpiake, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
11. Certifikata shëndetësore për nënproduktet e kafshëve për prodhimin e ushqimit për kafshë shtëpiake, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
12. Certifikata shëndetësore për importin e gjakut dhe produkteve të gjakut nga ekuidet për t'u përdorur jashtë zinxhirit të ushqimit, për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
13. Certifikata shëndetësore për produktet e gjakut që nuk janë të destinuara për konsum nga njeriu që mund të përdoren si lëndë ushqimore, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
14. Certifikata shëndetësore për produktet e gjakut të patrajtuara, me përjashtim të atyre të ekuideve, për prodhimin e produkteve të derivuara për qëllime jashtë zinxhirit të ushqimit për kafshët e kultivuara, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
15. Certifikata shëndetësore për produktet e trajtuara të gjakut, me përjashtim të ekuideve, për prodhimin e produkteve të derivuara për qëllime jashtë zinxhirit të ushqimit për kafshët e kultivuara, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
16. Certifikata shëndetësore për gëzofin dhe lëkurat e freskëta ose të ftohta të thundrakeve, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
17. Certifikata shëndetësore për gëzofin dhe lëkurat e trajtuara të thundrakëve, të destinuara për dërgim në, ose transit nëpër Republikën e Kosovës.
18. Deklarata zyrtare për gëzofin dhe lëkurën e trajtuar të ripërtypësve dhe të ekuideve që janë të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës dhe janë mbajtur të ndara për 21 ditë ose do t'i nënshtrohen transportit për 21 ditë të pandërprera para importimit.
19. Certifikata shëndetësore për trofe të gjahut të trajtuara dhe preparate të tjera të shpendëve dhe thundrakëve, të përbëra vetëm nga kockat, brirët, thundrat, kthetrat, dhëmbët, gëzofi ose lëkurat, për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
20. Certifikata shëndetësore për trofe të gjahut ose preparate tjera të shpendëve dhe thundrakëve të përbëra nga pjesë të tëra të patrajtuara, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.

21. Certifikata shëndetësore për qimet e derrit nga vendet e treta ose rajonet e tyre që janë të lira nga murtaja afrikane e derrave, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
22. Certifikata shëndetësore për qimet e derrit nga vendet e treta ose rajonet e tyre që nuk janë të lira nga murtaja afrikane e derrave, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
23. Certifikata shëndetësore për nënproduktet e kafshëve që do të përdoren për qëllime jashtë zinxhirit të ushqimit ose për mostra tregtare, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
24. Certifikata shëndetësore për vajin e peshkut që nuk është i destinuar për konsum nga njeriu për t'u përdorur si material ushqimor ose për qëllime jashtë zinxhirit të ushqimit, i destinuar për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
25. Certifikata shëndetësore për yndyrat e përpunuara që nuk janë të destinuara për konsum nga njeriu për t'u përdorur si lëndë ushqimore, të destinuara për dërgim në, ose për transit në Republikën e Kosovës.
26. Certifikata shëndetësore për yndyrat e përpunuara që nuk janë të destinuara për konsum nga njeriu për t'u përdorur për qëllime të caktuara jashtë zinxhirit të ushqimit, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
27. Certifikata shëndetësore për xhelatinë dhe kolagjen të pa destinuar për konsum nga njeriu për t'u përdorur si material ushqimor ose për qëllime jashtë zinxhirit të ushqimit, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
28. Certifikata shëndetësore për proteinat e hidrolizuara, dikalcium fosfat dhe trikalcium fosfat që nuk janë të destinuara për konsum nga njeriu për t'u përdorur si lëndë ushqimore ose për përdorime jashtë zinxhirit të ushqimit.
29. Destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
30. Certifikata shëndetësore për nënproduktet e bletarisë të destinuara ekskluzivisht për përdorim në bletari, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.
31. Certifikata shëndetësore për derivatet yndyrore që nuk janë të destinuara për konsum nga njeriu për t'u përdorur jashtë zinxhirit të ushqimit, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës;
32. Certifikata shëndetësore për derivatet e yndyrës që nuk janë të destinuara për konsum nga njeriu për t'u përdorur si ushqim ose jashtë zinxhirit të ushqimit, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.

33. Certifikata shëndetësore për produktet e vezëve që nuk janë të destinuara për konsum nga njeriu që mund të përdoren si lëndë ushqimore, të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.

34. Deklarata e importuesit të eshtrave dhe produkteve të kockave, brirëve dhe produkteve të bririt dhe thundrave dhe produkteve të thundrës të destinuara për përdorim të ndryshëm nga ato si lëndë ushqimore, pleh organik ose përmirësues të tokës për dërgim në Republikën e Kosovës.

35. Certifikata shëndetësore për plehun e përpunuar, produkte të derivuara nga plehu organik i përpunuar dhe guano nga lakuriqët e natës të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.

36. Certifikata shëndetësore për brirët dhe produktet e bririt, me përjashtim të miellit të bririt, dhe thundrës dhe produkteve të thundrës, me përjashtim të miellit të thundrës, të destinuara për prodhimin e plehrave organike ose përmirësuesve të tokës të destinuara për dërgim në, ose për transit nëpër Republikën e Kosovës.

37. Certifikatë shëndetësore për xhelatinë që nuk është e destinuar për konsum njerëzor për përdorim nga industria fotografike, e destinuar për dërgim në Republikën e Kosovës.

38. Deklarata për import nga vendet e tjera dhe për transit nëpër Republikën e Kosovës të produkteve të ndërmjetme që përdoren për prodhimin e produkteve medicinale, produkteve medicinale veterinarë, pajisjeve medicinale për qëllime medicinale dhe veterinarë, pajisjeve medicinale aktive të implantueshme, pajisjeve medicinale diagnostikuese in vitro për qëllime medicinale dhe veterinarë, reagentëve laboratorikë dhe produkteve kozmetike.

39. Deklarata e importuesit të leshit dhe qimeve të patrajuara të përcaktuara në nenin 27, paragrafin 2, nënparagrafin 2.5 për import në Republikën e Kosovës.

40. Shënimet në lidhje me certifikatat shëndetësore dhe deklaratat nga paragrafi 1 i kësaj shtojce janë si vijon:

40.1. Certifikatat veterinarë do të prodhohen nga vendi eksportues, bazuar në modelet e përcaktuara në këtë Shtojcë, sipas paraqitjes së modelit që korrespondon me nënproduktet shtazore ose produktet e derivuara në fjalë. Ato duhet të përmbajnë, sipas rendit të numrave që shfaqet në model, vërtetimet që kërkohen për çdo vend dhe, sipas rastit, ato garanci shtesë që kërkohen për vendin eksportues ose një pjesë të tij;

40.2. Kur modeli i certifikatës thotë se deklarata të caktuara duhet të mbahen sipas nevojës, deklaratat që nuk janë relevante mund të kryqëzohen dhe iniciohen dhe vulosen nga zyrtari certifikues, ose të fshihen plotësisht nga certifikata.

41. Origjinali i çdo certifikate do të përbëhet nga një fletë e vetme prej letre, në të dyja anët, ose, kur kërkohet më shumë tekst; do të jetë në atë formë që të gjitha fletët e nevojshme prej letrës të jenë pjesë e një tërësie të integruar dhe të pandashme;

42. Do të hartohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës të BE-së në të cilën do të kryhet kontrolli në pikën kufitare dhe të vendit të destinacionit. Megjithatë, këto vende mund të lejojnë gjuhë të tjera, të shoqëruara, nëse është e nevojshme, nga një përkthim zyrtar.

43. Nëse për arsye të identifikimit të artikujve të ngarkesës, certifikatës i bashkëngjiten fletë shtesë prej letre, këto fleta prej letre do të konsiderohen gjithashtu se janë pjesë e origjinalit të certifikatës me aplikimin e nënshkrimit dhe vulës së veterinerit zyrtar certifikues, në secilën prej fletëve prej letrës.

44. Kur certifikata, duke përfshirë programet shtesë të përcaktuara në pikën e), përfshin më shumë se një faqe, secila faqe do të numërohet - *(numri i faqes)* i *(numrit të përgjithshëm të faqeve)* - në fund të faqes dhe do të ketë numrin e kodit të certifikatës që është caktuar nga autoriteti kompetent në krye të faqes.

45. Origjinali i certifikatës duhet të plotësohet dhe të nënshkruhet nga një veteriner zyrtar. Duke vepruar kështu, autoritetet kompetente të vendit eksportues duhet të sigurojnë që të respektohen parimet e certifikimit ekuivalente me ato të përcaktuara në legjislacionin specifik për certifikimin e kafshëve dhe produkteve shtazore.

46. Ngjyra e nënshkrimit duhet të jetë e ndryshme nga ajo e printimit. I njëjti rregull zbatohet për pullat e tjera nga ato të stampuara ose filigranë.

47. Origjinali i certifikatës duhet të shoqërojë ngarkesën në pikën e kontrollit kufitar.

48. Nëse përdoren certifikatat shëndetësore për dërgesat në tranzit, kutia Nr. I.5 ("pranuesi i ngarkesës") i certifikatës përkatëse shëndetësore do të plotësohet me emrin dhe adresën e pikës së kontrollit kufitar përmes së cilës ngarkesa synohet të largohet nga Republika e Kosovës.)

SHTOJCA XIV

KONTROLLET ZYRTARE

KAPITULLI I

KONTROLLET ZYRTARE NË IMPIANTET PËR PËRPUNIM

Nënkapitulli 1

Mbikëqyrja e prodhimit

1. Autoriteti kompetent do të mbikëqyrë impiantet e përpunimit për të siguruar pajtueshmëri me kërkesat e Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 dhe me këtë Udhëzim Administrativ, ai, në veçanti:

1.1. kontrollojnë:

1.1.1. kushtet e përgjithshme të higjienës së ambienteve, pajisjeve dhe personelit;

1.1.2. efikasitetin e kontrolleve vetanake të kryera nga operatori i impiantit të përpunimit, në përputhje me nenin 28 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, kontrolle të tilla duhet të përfshijnë një ekzaminim të rezultateve të këtyre kontrolleve dhe nëse është e nevojshme, marrjen e mostrave;

1.1.3. zbatimin efektiv të procedurës së përhershme me shkrim bazuar në parimet HACCP në përputhje me nenin 29 paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, kontrolle të tilla duhet të përfshijnë një ekzaminim të rezultateve të këtij zbatimi dhe nëse është e nevojshme, marrjen e mostrave;

1.1.4. standardet e produkteve pas përpunimit; analizat dhe testet duhet të kryhen në përputhje me metodat e njohura shkencërisht, në veçanti, ato të përcaktuara në legjislacionin në fuqi ose, kur nuk parashikohen metoda të tilla në legjislacion, në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare ose, në mungesë të tyre, standardet kombëtare; dhe

1.1.5. kushtet e ruajtjes;

1.1.6. marrja e çdo mostre të nevojshme për testet laboratorike; dhe

1.1.7. kryerja e çdo kontrolli tjetër që e konsideron të nevojshëm për të siguruar pajtueshmërinë me Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, dhe me këtë Udhëzim Administrativ.

2. Për ta lejuar atë të kryejë përgjegjësitë e tij sipas paragrafit 1 të këtij Nënkapitulli, autoriteti kompetent duhet të ketë qasje të lirë në çdo kohë në të gjitha pjesët e impiantit të përpunimit dhe në të dhënat, dokumentet tregtare dhe certifikatat shëndetësore.

Nënkapitulli 2

Procedurat e validimit

1. Përpara lëshimit të një miratimi për një impiant përpunimi, siç përcaktohet në Nenin 44, paragrafin 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, autoriteti kompetent duhet të kontrollojë nëse verifikimi i impiantit të përpunimit është kryer nga operatori në përputhje me procedurat dhe treguesit si vijon:

1.1 një përshkrim të procesit me një diagram të rrjedhës së procesit;

1.2 një identifikim të pikave kritike të kontrollit (CCP) duke përfshirë shkallën e procesit të materialit për sistemet e vazhdueshme;

1.3 pajtueshmërinë me kërkesat specifike të procesit të përcaktuara nga ky Udhëzim Administrativ; dhe

1.4 arritjen e kërkesave si vijon:

1.3.1. madhësia e grimcave për presionin e grupit dhe proceset e vazhdueshme, të përcaktuara nga vrima e grirësit ose madhësia e boshllëkut të kudhërit;

1.3.2. temperatura, presioni, koha e përpunimit dhe, në rastin e sistemeve të përpunimit të vazhdueshëm, shkalla e përpunimit të materialit, siç specifikohet në paragrafët 2 dhe 3 të këtij Nënkapitulli.

1.4. Në rastin e një sistemi presioni në grup:

1.4.1. temperatura duhet të monitorohet me një termoelement të përhershëm dhe duhet të futet në diagram në kohë reale;

1.4.2. faza e presionit duhet të monitorohet me një matës presioni të përhershëm, presioni duhet të futet në diagram në kohë reale;

1.4.3. koha e përpunimit duhet të tregohet nga diagramet e kohës/temperaturës dhe kohës/presionit. Të paktën një herë në vit duhet të kalibrohen termoelementi dhe matësi i presionit.

1.5. Në rastin e një sistemi presioni të vazhdueshëm:

1.5.1. temperatura dhe presioni duhet të monitorohen me termoelement, ose një pistoletë të temperaturës me rreze infra të kuqe dhe matësit e presionit duhet të përdoren në pozicione të përcaktuara në të gjithë sistemin e procesit në mënyrë të tillë që temperatura dhe presioni të përputhen me kushtet e kërkuara brenda të gjithë sistemit të vazhdueshëm ose në një pjesë të tij, temperatura dhe presioni duhet të futen në diagram në kohë reale

1.5.2. matja e kohës minimale të tranzitit brenda të gjithë pjesës përkatëse të sistemit të vazhdueshëm, ku temperatura dhe presioni përputhen me kushtet e kërkuara, duhet t'u jepet autoriteteve kompetente, duke përdorur shënues të patretshëm, si dioksidi i manganit, ose një metodë që ofron garanci ekuivalente. Matja e saktë dhe kontrolli i shkallës së procesit material është thelbësor dhe duhet të matet gjatë testit të verifikimit në lidhje me një CCP që mund të monitorohet vazhdimisht si:

1.5.3. rrotullimet e vidhave të furnizimit në minutë (rev./min.);

1.5.4. fuqia elektrike - amp në tensionin e dhënë;

1.5.5. shkalla e avullimit / kondensimit; ose

1.5.6. numri i goditjeve të pompës për njësi të kohës.

2. Të gjitha pajisjet matëse dhe monitoruese duhet të kalibrohen të paktën një herë në vit.

3. Autoriteti kompetent duhet të përsërisë kontrollet në procedurat e verifikimit kur e sheh të nevojshme dhe në çdo rast çdo herë që i bëhet procesit ndonjë ndryshim domethënës, si modifikime të makinerisë ose ndryshime të lëndëve të para.

KAPITULLI II

KËRKESAT SPECIFIKE PËR KONTROLLET ZYRTARE

Nënkapitulli 1

Kontrollet zyrtare lidhur me shënjinin e produkteve të derivuara

Autoriteti kompetent kryen një kontroll të performancës së sistemit të monitorimit dhe regjistrimit të përcaktuar në paragrafin 2 të Kapitullit V të Shtojcës VIII të këtij Udhëzimi Administrativ për të konstatuar pajtueshmërinë me këtë Udhëzim Administrativ dhe, kur është e nevojshme, mund të kërkojë testimin e mostrave shtesë në përputhje me metodën e përcaktuar në nën-paragrafin e dytë të atij paragrafi.

Nënkapitulli 2

Kontrollet zyrtare në impiantet e djegies me kapacitet të ulët

Autoriteti kompetent do të inspektojë një impiant djegieje me kapacitet të ulët për djegien e materialeve me rrezik specifik përpara miratimit, dhe të paktën një herë në vit për të monitoruar pajtueshmërinë me Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 dhe me këtë Udhëzim Administrativ.

Nënkapitulli 3

Kontrolle zyrtare në zonat e largëta

Në rastin e asgjësimit të nënprodukteve shtazore në zona të largëta në përputhje me Nenin 19, paragrafin 1, nënparagrafin 1.2 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022, autoriteti kompetent monitoron rregullisht zonat e kategorizuara si zona të largëta për të siguruar që ato zonat dhe operacionet e asgjësimit janë të kontrolluara siç duhet.

Nënkapitulli 4

Kontrollet zyrtare në fermat e regjistruara për ushqimin e kafshëve me gëzof

1. Autoriteti kompetent merr masat e nevojshme për të kontrolluar si:

1.1. përbërja, përpunimi dhe përdorimi i duhur i ushqimit të kafshëve që përmban miell mishi dhe kockash ose produkte të tjera të cilat janë përpunuar në përputhje me metodat e përpunimit të përcaktuara në Kapitullin III të Shtojcës II të Udhëzimit Administrativ dhe që rrjedhin nga trupat ose pjesët e trupave të kafshë të së njëjtës specie;

1.2. që kafshët ushqehen me ushqimin e përcaktuar në nënparagrafin 1.1 të këtij paragrafi, duke përfshirë:

1.2.1. mbikëqyrje të rreptë të gjendjes shëndetësore të këtyre kafshëve; dhe

1.2.2. mbikëqyrjen e duhur të TSE që përfshin marrjen e rregullt të mostrave dhe ekzaminimin laboratorik për TSE.

2. Mostrat e përcaktuara në nënparagrafin 1.2.2 të paragrafit 1 të këtij Nënkapitulli përfshijnë mostrat e marra nga kafshët që shfaqin simptoma neurologjike dhe nga kafshë të mbarështimit më të vjetër.

Nënkapitulli 5

Kontrollet zyrtare në lidhje me qendrat e grumbullimit

1. Autoriteti kompetent do të:

1.1. përfshijë qendrat e grumbullimit në listën e hartuar në përputhje me nenin 47, paragrafin 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022;

1.2. caktojë një numër zyrtar çdo qendre grumbullimi; dhe

1.3. përditësojë listën e qendrave të grumbullimit dhe ta vejë në dispozicion së bashku me listën e hartuar në përputhje me nenin 47, paragrafin 1 të Udhëzimit Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022.

1.4. Autoriteti kompetent kryen kontrolle zyrtare në qendrat e grumbullimit për të verifikuar pajtueshmërinë me këtë Udhëzim Administrativ.

Nënkapitulli 6

Kontrollet zyrtare në lidhje me ushqimin e kafshëve të egra dhe kafshëve të caktuara të kopshtit zoologjik me materiale të kategorisë 1

1. Autoriteti kompetent do të monitorojë gjendjen shëndetësore të kafshëve të fermave në rajonin ku kryhet ushqyerja, siç përcaktohet në nënkapitullin 2, 3 dhe 4 të Kapitullit II të Shtojcës IV të këtij Udhëzimi Administrativ dhe do të kryejë mbikëqyrjen e duhur të TSE që përfshin marrjen e rregullt të mostrave dhe ekzaminimin laboratorik për TSE.

2. Këto mostra do të përfshijnë mostra të marra nga kafshë të dyshuara dhe nga kafshë të mbarështimit më të vjetër.

Nënkapitulli 7

Kontrollet zyrtare lidhur me aplikimin e disa plehrave organike dhe përmirësuesve të tokës

1. Autoriteti kompetent do të kryejë kontrolle përgjatë gjithë zinxhirit të prodhimit dhe përdorimit të plehrave organike dhe përmirësuesve të tokës, që i nënshtrohen kufizimeve të përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të nenit 6 të këtij Udhëzimi Administrativ.

2. Kontrollet nga paragrafi 1 i këtij Nënkapitulli do të përfshijnë kontrollet e përzierjes me një komponent të përcaktuar në paragrafin 2 të Nënkapitullit 1 të Kapitullit II të Shtojcës IX të këtij

udhëzimi administrativ, si dhe kontrollet mbi rezervat e këtyre produkteve të mbajtura në fermë dhe të dhënat e mbajtura në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) - Nr. 05/2022 dhe me këtë Udhëzim Administrativ.

Nënkapitulli 8

Kontrollet zyrtare në lidhje me fabrikat e miratuara fotografike

Autoriteti kompetent do të kryejë kontrolle dokumentare në fabrikat e miratuara fotografike të përcaktuara në tabelën 3 të paragrafit 1 të Nënkapitullit 11 të Kapitullit II të Shtojcës XII mbi zinxhirin e kanalizimit nga pikat e inspektimit kufitar të hyrjes së parë në fabrikat e miratuara fotografike me qëllim të mbledhjes/grupimit të sasive të produkteve të importuara, të përdorura dhe të asgjësuar.

Nënkapitulli 9

Kontrollet zyrtare në lidhje me disa yndyrna të përpunuara të importuara

Autoriteti kompetent do të kryejë kontrolle dokumentare në objektet e regjistruara ose impiantet që marrin yndyrna të përpunuara të cilat janë importuar në përputhje me Nënkapitullin 9 të Kapitullit II të Shtojcës XII të këtij Udhëzimit Administrativ në zinxhirin e kanalizimit nga pikat e inspektimit kufitar të hyrjes së parë në ndërmarrjen ose impiantin e regjistruar për qëllim të barazimit të sasive të produkteve të importuara, të përdorura dhe të asgjësuar.

Nënkapitulli 10

Kontrolla zyryare lidhur me bimët e aprovuara për djegje të nën produkteve shtazore

Autoriteti kompetent do të kryejë kontrollë të dokumenteve në përputhje me procedurat e cekura në Nenin 6, paragraf 7 dhe 8 në fabrikat e aprovuara sipas Kapitullit V të Shtojcës I të këtij Udhëzimi Administrativ.